

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

1.06.2023  
Ora 12:37

**RENDI I DITËS**

**“Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 85, subjekti ankues,  
koalicioni “Bashkë Fitojmë”**

**PJESËMARRJA:**

- KAS-i: Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,  
Z. Ledio Braho, Z. Koli Bele.
- Stafi i KQZ-së: Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Znj. D. Alimemeti
- Parti Politike: BF (Franci Nuri, Blendi Himçi)
- Të tjerë: KRIIK

**Z. L. Braho:** Përshendetje, të gjithëve! Çelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 85, me ankues subjektin zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë” me objekt ankimi kundërshtimi i vendimit nr. 539 datë 20.05.2023 për miratimin e tabelës përbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë dhe për këshillin e bashkisë, zonën zgjedhore Bashkia Elbasan për zgjedhjet e organet të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Objekti i ankimit ka 8 pikë. Nuk po i lexojmë të gjitha, duke qenë se i kemi cituar edhe në seancën paraprake; kemi modifikuar objektin, në fakt, sepse një pjesë nuk janë pjesë e objektit, po janë mekanizma, për ta arritur te qëllimi që kërkon ankumuesi. Të pranishëm janë përfaqësuesit e subjektit zgjedhor të koalicionit “Bashkë Fitojmë”.

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. F. Nuri:** Prezent

**Z. B. Himçi:** Prezent

**Z. L. Braho:** Edhe ju jeni në cilësinë e përfaqësuesit ligjor?

**Z. F. Nuri:** Po.

**Z. L. Braho:** Dakord, faleminderit! Po ashtu i pranishëm është edhe përfaqësuesi i subjektiti zgjedhor të palës së interesuar, Partia Socialiste e Shqipërisë.

**Z. M. Legisi:** Prezent.

**Z. L. Braho:** Faleminderit! I pranishëm është edhe zoti Ylli Merkaj, sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së. KAS-i përbëhet tashmë me numrin e plotë të anëtarëve. Ka ndonjë kërkesë paraprake nga palët?


**Z. F. Nuri:** Po, i nderuar.

**Z. L. Braho:** Po, zoti Nuri.

**Z. F. Nuri:** Atëherë dua të sjell në vëmendje të KAS-it kërkesën që ne kemi depozituar në datën 25 Maj me numër protokolli 54-58, përvienien në dispozicion të filmimeve të kamerave të të gjithave qendrave të votimit në Bashkinë e Elbasanit, sikundër edhe kërkesat e tjera teknike, që ishin, po themi, ato që kemi kërkuar dhe

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

2



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

dje për Kamzën. Dua t'ju bëj me dije se deri në këtë moment nuk na është vënë në dispozicion për Elbasanin asnjë qendër votimi, pra asnjë kamerë e asnjë qendre votimi, nga mbi 200 qendra votimi, 222 sa janë në Elbasan. Nga 222 qendra votimi në Elbasan, nuk na është vënë në dispozicion asnjë, zero deri më tanë. Ndërkohë që suporti teknik, dhjeta terra ne e kemi depozituar në KQZ ditën e shtunë dhe sot jemi e enjte, kanë kaluar 4 ditë dhe nuk kemi asnjë filmim. Kështu që në këto kushte, unë mendoj se nuk mund të zhvillojmë dot një seancë themeli për këtë çështje. Do të na duhet një kohë e mjaftueshme.

**Z. L. Braho:** Me pak fjalë, ju kërkoni kohë, që edhe KQZ-ja t'ju verë në dispozicion provat dhe më tej ju t'i analizoni.

**Z. F. Nuri:** Këto mund t'i kërkoni dhe ju si anëtarë të KAS-it, marrjen e provës.


**Z. L. Braho:** Ju e keni depozituar që në datën 25 maj kërkesën?

**Z. F. Nuri:** Në 25 Maj me numër protokolli, me të gjitha, sipas kërkesave të ligjit. Tani ose mund ta kërkoni ju vetë si anëtarë të KAS-it t'ju vihet në dispozicion edhe juve për shkak të interesit të përgjithshëm dhe le të hapen këtu kamerat të gjitha, janë 12 orë filmime për çdo qendër votimi, ose të paktën KQZ -ja të na i vëré në dispozicion.

**Z. L. Braho:** Juve nuk ju është referuar, thjesht nuk jua kanë dhënë, nuk keni ndonjë shkresë me refuzim për marrje provash?

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

3



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. F. Nuri:** Jo, në dijeninë time deri më tani nuk kemi ndonjë shkresë me refuzim, por ndryshe nga ajo që ndodhi dje me Kamzën, ne gjykojmë se duke qenë se janë dyfishi i qendrave të votimit sësa Kamza, duhet një afat kohor i mjaftueshëm dhe i arsyeshëm përt'i përpunuar të gjitha ato qendra. Janë 12 orë filmime për çdo qendër, të mos harrojmë 24 orë që na u dha për Kamzën...

**Z. L. Braho:** Ja t'i kërkojmë një herë se sa kohë i duhen KQZ-së përt'i bërë gati. Zoti Merkaj, duke qenë se shkresa është depozitar që në datën 25, në qoftë se keni ndonjë informacion se kur mund t'i vihen në dispozicion palës ankimuese.

**Z. Y. Merkaj:** Kompania është duke punuar, po ka pasur probleme me *hard disk-un* e jashtëm, të dorëzuar nga pala ankuese.... (*nuk dëgjohet*) kështu që ka pasur probleme.

**Z. F. Nuri:** Ne nuk na ka informuar njeri lidhur me problematikën e *hard disk-ut*.

**Z. L. Braho:** Sa duhet, pra, mund ta kemi një afat që të përllogarisim edhe sa afat i duhet palës pastaj.

**Z. Y. Merkaj:** Besoj 4 ditë do të jenë të mjaftueshme.

**Z. L. Braho:** Pra ju duhen ju 4 ditë që të jepni materialet.

**Z. Y. Merkaj:** Po janë 222 qendra votimi, herë 12 orë.

**Z. L. Braho:** Pra, i bie të hënën në datën 5 ju mund ta jepni.

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

4

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt. 01.06.2023*

**Z. F. Nuri:** Atëherë, nëse me lejohet, edhe neve do të na duhet një kohë rrreth 10 ditë, me gjithë stafin.

**Z. B. Himçi:** I nderuar, faktikisht nga data 25 llogarism dhe duke vënë në dispozicion edhe përderisa po i vendosim kompanisë edhe 4 ditë të tjera në dispozicion, besoj se duhet të ketë një afat të arsyeshëm edhe për ne për t'u parë si filmime, që të mos anashkalohen. Ju faleminderit!

**Z. L. Braho:** Po, faleminderit! Të marrim edhe mendimin e palës interesuar. Zoti Legisi, ju çfarë mendimi keni në lidhje me këtë situatë, në lidhje me kërkesën paraprake të palës ankimore?

**Z. M. Legisi:** Po, mendoj që jemi në seancë shqyrtimi të ankesës do të ishte më e mirë që të bënин dhe një përbledhje të pretendimeve të tij dhe pastaj të vijë kërkesa për provën. Ne faktikisht, pa u njojur edhe me kërkesën e palës në këtë seancë, nuk është se jemi kundër marrjes së provave, sikurse e pretendon pala ankuese, dakord të merren provat, pastaj masën apo thellësinë e hetimit që do të bëjë KAS-i, e lëmë në vlerësimin tuaj. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Po, faleminderit!

**Z. K. Bele:** Duhet të kemi në konsideratë që ka një simetri midis procesit zgjedhor, që shtrihet në territorin dhe forcës që angazhohet në proces dhe mundësisë dhe burimeve njerëzore dhe kërkesave të logjikshme, që na bëhen neve. Natyrisht, një forcë politike, e cila çon komisioner në çdo qendër votimi, ka 200 veta potencial, të

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

5

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt. 01.06.2023*

cilët secili nga ata mund të marrë dhe ta shohë atë gjë. Pra ata 200 vëzhgues që kanë qenë në secilën qendër, secili mund të marrë qendrën e vet dhe ta shohë dhe ky proces realizohet edhe për një ditë apo edhe për 2 ditë. Pse e them këtë? Sepse nëse do të pranojmë kërkesën e avokatit, që duket në pamje të parë e logjikshme, t'i shikojmë ne kamerat këtu. Në një gjyq penal ndodh që një sekuencë 20.- 30 sekonda, 5 minuta shihet dhe i kërkon që kjo provë të këqyret nga një trupë gjyqësore e ne jemi kuazi gjyqësore. Po bëja një matematikë, sikur ne t'i marrim 222 qendra për 12 orë t'i shikojmë para KAS-it, duke llogaritur 8 orë në ditë pandërprerje t'i shikojmë na duheshin 333 ditë pune, që duke i shumëzuar me festat, me ditët e pushimit, i bie që ne të mbarojmë këqyrjen këtu në KAS besoj për 2 vjet. Pra, ju e kuptioni dhe kërkesat, e kisha për avokatin, duhet të jenë proporcionale.

**Z. F. Nuri:** Prandaj edhe ne, i nderuar, i kërkuam që të na vihen në dispozicion, se ajo ishte alternative ose ju.

**Z. K. Bele:** Pavarësisht se është në të drejtën tuaj të keni dyshime të arsyeshme, të merrni të gjitha provat, të keni çdo lloj pretendimi.

**Z. B. Himçi:** Pa diskutim, por edhe ky afat të paktën 1 ose 2 ditë, besoj se nuk është i arsyeshëm. Pse e them këtë? Për aspektin, sepse do të pretendohet jo vetëm shikueshmëria, por edhe marrja e asaj pjese filmimi, për t'jua vënë juve të gjitha në dispozicion si prova të përbledhura të çdo lloj shkeljeje që ka ndodhur, në çdo qendër votimi, në qoftë se kemi pikërisht nga provat që neve do t'jua sjellim dhe do t'jua vëmë në dispozicion, që t'i keni edhe juve në mënyrë të përbledhur. Kështu që nuk është vetëm thjesht pamje filmike për ta parë në vazhdimësi, por kërkon edhe

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

një operim teknik nga jonë për t'jua vënë ju në dispozicion si prova konkrete dhe pa ju munduar shumë. Ju faleminderit!

**Z. E. Lako:** Meqë jemi këtu te kërkesat për prova dua t'ju rikujtoj edhe një herë që edhe në praktikën e vet KAS-i, edhe në marrjen e provave patjetër që do të ezurohet pjesa e pretendimeve tuaja konkrete. Pra, ju duhet të keni një pretendim konkret për filan QV dhe të keni një indicie për këtë provë që kërkon dhe pastaj do të vazhdohet me marrjen e provës, nuk mund të kërkohet apriori që ne duam të hapim gjithë QV-të e Elbasanit, sepse kjo është e pamundur, është e palogjikshme dhe nuk ka kuptim për disa arsy. I gjithë procesi zgjedhor është i ndërtuar mbi bazën e vetëkontrollit. Pra, që në Komisionin e Qendrës së Votimit, pastaj kalon te Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor, pastaj vjen në KQZ. Pra, të gjithë mekanizmat ligjorë, që ka përcaktuar ligji, ju keni të drejtë t'i përdorni gjatë gjithë procedurës, që do të thotë se duhet të ketë një shënim të libri i protokollit në qendrën filan të votimit apo gjatë numërimit të votave në KZA, dhe kjo është një indicie, nuk mundet tani të kërkon ju që duam të hapan të gjitha, se ne mendojmë se kushedi se çfarë është bërë. Kjo nuk është kërkesa e argumentuar dhe nuk është ndjekur në praktikën e KAS-it, prandaj nëse ju keni ndonjë provë, ndonjë indicie konkrete, na e vini në dispozicion që ne ta shohim, sepse nuk mund të thuhet që ne duam të hapët i gjithë qarku pas nja një muaji, të shohim dhe po pati ndonjë gjë ta shohim, se nuk funksionin kështu.

**Z. F. Nuri:** Jo, thjesht një saktësim. E para, ka të bëjë vetëm me Bashkinë e Elbasanit dhe jo me qarkun, por ne kemi kërkuar, i nderuar, kamerat brenda qendrës së votimit. Pra, nuk kemi kërkuar të hapan, domethënë kemi kërkuar kamerat sikundër kemi kërkuar dhe për bashkitë e tjera dhe faktikisht na janë vënë në dispozicion, edhe për Kamzën, të gjitha teorikisht edhe për Belshin, edhe për Rrogozhinën etj, etj,

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt. 01.06.2023*

**Z. E. Lako:** Që e keni kërkuar dhe ju vihet në dispozicion është normale, po në procedurën e ankimit duhet të ketë një indicie dhe një pretendim konkret siç keni thënë në ankım, për shembull, në filan QV kam këtë pretendim dhe kjo duhet argumentuar dhe për këtë duhet marrë prova, se nuk mund të marrim ne dhe të shohim këtu 1 muaj filmim, se as nuk është në procedurë, as nuk është se s'kemi çfarë të bëjmë tjetër.

**Z. F. Nuri:** Prandaj i kërkuam kohë. E para të na vihen në dispozicion njëherë, se nuk na e vunë farë në dispozicion kamerat, dhe kamerat ishin vetëm pika e parë e kërkesës sonë. Ndërkohë për të gjitha kërkesat e tjera, sikundër u bë edhe dje me Kamzën, nuk na është kthyer përgjigje as me shkrim, nga aspekti teknik, po flas, nga KQZ –ja. Pra, për arkitekturën e sistemit, për akseskontrollin, për *times terms*, paternat, etj, etj, që terma teknikë, që edhe unë nuk jam në gjendje t'i identifikoj ndoshta si jurist dhe si avokat, por nga ana e KQZ –së ne kemi bërë kërkesën që të paktën të na vihet me shkrim edhe këto gjëra, këto përgjigje ose këto të dhëna dhe fatkeqësisht asnjë nga këto nuk na është vënë në dispozicion. Pastaj ju do ta gjykon kohën e nevojshme, dhe ju do ta vendosni kohën e nevojshme që mund të na duhet, po të paktën na e vini në dispozicion. Faleminderit!

**Z. I. Rusmali:** E para, një herë të gjithë bashkë duhet të mbajmë në mendje faktin që afati në dispozicion të KAS-it, për shqyrtimin e këtyre kërkesave ankimore është 10 ditë. Ne sot jemi në ditën e 10-të, për shqyrtimin e kësaj, është e shkruar në ligj ky afat, nuk po e nxjerrim nga xhepi, është i shkruar në ligj, brenda 10 ditëve duhet të jepet vendimi, dhe kjo është çështja e parë. Çështja e dytë, arsyetimi juaj nuk është shumë i justifikueshëm ose ndoshta dhe nuk është fare i justifikueshëm. Kërkesa

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

ankimore ngrihet mbi bazën e fakteve të qëmtuara nga procesi, që do të thotë se ditën që jeni ulur për të shkruar faktet i keni pasur dhe përvëç fakteve keni pasur ditën që jeni ulur për të shkruar kërkesën ankimore edhe një mori provash, mbi të cilat keni arsyetuar ligjërisht për shkeljet. Pa fakte dhe pa prova kërkesa është spekulim për këdo, jo për ju. Çdo njeri që ulet të shkruajë një kërkesë ankimore pa fakte dhe pa prova është duke spekuluar. Ju, jam i sigurt s'e keni bërë këtë gjë, që do të thotë se faktet dhe provat i dispononi. Tani ju për të qenë korrekt me të gjithçka, po kërkoni dhe një provë shtesë, që është ajo e filmimeve nga qendra e votimit, një provë shtesë, e cila mund të vlejë për të përforcuar pretendimet tuaja të bazuar mbi fakte dhe prova. Kjo është situata që kemi?

**Z. B. Himçi:** Inderuar, jam plotësisht dakord për aq sa parashtroni që...

**Z. I. Rusmali:** Jo, vetëm më thuaj, a është kjo situata apo s'është kjo situata?

**Z. B. Himçi:** Jo, nuk është prandaj po them.

**Z. I. Rusmali:** Nuk është kjo.

**Z. B. Himçi:** Të lutem, jo, përderisa më jepni fjalën, unë pa nisur gjysmën e fjalisë nuk mund të më ndërprisni.

**Z. I. Rusmali:** Të bëra një pyetje, të nuk dhashë fjalën. Zoti Himçi, të lutem shumë, të bëra një pyetje nuk të dhashë fjalën, po pres përgjigjen e pyetjes që të nxjerr konkluzionet e mia. Është kjo situata që keni, apo nuk është kjo?

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt. 01.06.2023*

**Z. B. Himçi:** Më lini ta parashtroj pyetjen tuaj.

**Z. I. Rusmali:** Më thuaj po ose jo, që të vazhdoj arsyetimin.

**Z. B. Himçi:** Nuk përgjigjem me po ose jo, sepse më lini të parashtroj, ju lutem!


**Z. I. Rusmali:** Atëherë, unë e tërheq pyetjen.

**Z. B. Himçi:** Ne jemi juristë, zotëri, dhe indicia të çon në prova.

**Z. I. Rusmali:** Hiqja pak zérin, të mbaroj unë, pastaj jepja fjalën atij! Unë e tërheq pyetjen time dhe nuk ke nevojë të përgjigjesh. Mos u shqetëso më të përgjigjesh. E rëndësishme është të kuptojmë një gjë: nuk është në praktikën e zgjedhjeve, nuk është në praktikën e këtij komisioni që të krijojë hapësira për të “peshkuar në det”. Ne nuk e kemi këtë mundësi, ne kemi vetëm 10 ditë afat, kaq është koha që ne kemi në dispozicion dhe sot është dita e fundit, prandaj unë i kërkoj komisionit të fillojmë shqyrtimin në themel, të bëjë analizën e fakteve palët, jo ne, të bëjnë analizën e fakteve dhe të provave, ashtu siç i kanë, dhe në përfundim të shqyrtimit në themel, të gjykojmë nëse ka vend për të marrë ndonjë sekuencë video, ndonjë sekuencë video, jo 220 qendra votimi shumëzim për 12 orë; ndonjë sekuencë video, që na shërben për të provuar ndonjë nga faktet e pretenduara këtu, për të cilat provat nuk na janë kompletuar. Kjo është mënyra sesi procedohet, një shqyrtim në një hetim administrativ si ky yni.

**Z. B. Himçi:** Ju faleminderit! Faktikisht për sa u përket provave, sigurisht procesi zhvillohet mbi bazën e provave, po neve gjatë argumentimit tonë kemi sjellë indicie,

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

10  


*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

që të çojnë pikërisht te prova dhe këto indicie, sigurisht, i kemi vënë në dispozicion, ku këtu kemi fotografi, të cilat operatorët, ju lutem unë ju dëgjova, mos më ndërprisni. Kemi fotografi, pamje filmike, në të cilat pikërisht operatori ka ndërhyrë në procesin e votimit. Të mos harrojmë momentin kur jemi në kushtet kur është ndikuar vota e lirë, vota individuale, vota e fshehtë, që është një liri themelore dhe kushtetuese. Kemi edhe një vendim të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2002, jua vë në dukje, nr. 169 të datës 26 korrik 2002, që është bërë rikthim i këtij procesi të votimit dhe këtu argumenti ynë është që ne të provojmë pavlefshmërinë e këtij procesi votimi, i cili është një proces sistematik që ka ndodhur në çdo qendër votimi, është një proces, i cili për shkak edhe të indiceve, që na kanë sjellë vëzhguesit tanë, operatorët kanë ndërhyrë mbi 20 herë në çdo qendër votimi, gjë që ka bërë që të ndikohet dhe të operohet në një votim të diktuar dhe jo në një votim individual dhe normal. Ne kishim pretendimin që votimi elektronik do të sillte një avantazh karshi votimit me fletë votimi, por që realisht në gjykimin tonë për shkak të këtyre indiceve që kemi, na kanë sjellë, në këtë lloj situate që ne jemi sot para KAS-it. Akoma më tepër ne po kërkojmë që në funksion të këtyre indicieve të na vihen prova në dispozicion, sepse ne këto prova nuk i administrojmë, këto janë prova të administruara nga KQZ-ja. Tani ne i kemi kërkuar të na i verë në dispozicion. Janë në mënyrë të padiskutueshme dakord me ju, që unë nuk do të kem dëshirë t'ju vë pamje filmike për 222 qendra herë 12 orë, por ne themi: na jepni këto pamje filmike, të marrim pikërisht ato shkelje dhe t'ju japim sekuencat e caktuara, ku mund t'jua vë në dispozicion. Këtë po ju kërkojmë. Në qoftë se do të flasim për një proces të rregullt ligjor dhe të paanshëm, besoj se provat duhen të na vihen në dispozicion nga KQZ-ja. Edhe në funksion të Kodit të Procedurave Administrative i takon administratës të na i vërë në dispozicion këto. Ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. L. Braho:** Faleminderit! Një pyetje të fundit, para se të tërhiqemi për vendim. Pra, ju pretendoni se në të 222 qendrat e votimit ka pasur problematika ditën e zgjedhjeve dhe ju i keni indicet, thjesht, ju duhen filmimet që këtë ta provoni te KAS-i, se me indicie se provoni dot, po ju duhen pjesët e filmimeve. E kuptoj.

**Z. F. Nuri:** Po, patjetër, filmimet janë, i nderuar, pjesë...

**Z. L. Braho:** Jo, ideja është që i kërkoni të 220-ta, sepse ju pretendoni që te 220-ta kanë pasur shkelje. 222, po

**Z. F. Nuri:** Shkelje të tipit, votim familjar, për shembull, votim i shumëfishtë, ndihma e jashtëligjshme e asistentit, etj.

**Z. L. Braho:** Po, zoti Rusmali.

**Z. I. Rusmali:** Unë kam nevojë të di: 220 indicet që keni ju, mund të na i jepni, të na i vini në dispozicion 220 indicet, për secilën qendër votimi.

**Z. B. Himçi:** 222 indicet janë mbi bazën e dëshmive personale të çdo vëzhguesi, që kanë paraqitur para kandidatit dhe para personave të tjera.

**Z. E. Lako:** Unë mendoj që çfarë indiciesh kanë dhe çfarë argumentesh kanë, t'i parashtrojnë, t'i dëgjojmë dhe në fund të vendosim pastaj që a kanë nevojë për marrje prova shtesë, se kështu me deklarata...

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt. 01.06.2023*

**Z. L. Braho:** Këtë e diskutojmë ne kur të tërhiqemi për vendimin dhe pastaj shohim do ta vazhdojmë apo do ta pezullojmë. Po, zoti Çefa.

**Z. E. Çefa:** Kam një pyetje për të dyja palët, edhe për palën ankuese, por edhe për administratën. Për efektshmëri, ndoshta nuk e di, ky është një mendim imi, nëse do të jetë i mundur të realizohet, më thoni ju: a mund të fillojmë pjesërisht duke i vënë në dispozicion një kampion prej 20 qendrash votimi, filmimet, që t'ia jepni brenda ditës së sotme, në mënyrë që ne të kemi mundësi, por edhe ata vetë të kenë mundësinë që të paktën në një numër të caktuar qendrash të shohin fenomenet si janë dhe nëse do të ketë problematika, do të shërbejë edhe për ne, por edhe për ata vetë për të marrë një vendim më të saktë për ta ndërprerë kërkimin apo për ta vijuar kërkimin më tej. Pra, ky është një kompromis që unë propozoj, gjithmonë nëse pranohet. Për efektshmëri kohe.

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë do të duhet që ne të kemi 8 hard disqe të jashtëm, që të japim çdo 12 orë. Jo një hard disk me 10...

**Z. L. Braho:** Çfarë ka ndodhur nga data 25 deri sot...

**Z. Y. Merkaj:** Duhen hard disqe të ndryshëm...

**Z. L. Braho:** Pse nuk ia keni komunikuar, apo ia keni komunikuar dhc ata nuk i kanë sjellë? Tani të jemi të ndershëm me këtë, ata kanë bërë një kërkësë, në qoftë se ajo pajisje nuk i plotëson kriteret, është shumë e drejtë.

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

13  


*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt. 01.06.2023*

**Z. Y. Merkaj:** Zoti Braho, janë 5200 qendra votimi, jo 11 qendra votimi. Janë 18 parti që i kërkojnë të gjitha njëkohësisht. Nuk mund të bëjmë dot.

**Z. L. Braho:** Nuk i kanë kërkuar 18 parti, se këto që kanë ardhur këtu...

**Z. Y. Merkaj:** Nuk i kanë kërkuar 18 parti, i kanë kërkuar 5, 6, 7 parti.

**Z. L. Braho:** Këto që janë me ankim në KAS duhet t'u jepet prioritet dhe duhen sqaruar të paktën, kjo pajisje nuk e nxë.

**Z. Y. Merkaj:** Këtyre që janë me ankim në KAS u kemi dhënë prioritet.

**Z. L. Braho:** Dakord. Duhen sqaruar palët, se ja ku jemi tani, ai thotë unë nuk di gjë, po pret pajisjet. Po, zoti Nuri.

**Z. F. Nuri:** Faleminderit, i nderuar relator! Vetëm një sqarim të vogël se tani na u hap edhe kjo çështja e pajisjeve. Ditën që është depozituar kërkesa, nga administrata na u tha që do të rregulloni pajisjen. E kemi vënë në dispozicion sa më shpejt, morëm një pajisje që mjafton, del e tepron se është 10 terra. Nuk na u tha më me asnjë lloj komunikimi elektronik apo me telefon nëse pajisja mjaftonte apo nuk mjaftonte, sikundër u vu re edhe më herët në këtë seancë që nga KQZ-ja nuk na u refuzua dhënia e kamerave, pra ne kishim pritshmëri të ligjshme, të paktën të kishim marrë një pjesë. Unë nuk kam reshtur thuajse çdo ditë duke soliticuar administratën e KQZ-së për vënien në dispozicion qoftë edhe pjesërisht të kamerave të Elbasanit. Për Kamzën u vunë pjesërisht në dispozicion, 10% e kamerave dhe mjaftuan të sillnin prova të mjaftueshme në dispozicionin tuaj, sikurse e patë edhe dje në dosje në disa

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

A4

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt. 01.06.2023*

qendra votimi, por meqë po përmend edhe Kamzën, dje na rezulton që nga dëshmia e kandidatit që unë kam nuk është thënë një gjë e vërtetë në seancë, sepse nuk janë vënë fatkeqësisht në dispozicion të gjitha kamerat. Zoti Hoxha pretendon, dhe ma ka ngritur mua këtë shqetësim, që janë vënë në dispozicion një pjesë e qendrave të votimit dhe jo totalisht siç u tha këtu nga administrata e KQZ-së, dhe madje jo filmime të plota. Ka qendra votimi me minuta filmimesh. Kështu që kjo problematikë është goxha e madhe.

**Z. L. Braho:** Dakord! Ka ndonjë pyetje tjetër? Nuk ka. 10 minuta tërhiqemi në lidhje me kërkesën për kohë lidhur me provat.

*Rifillon seanca*

*Ora 13:14*

**Z. L. Braho:** Çelim seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesë ankimore nr. 85. KAS, pasi u tërheq për vendim në lidhje me kërkesën për prova, vendosi që të vijojë seancën duke dëgjuar parashtrimet nga pala ankimore dhe më tej të shprehet në lidhje me provat e kërkuar, duke bërë edhe lidhjen e provave me pretendimet që ngrihen në ankım. Ndaj ju ftoj të vazhdoni me parashtrimet e kërkesës ankimore.

**Z. F. Nuri:** Faleminderit, i nderuar relator! Unë këtu përpara jush kam kërkesën ankimore me numër protokolli dhe me datë. Ne me matematikën si parti nuk është se kemi qenë shumë mirë, por mua këtu më del që është data 24 maj e depozituar. Afati 10-ditor kur përbushet sipas jush? 24 maj, sot është data 1 qershor. Në gjykimin tim, jemi në ditën e shtatë.

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt. 01.06.2023*

**Z. L. Braho:** Ne nuk morëm ndonjë vendim për afatin 10-ditor.

**Z. F. Nuri:** Thjesht për sqarim.

**Z. L. Braho:** Dakord. Faleminderit!

**Z. F. Nuri:** Mendoj që mjafton edhe koha ligjore për ta gjykuar. Gjithsesi, objekti i ankimit është që ne kundërshtojmë vendimin nr. 539, datë 20.5.2023 për Bashkinë Elbasan të marrë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe pa u zgjatur kërkojmë pavlefshmërinë e zgjedhjeve në të gjithë Bashkinë Elbasan dhe përsëritjen e tyre. Kemi paraqitur edhe në seancën e kaluar disa elemente lidhur me legitimimin, kurse për sa u përket shkeljeve të pretenduara, ne jemi të bindur që në të gjithë Bashkinë e Elbasanit, në të gjitha qendrat e votimit ka pasur shkelje të Kodit Zgjedhor, shkelje masive të neneve 106, 107 dhe 108, votim familjar, votim i shumëfishtë, asistim i personave nga vëzhguesit, nga komisionerët apo nga personeli që duhet të asistonte personat në kundërshtim flagrant me ligjin dhe dispozitat urdhëruese të Kodit, të cilat cenojnë jo vetëm integritetin e procesit në mënyrë të përgjithshme, por më konkretisht cenojnë votën personale të personave, cenojnë votimin e fshehtë dhe ka ndikuar në mënyrë sistematike tek zgjedhësit. Raste konkrete që ne kemi paraqitur janë për shembull rastet e disa qendrave të votimit, ku edhe pajisja elektronike në vlerësimin tonë, PEVN-ja ka pasur probleme të theksuara. Për shembull, në qendrat e votimit nr. 2345 shkolla “De Rada”, qendra e votimit nr. 2373/1, nr. 2377, nr. 2358, nr. 2477, nr. 2423, nr. 2483 dhe nr. 2481/1, ku nga të dhënat që na kanë ardhur nga vëzhguesit dhe njerëzit që ne kemi pasur, pavarësisht se në gjysmat e qendrave të votimit nuk kemi pasur vëzhgues zyrtarisht, janë votuar, është shtypur butoni me numrin rendor 2 në favor të zotit Luçiano Boçi dhe fleta e votimit është printuar me

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

numrin rendor 1, duke shkuar për kandidatin e Partisë Socialiste. Raste të votimit gjithashtu për zotin Luçiano Boçi ne e kemi vënë re që pajisja ka pasur vonesa të pashpjegueshme gjatë kryerjes dhe procesit të votimit elektronik apo problematika në lidhje me printimin e atyre kuponave të votimit, vonesa në printim, ngecje e aparatit në printim, që këtë edhe vetë KQZ-ja e ka konstatuar, që aparati ngec herë pas here në printimin e fletëve. Pranë shtabit tonë elektoral të koalicionit “Bashkë Fitojmë” kemi administruar denoncime të shumta dhe të panumërtë, ku votuesit nuk kanë arritur dot të kryejnë votimin deri në fund, sepse nuk merrej komanda “Printo”, pavarësisht komandës që mund të ishte dhënë dhe nga ana e komisionerëve tanë, aty ku kemi pasur komisionerë në ato pak qendra, kemi konstatuar parregullsi të shumta, ku ka pasur votim të orientuar, ka pasur shoqërim të personave në qendrat e votimit deri brenda qendrës së votimit nga patronazhistët dhe persona që nuk duhet të rrinin fare aty; ka pasur votim në shkelje totale të procedurave të Kodit Zgjedhor, ku persona që nuk kishin fare autorizim, as të shënuar në protokoll, kanë shoqëruar persona të tjerë për t'i asistuar e për të votuar në emrin e tyre, persona që nuk kanë pasur probleme fizike, për shembull, në kundërshtim me dispozitat 106, 107 dhe 108 të Kodit Zgjedhor janë asistuar nga persona të tjerë të tretë gjatë votimit. Ka pasur raste kur operatorët janë përzgjedhur në kundërshtim me pikën 12, kriteret e përzgjedhjes së tyre, sepse kanë pasur marrëdhënie pune me kandidatët, konkretisht një pjesë, sikurse e kemi parashtruar, e këtyre operatorëve në Bashkinë e Elbasanit kanë qenë të punësuar të vetë bashkisë dhe, duke qenë se kandidati i Partisë Socialiste rikandidonte, ai njëkohësisht ishte edhe kandidat në detyre, ndaj gjykojmë që ka pasur konflikt interesi në mjaft qendra. Problem tjetër që kemi konstatuar dhe ka ndikuar në rezultat, në vlerësimin tonë, është ajo që e shprehëm, shoqërimi i votuesve nga komisionerët apo nga operatorët e qendrave të votimit, në shumicën e rasteve këta kanë qenë punonjës të administratës vendore ose qendrore. Nga të

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

dhënati që ne kemi marrë, ka rreth 50% të votuesve në qendra të caktuara që kanë votuar me shoqërim pa asnjë lloj dokumenti ose justifikimi ligjor për të qenë përjashtim, sepse votimi i asistuar dihet që është përjashtim dhe inkuadrohet mjaft strikt nga Kodi Zgjedhor. Gjithashtu, kemi pasur edhe probleme të tjera, të cilat janë evidentuar, madje ne kemi bërë edhe kallëzim penal si koalicion. Një ditë para zgjedhjeve ASHK-ja e Elbasanit, në gjykimin tonë, ka qenë hapur dhe aty janë shpërndarë certifikata legalizimi apo leje legalizimi ose certifikata pronësie, janë të pasqyruara në televizionet lokale ose kombëtare, bëhet fjalë për ditën e shtunë 13 maj, dita e heshtjes zgjedhore; ka pasur presion të vazhdueshëm ndaj votuesve, intimidim, përveç shoqërimit të votuesve deri në qendrën e votimit. Rastet konkrete, që kemi edhe emrat konkretë që i kemi denoncuar dhe i kemi sjellë në këtë ankım janë për shembull qendra e votimit nr. 2328, me kryetare komisioni shtetasen D.M, punonjëse e Bashkisë Elbasan, e cila në kundërshtim flagrant me Kodin Zgjedhor, nenin 39, pika 2, shkronja “b”, ka qenë pjesë e komisioneve, që nuk duhet të ishte; shtetasi K. H dhe shtetasi E. Sh kanë qenë vëzhgues në këtë qendër votimi, ndërkohë që janë të dy policë bashkiakë të Bashkisë Elbasan në kundërshtim edhe këta më Kodin Zgjedhor kanë qenë vëzhgues aty; në qendrën e votimit nr. 2355 shtetasi E. C, emëruar kryetar komisioni, ndërkohë që ky është punonjës i teatrit, që varet nga bashkia, teatri “Skampa”; në qendrën e votimit nr. 2351 kemi anëtarë komisioni shtetasen A. Q dhe shtetasin U. Q, punonjës të administratës së Bashkisë Elbasan, edhe kjo në kundërshtim me nenin 39 të Kodit Zgjedhor. Në qendrën e votimit nr. 2352 anëtarë i komisionit G.P punonjës i Bashkisë së Elbasanit gjithashtu. Pra, kemi evidentuar mjaft raste dhe gjykojmë që nga këqyrja e kamerave që do të na vihet në dispozicion, do të arrijmë të identifikojmë akoma më mirë punonjës bashkiakë, punonjës të administratës, të cilët kanë punuar si anëtarë komisioni në komisionet e votimit atë ditë në Elbasan në kundërshtim me ligjin. Theksojmë që ne nuk kemi

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

pasur vëzhgues në të gjitha qendrat e votimit, kështu që vënia në dispozicion e këtyre elementeve, i kamerave të votimit, kamerave 360 gradë, do të na jepte mundësinë që t'i verifikonim më mirë të gjitha këto shkelje, të cilat do t'i pasqyrojmë jo vetëm në KAS, jo vetëm në Kolegin Zgjedhor, po qe nevoja ose në Gjykatë Kushtetuese, por edhe në prokurori. Gjithashtu, një shkelje tjeter që ne kemi konstatuar është mosrakordimi i shifrave të fletëve të votimit të kandidatit me ato të këshillit bashkiak Elbasan nga vetë tabelat e miratuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Kjo është e çuditshme dhe e pashpjegueshme për gjykimin tonë, sepse kemi të bëjmë me votimin elektronik, ku nuk mbyllt procesi i votimit nëse personi nuk e përmbyll votimin në të dyja aspektet, si në votimin për kryetar, ashtu edhe në votimin për këshill. Po nuk i dha komandës “përfundo votimin”, nuk printohen fletët e votimit. Ndërkohë, çuditërisht na ka rezultuar zyrtarisht, sipas të dhënave që ju si KQZ na keni vënë në dispozicion, se në Elbasan figurojnë 65713 vota të gjendura në kutitë e votimit për këshillin bashkiak, ndërkohë që për kryetar bashkie ka një diferençë dhe janë saktësisht 65612. Pra, nuk arrijmë ta shpjegojmë këtë mopërputhje shifrash, se i bie që në disa qendra votimi fletët ose janë tjetërsuar ose nuk janë printuar, sepse nuk mund të ketë dëmtim të fletës së votimit në votimin elektronik si rregull, nuk ka si t'i nxjerrë dikush jashtë qendrës së votimit ato edhe të donte. Kjo është një dilemë e madhe që të na sqarohet këtu nga administrata, përpos faktit që votimi elektronik prodhoi një rezultat me 3 orë e gjysmë vonësë, edhe ai rezultat i pjesshëm që edhe ne kemi dyshime të arsyeshme se çfarë mund të ketë ndodhur gjatë gjithë kësaj kohe. Shkurtimisht, për t'i përmbyllur parashtrimet e mia e pastaj do t'ia lë fjalën zotit Himçi, ne kërkojmë vetëm zbatim të nenit 136, pika 3 e Kodit Zgjedhor. Parashtrojmë kërkesën tonë për marrjen e provave sipas shkronjës “c”, pika 1 të këtij nenit, nëse do të mbështetet nga dy anëtarë të KQZ-së, ne kërkojmë që të administrohen edhe nga vetë KQZ-ja provat e kërkuara dhe në kërkesën tonë që ka

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

të bëjë me rinumërimin dhe rivlerësimin e votave në të gjitha qendrat e votimit të Bashkisë Elbasan, të këqyren votimi dhe të konstatohet si është kryer votimi elektronik me fletët që rezultojnë në kuti dhe më pas të shprehet KQZ-ja, pra KAS-i në këtë rast, edhe në lidhje me pavlefshmërinë. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Pra, zoti Nuri, ju kërkesës suaj i shtuat edhe kërkesë për rivlerësim dhe rinumërim, apo ka qenë te kërkesa fillestare kjo?

**Z. F. Nuri:** Ka qenë pika 6, i nderuar, identike si e Kamzës.

**Z. L. Braho:** Dakord. Po, zoti Himçi.

**Z. B. Himçi:** Faleminderit! Unë doja të ndalesha në tri momente shumë të rëndësishme të të gjithë kësaj që parashtroi zoti Nuri. Së pari, në KZAZ-në nr. 47, që u përket njësive administrative të fshatit, në 76 PENV, që janë pajisjet e numërimit elektronik të votimit, konsistoj që kur janë depozituar në KZAZ, faktikisht 76 prej tyre kanë qenë pa vulë sigurie kur kanë arritur, janë mbajtur të gjitha në procesverbalet e KZAZ-së. Një moment i dytë është, Franci e përmendi, por doja ta sqaroja më shumë, po të mbledhim votat për kryetar bashkie të të dy kandidatëve plus votat e pavlefshme në total janë 65612 sipas listës që ka paraqitur KQZ në listën përbledhëse dhe përfundimtare, që është shpallur fitues kandidati i Partisë Socialiste. Nga ana tjetër, në qoftë se mbledhim të gjitha votat e partive, që është votuar për këshillin bashkiak plus votat e pavlefshme shkojnë në 65713, pra ka një diferencë 101 vota, të cilat nuk rakordojnë. Është e pamundur që të mos votohet në faqen e parë dhe të dilet në faqen e dytë, dalin 101 vota më tepër, gjë që për ne mbetet e paspjegueshme dhe na lind dyshimi i arsyeshëm që në këto pajisje

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

ka problematika, të cilat ne do të kërkonim t'i konfirmonim. Pjesa tjeter, në dy qendrat e votimit nr. 2481/1 dhe nr.2483, që i përkasin njësisë administrative Shirgaj, ka pasur një mosrakordim midis përbledhëses që ka nxjerrë pajisja elektronike e votimit kur ka përfunduar procesi i votimit dhe asaj që ka transmetuar në KQZ. Normalisht, kur është bërë përbledhësja e KQZ-së nga ana e sekretares së Përgjithshme të KQZ-së është intimiduar kryetari i KZAZ-së duke i kërkuar të vinte e të firmoste përbledhësen e tyre, sepse e tyrja nuk ishte e vlefshme, ka këmbëngulur që jo dhe në fund fare KQZ-ja, pavarësisht situatës së çfarë kishte transmetuar, ka miratuar përbledhësen e saj që ishte në KZAZ. Ka një mosrakordim midis fletës përbledhëse të këtyre dy qendrave, për të cilat ngrë dyshim përsëri të arsyeshëm, pajisja duhet të transmetonte po të njëjtat të dhëna, jo të dhëna të ndryshme midis transmetimit KQZ dhe fletës përbledhëse të printuar nga vetë pajisja elektronike e votimit.

**Z. I. Rusmali:** Më fal, që po të ndërpres, cila është marrë në konsideratë, e dhëna print, apo e dhëna e transmetuar?

**Z. B. Himçi:** Në përfundim, pas një debati treditor, është marrë në konsideratë përbledhësja e KZAZ-së dhe jo e KQZ-së, nga vetë KQZ-ja.

**Z. I. Rusmali:** Përbledhësja print, ajo që ka dalë nga makina.

**Z. B. Himçi:** Përbledhësja print dhe jo ajo e transmetimit, por ky ka qenë një debat treditor, pavarësisht rezultatit përfundimtar, përsëri ky është një shqetësim, për të cilin ngremë dyshimin e arsyeshëm që pajisjet elektronike ndoshta në pjesën e vendosjes së algoritmit apo të instalimit të softwer-it ne jemi të paqartë se cila

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt. 01.06.2023*

kompani ishte, është që e ka instaluar pajisjen e softwerit: A ka qenë e certifikuar ndërkombëtarisht? A ka qenë me certifikatë sigurie për ta instaluar këtë softwer për t'i dhënë një garanci votimit dhe qytetarëve? Por, mbi të gjitha, disa nga pamjet filmike, të cilat ne i kemi pasur nga vëzhguesit dhe komisionerët, të cilët janë të pakta në numër, ose jo nuk i kemi sistematike për çdo qendër votimi, sepse nuk lejohej pajisja, fotografimi në qendrat e votimit, na rezulton se operatoret e pajisej elektronike të votimit që në pjesën më të madhe, i nderuar kanë qenë ose anëtarë të Partisë Socialiste, që kanë aplikuar, ose anëtarë të Forumit Rinor Eurososialist të Shqipërisë. Në të gjithë pjesën më të madhe, pra në 99% të rasteve kanë qenë këto persona, të cilët realisht nuk kanë respektuar, atë që KQZ pretendonte të ishin të paanshëm në këtë proces votimi dhe të ishin qytetarë që duhej të operonin pranë KQZ-së, por janë marrë në total. Këto persona kanë ndikuar në procesin e votimit, në mënyrë të drejtpërdrejtë, prandaj kërkojmë administrimin e pajisjeve, jo për t'ju vënë dhe për ta zvarritur këtë proces, sepse, edhe ju ashtu si ne, kërkojmë një përgjigje sa më të shpejtë, por pa diskutim ta përdorim si provë për t'ju bindur ende më shumë juve si trupë të KAS-it ku qëndrojnë pretendimet tona dhe nëse janë të vërteta apo jo. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Faleminderit, zoti Himci! Fjala për përfaqësuesin e palës së interesuar, Partia Socialiste e Shqipërisë.

**Z. M. Legisi:** Faleminderit! Të nderuar anëtarë të KAS-it, sipas tabelave të miratuara nga KSHZ-ja, me vendimin objekt ankimi, rezulton se diferenca ndërmjet kandidatëve për kryetar bashkie është, pra përllogariten 8073 vota ndërsa për këshillin bashkiak është 17 654 vota. Tani, duke parë edhe këtë lloj rezultati dhe mënyrën e parashtrimit të faktave dhe argumentimit të shkeljeve nga ankuesi, ne

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*


vlerësojmë se janë të pabazuara në prova. Një pjesë e mirë e shkeljeve, siç janë lejet e legalizimit, apo punësimet, apo intimidimi i shtetasve, i zgjedhësve apo konflikti i interesit janë shkelje që nuk lidhen aspak me procesin e votimit të zhvilluar në qendrën e votimit, dhe rrjedhimisht këto janë edhe të papranueshme. Sa i përket shkeljeve të tjera të pretenduara ne vlerësojmë që nuk e ka ndikuar aspak procesin zgjedhor dhe rezultatin përfundimtar të votimit. Në këtë kuptim jemi për rrëzimin e kërkesës. Sa i përket marrjes së provave ne sigurisht, Partia Socialiste si subjekt zgjedhor e ka deklaruar dhe më përpara që jemi për transparencë dhe në rastin konkret ne jemi që të hetohet sipas kërkesës së ankuesit, pastaj, në lidhje me thellësinë e këtij hetimi, se deri ku do të shkojë me një ose dy kuti material zgjedhor apo fletë votimi, e vlerëson vetë KAS-i si trupë. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Faleminderit, zoti Legisi! A ka pyetje? Kam një pyetje për administratën në lidhje me këtë diferencën midis votave për këshill bashkiak dhe kryetar bashkie. Ne nuk e dimë procesin saktë, si është, pra fillimi votohet për kryetar bashkie, pra tek e njëjta pajisje votohet edhe për kryetarin edhe për këshillin? Pra, çdo votues voton tek e njëjta pajisje? Dhe a është e mundur që të zgjedhësh vetëm kryetarin apo vetëm partinë dhe pjesën tjetër të mos votosh? Pra, nëse ka ndonjë shpjegim tjetër kjo diferenca?

**Znj. D. Alimemeti:** Diferenca nuk ka lidhje me, diferenca ka lidhje me gabimin e hedhjes ose, le të themi, me bashkimin e procesit të transmetimit me procesin manual. Ajo është problematika që ne kemi evidentuar. Kjo do të thotë sidomos në zonën 47, në KZAZ-në 47 kemi pasur probleme me transmetimin e të dhënavë. Ky transmetim ka qenë për një numër shumë të vogël të dhënash, prandaj është filluar të hidhet manualisht informacioni. Hedhja manuale e të dhënavë ka pasur

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

23



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

problematikat e veta dhe kjo është arsyaja pse rezultojnë këto gabimet dhe diferencat në votat për kryetar dhe në votat në këshill, por, në sistem, ose, le të themi, të dhënrat që janë marrë, votat për këshill dhe votat për kryetar janë të njëjta, do të thotë në sistem, vlerësimi elektronik në fund të procesit, votat përputhen dhe janë të njëjtat le të themi.

**Z. L. Braho:** Sot, nëse i referohemi tabelës përbledhëse të miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve numri i votave është i barabartë mes këshillit dhe kryetarit?

**Znj. D. Alimemeti:** Po, numri i votave me këshillin dhe kryetarin.

**Z. L. Braho:** Një pyetje tjetër për KZAZ-në që referoi përfaqësuesi i ankimeshit, që kanë qenë të gjitha kutitë kur janë transportuar nga KQV-të në KZAZ pa vulë sigurie, a keni ndonjë informacion se për çfarë vule bëhet fjalë dhe sa e vërtetë është kjo?

**Znj. D. Alimemeti:** Jo, ne kemi mbledhur të gjitha procesverbalet nga KZAZ-ja që referohen me lidhjen ose me identifikimin e vulave të sigurisë, gjithashtu, kemi ruajtur dhe kemi administruar kutitë, edhe kutitë shoqëruese, edhe kutitë PEVN, janë identifikuar dhe janë administruar vulat me kodet e sigurisë me të cilat kanë hyrë në magazinën tonë. Do të thotë të bëhet një vlerësim i qartë i elementëve që mungojnë ose problematikave që mund të ketë pasur në pjesën e sigurisë. Të tëra janë të evidentueshme.

**Z. L. Braho:** Po në lidhje me atë pretendimin tjetër për mosrakordim të asaj se çfarë printon pajisja me ...

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Znj. D. Alimemeti:** Jo, kjo mund ta provojnë. Kemi instaluar një pajisej vetëm thjeshtë për ta parë dhe për ta testuar nëse do të duan zotérinjtë, megjithëse kjo ftesë është bërë edhe më përpara që në testimin e funksionaliteteve le të themi përpara zgjedhjeve. Sistemi ose pajisja në momentin që, pasi mbaron të dyja proceset për kryetar dhe për këshillin bashkiak printon dy kuponët e votës dhe aty mbaron procesi. Çdo qytetar ka mundësi të zgjedhë një alternativë aty, që nuk zgjedh asnjë nga kandidatët, që të kthehet automatikisht në votë të pavlefshme. Ky është i gjithë procesi, i cili është i thjeshtë i qartë, lehtësisht i kuptueshëm dhe për qytetarët, është i kollajshëm. Gjithsesi mund ta provojnë mund ta shohin.

**Z. L. Braho:** Nuk e kisha për këtë, unë e kisha për atë që pajsija ka printuar rezultat tjetër dhe transmetimi ka qenë me rezultat tjetër për ato dy qendrat e votimit që thatë.

**Znj. D. Alimemeti:** Jo, nuk është bërë transmetimi i të dhënave, ajo zonë për të cilën flet zotëria, është larg, ka kaluar transmetimi me *usb*, do të thotë transmetimi online i të dhënave, dhe duhet të bëhej transmetimi i të dhënave me anë të *usb-së*, nuk e di si është, në KZAZ mbështetje nuk janë kaluar të gjitha *usb-të* dhe vlera e kësaj QV-je kishte dalë zero, le të themi, ndërkohë që ët dhënat nga printimi, të dhënat nga kutitë flisnin për të tjera rezultate. Kjo ishte problematika.

**Z. L. Braho:** Po.

**Z. I. Rusmali:** Ju thatë pak më parë që për shkak të defekteve në transmetim, pamundësisë jo defekteve, pamundësisë për të transmetuar një pjesë e të dhënave

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

janë hedhur në sistem manualisht. Në këto dy QV, që kuponi ka shifër tjetër dhe sistemi ka shifër tjetër, a mund të ketë ardhur defekti për shkak të hedhjes manuale?

**Znj. D. Alimemeti:** Për këto dy QV, besoj se jo sepse e kemi verifikuar disa herë.

**Z. I. Rusmali:** Kjo do të thotë që ju kur thoni se shifra ka qenë zero jeni e sigurtë, që shifra ka qenë zero?

**Znj. D. Alimemeti:** Në çfarë ka sjellë KZAZ-ja për...


**Z. I. Rusmali:** Jo, ju lutem për këto dy qendra, ose keni verifikuar këto dy QV dhe dini gjithçka për to, ose...

**Znj. D. Alimemeti:** Jo, po flasim...Jo për këto dy QV.

**Z. I. Rusmali:** Po flasim për këto dy QV. Për këto dy QV, pala thotë ka pasur debat në nivel KZAZ-je, lidhur me shifrat e dy QV-ve dhe debati ka qenë dhe i ashpër dhe ka gjurmë për debatin, apo jo? Është shkruar në librin e protokollit, është dhënë zgjedhja nga KZAZ-ja duke marrë rezultatin e printit si rezultat zyrtar. Këtë thonë ata. Ju thoni diçka tjetër, tani si mund t'i bashkojmë të dyja?

**Znj. D. Alimemeti:** Jo, po përpinqem të sqaroj procesin. Pjesa e transmetimit nuk ka funksionuar në këto QV. Ky është fakt. Është hedhur manualisht me dorë informacioni. Dhe ky është fakt. Është hedhur informacion për këto dy QV. Nga sistemi nuk është marrë informacion, sistemi nuk është lexuar dhe ka pasur të dhëna zero dhe kjo është diferenca dhe prandaj është debatuar. Do të thotë ata kanë

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

76  


*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

printuar, në KAZA, kanë printuar raportin që u ka dhënë sistemi me zero vota, po flasim për sistemin elektronik. Ndërkohë ne kemi dy, kemi pjesën e sistemit të votimit elektronik, ama kemi edhe totalin, sistemin total i cili na bën aggregimin e të gjitha të dhënavëve dhe ne përdorim..

*(Diskutime pa mikrofon)*

Të transmetuar.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Dhe aggregimin për zonat e tjera jo vetëm për bashkinë e Elbasanit.

**Z. I. Rusmali:** Më duket se po na jep informacion më shumë se sa na duhet ne dhe po na ngatërron. Të lutem, shumë reduktoje informacionin. Makina në këto dy QV ka printuar një rezultat. Ky rezultat është hedhur manualisht ku?

**Znj. D. Alimemeti:** Në sistemin tonë, qendor.

**Z. I. Rusmali:** Qendorin, dakord, është hedhur manualisht në sistemin tuaj qendor dhe ato zotërinjëtë kanë lexuar të dhënën e sistemit qendor të ndryshme nga e dhëna. Çfarë do të thotë e zeruar, kur e dhëna ekziston në sistemin qendor?

**Znj. D. Alimemeti:** Nuk është hedhur, ose nuk është kaluar *usb*-ja, është procedurale ose ka një gabim teknik.

**Z. I. Rusmali:** Të lutem, mos i kalo hapat realisht na bën konfuz përfajin tonë jo tëndin, sepse jemi në që e kemi të vogël aftësinë përfshirë të kuptuar. Kur janë hedhur manualisht të dhënat kanë hyrë në sistem, pra u futën, janë brenda, si u bënë zero?

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

  
27

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Znj. D. Alimemeti:** Flasim për dy sisteme, këtë po përpinqem të sqaroj.

**Znj. I. Rusmali:** Na mbaj këtu që të sqarojmë gjënë. A është i vërtetë fakti apo nuk është i vërtetë?

**Znj. D. Alimemeti:** Hedhja e të dhënave në sistemin qendror është bërë manualisht. Po përpinqem të sqaroj këtë proces.

**Z. L. Braho:** Ai që shohim ne online atë ditë, dhe që vazhdojmë ta shohim edhe sot, ai është që hidhet manualisht? Ajo që del te aplikacioni i KQZ-së?

**Znj. D. Alimemeti:** Po. Ai është.

**Z. L. Braho:** Pra aty hidhen manualisht. Pra, çfarë do të thotë manualisht, ajo që ka printuar pajisja i është dërguar dikujt për ta hedhë, dhe e ka hedhur gabim. Po kjo me zero?

**Znj. D. Alimemeti:** Kjo me zero është kalimi i informacionit në KAZA, nëpërmjet *usb*-ve. Vetë sistemi bën aggregimin e të dhënave të të tjerë votimit elektronik. Pra, kemi dy pjesë. Unë po përpinqem të sqaroj se kemi dy pjesë.

**Z. I. Rusmali:** Edhe njëherë të tabela e KAZA-së ka dalë zero? Te tabela e KAZA-së ka dalë zero para se të miratohej tabela?

**Znj. D. Alimemhmeti:** Po.

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Çfarë ndodhi pastaj, si u bë shifër?

**Znj. D. Alimemeti:** Në momentin që kanë ardhur dhe këtu u diskutua me stafin e KZAZ-së për të rivlerësuar dhe për të marrë në konsideratë vlerën e vërtetë që ka pasur votimi. Kjo do të thotë treguan printimet dhe u tregua nga sistemi dhe thamë që kjo është problematikë.

**Z. I. Rusmali:** Dakord. Tani, zero pse u bë? Çfarë ndodhi që u bë zero?

**Znj. D. Alimemeti:** Nuk janë vendosur. Procedura është e tillë. Më lejoni të sqaroj procedurën. Në fund pasi mbaron transmetimi të gjitha makinat kthehen në KZAZ dhe fillon dhe bëhet kalimi manual i çdo *usb*-je. Thamë që në fillim të herës që *usb*-të mbanin të dhënat e votave, çdo pajisej ka *usb*-në e vet. Hidhen në një laptop, i cili është i qendërzuar, është i lidhur me sistemin qendro5 dhe ka akses të reduktuar vetëm për hedhjen e këtij informacioni në një drejtim dhe merr dhe përpunon këto të dhëna.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ky është një miniserver në KZAZ, vetëm për të mbledhur votat.

**Z. L. Braho:** Ky rezultati i *usb*-së a përputhet me rezultatin e printimit nga makineria?

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Z. I. Rusmali:** Pse u bë zero?

**Znj. D. Alimemeti:** Sepse nuk është vendosur *usb*-ja për këto dy qendra votimi.

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** A e dini pse nuk u vendos *usb*-ja?

**Znj. D. Alimemeti:** Këtë nuk e themi dot.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Jo, kalimi manual prandaj bëhet që të hiqet elementi i transmetimit. Do të thotë bëhet kalim manual, është si të kopjosh, si të kalosh informacionin nëpërmjet internetit radhën e parë dhe radhën e dytë si ta kopjosh nga *usb*-ja ta kalosh direkt nga *usb*-ja në një laptop, në një server.

**Z. I. Rusmali:** E qartë. Tani, a mundet vetëm këtë sekuencë zoti Himci, mos na shpërndaj edhe ti se 5mbytemi, vetëm këtë sekuencë, përjetimit tuaj për kaq.

**Z. B. Himçi:** Tani unë iu referova dy qendrave të votimit, që është 2481/1 dhe 2483, që është Shirgja, distanca nuk është shumë e largët, është ngjitur me qytetin si njësi administrative, jo ashtu, siç pretendon përfaqësuesja e KQZ-së, por, pavarësisht pjesës së transmetimit, unë nuk kam qejf të merrem me pjesën e transmetimit, unë di të them këtë që së pari, nuk ka qenë zero. Ka qenë ka pasur dhe qendra votimi me transmetim zero nuk e kemi ngritur këtë pretendim për 2477-ta njësia administrative Shushicë, po pikërisht për ta orientuar, kurse këtu ka pasur disproporcion të hedhjes së të dhënavë midis fletës përbledhëse të printuar nga pajisja dhe asaj që është marrë me *flesh* siç pretendon dhe hedhur manualisht. Pra, nuk jemi në situatën zero, jemi me shifra të ndryshme.

**Z. K. Belo:** A kuantifikohet dot ky disproporcion, pra është një votë, a është një gabim njerëzor apo është një votë, apo janë 100 vota?

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. B. Himçi:** Ka qenë një diferencë e konsiderueshme, i nderuar, pra 20, 30 unë nuk e di. Pra, kjo ka qenë pjesë e luhatur. Po, po kjo ka qenë, ka luajtur me 20-30 vota pra diferenca midis *flesh*-it dhe diferenca midis printimit që ka bërë pajisja. Në këtë pikëpamja ky ka qenë dhe debati midis kryetarit të KZAZ-së, që ishte përfaqësues i forcës sonë, dhe sigurisht midis përfaqësuesve të KQZ-së të cilët kërkonin atë që kishte *flesh*-i dhe jo fletës së printuar. Kjo ishte mbajtur në procesverbal dhe ky ka qenë një debat gati 3 ditor pasi ishin depozituar pajisjet. Thjesht për t'jua svaruar vetëm kjo ishte. Kam edhe diçka, një pyetje.

**Z. I. Rusmali:** Prit se do t'jua bëj unë pyetjen, që të mbyllim këtë gjënë njëherë. Ky debat treditor a është i pasqyruar në librin e protokollit, në dijeninë tuaj?

**Z. B. Himçi:** Shiko, ishin depozituar të gjitha materialet zgjedhore në këtë moment. Në KZAZ nuk është pasqyruar por ka qenë një debat i vazhdueshëm të cilët kryetari i KZAZ-së ka dalë më pas edhe në deklaratë për shtyp, pasi është kërcënuar se do t'ju çojmë dhe për ndjekje penale.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, a di të na thuash pse nuk është pasqyruar në librin e protokolleve?

**Z. B. Himçi:** Po sepse diskutimi ka qenë thjeshtë telefonik verbal, i nderuar nga përfaqësuesit e KQZ-së.

**Z. I. Rusmali:** Pra, nuk ka qenë përfaqësuesit në mbledhje?

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

B1  


*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. B. Himçi:** Po, do të thotë janë mbledhur për ta diskutuar, por nuk ka pranuar ta firmosë kryetari i KZAZ-së.

**Z. I. Rusmali:** A ka një vendim, se ju na thatë ne se ka një vendim?

**Z. B. Himçi:** Vendimi përfundimtar ka qenë mbi bazën e fletës së përgjithshme. Këtë vendim ka marrë KZAZ-ja.

**Z. I. Rusmali:** Këta vendosën të injorojnë *usb*-në dhe të pasqyrojnë fletën, printimin. Kështu na thatë ju? A ka ndonjë vendim për këtë KZAZ-ja?

**Z. B. Himçi:** Po ka.

**Z. I. Rusmali:** A e ka të shkruara?

**Z. B. Himçi:** Po e ka të pasqyruar në protokoll dhe ka thënë. Do të thotë në vendimin e tyre është konkretizuar.


**Z. I. Rusmali:** Ju e dispononi?

**Z. B. Himçi:** Jo nuk e disponojmë. Do të thotë është në librin e protokollit.

**Z. I. Rusmali:** Dakord. E mora përgjigjen.

**Z. B. Himçi:** Edhe një diçka. A mund të bëj një pyetje, për ta sqaruar edhe ne veten me përfaqësuesit e KQZ-së?

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

37  


*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. L. Braho:** T'i mbarojmë ne njëherë pyetjet dhe pastaj. Tani, a mund të ndodhë kjo që materiali në *usb* të jetë i ndryshëm nga printimi që bën pajisja?

**Znj. D. Alimemeti:** Jo, nuk ndodh. Nuk është vendosur *usb*-ja. Ka dy elemente.

**Z. L. Braho:** Nëse nuk vendoset i bie të jetë zero. Nuk është më rezultat.

**Znj. D. Alimemeti:** Por duhet të kemi parasysh një gjë. Çdo QV ka pasur dy makina. Problematikat kryesore kanë qenë, ka kaluar një makinë, nuk ka kaluar makina tjeter. Po flas vetëm për zonën 47, ku kemi pasur probleme me transmetimin. Do të thotë një QV, ka pasur dy makina dhe mund të jetë pasqyruar gjysma e rezultatit. Kjo është ajo çfarë po i referohet zotëria për momentin, ose si e kuptoj unë. Nuk ka lidhje. *Usb*-ja përmban ato të dhëna

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

33  


*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Znj. D. Alimemeti:** ...të cilat janë printuar, kjo është e sigurt.

**Z. L. Braho:** Këtë dua të kuptoj dhe unë a është e njëjta gjë që tha apo

**Znj. D. Alimehmeti:** Është gjithmonë e njëjta gjë.

**Z. L. Braho:** Pjetja tjetër, këto hidhen të gjitha dhe manualisht apo ato që nuk transmetohen.

**Znj. D. Alimehmeti:** Ato që nuk transmetohen ishin hedhur manualisht dhe u përpoqëm, shikoni është hera e parë që ne bëjmë procesin për kaq shumë Qendra Votimi dhe u përpoqëm që ta kishim të dhënën sa më shpejt që të ishte e mundur dhe të gjithë ky informacion që morëm u përoqëm që ta hidhnim, të ecnim paralelisht, le të themi, me operatorët për ta pasqyruar rezultatin paraprak në kohë sa më të shkurtër. Kjo solli problematika, siç duket.

**Z. I. Rusmali:** Pse hera e parë?

**Znj. D. Alimehmeti:** E shtrirë në 401 Qendra Votimi është hera e parë, manaxhimi i tërë informacionit në 401 operatorë të ndryshëm për të ardhur dhe për të manaxhuar të tërë këto është, do të thotë kapacitetet dhe puna që duhej bërë ishte goxha.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, çdo herë që përdoret do jetë hera e parë se do jenë më shumë.

**Znj. D. Alimehmeti:** Jo, ideja është...

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Pyetja që kam unë është, meqënsëse the hera e parë, përdoret për herë të parë transmetimi i të dhënave në to?

**Znj. D. Alimehmeti:** Po.

**Z. I. Rusmali:** Dakord! Përdoret transmetimi i të dhënave për herë të parë. Herët e tjera, dy herët e tjera nuk ka pasur transmetim të dhëna, është operuar vetëm me formën manuale, nga USB-ja në Lap Top, ka qënë kjo.

**Znj. D. Alimehmeti:** Po, keni të drejtë.

**Z. I. Rusmali:** Nuk keni një rezervë lidhur me operatorët e ...operatorët janë përgjedhur me konkurim? Kush është procedura e përgjedhjes së operatorëve?

**Z. B. Himçi:** Procedura e përgjedhjes ka qënë thjesht aplikimi në KQZ.

**Z. I. Rusmali:** Dakord.

**Z. B. Himçi:** Online dhe nga ato dilnin fituesit.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, në gjykimin tuaj, çuna të forumit rinor të Partisë Demokratike që të kenë aplikuar dhe të mos jenë përgjedhur ka patur?

**Z. B. Himçi:** Po, ka patur.

**Z. I. Rusmali:** I kemi të kuantifikuara këto raste?

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. B. Himçi:** Tani të kuantifikuara nuk i kemi konkretisht, por di që nga KQZ-ja mund tju japi dhe pjesën të cilët kanë aplikuar personat.

**Z. I. Rusmali:** Përザgjedhjen e bën KQZ-ja apo kompania private?

**Z. Y. Merkaj:** Jo, KQZ-ja e ka bërë pérザgjedhjen.

**Z. I. Rusmali:** E bën KQZ-ja.

**Z. Y. Merkaj:** Ka qënë aplikim, ku kanë aplikuar, janë plotësuar vendet dhe kaq. Në momentin që janë plotësuar vëndet është mbyllur.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, po si i pérザgjedhni ju? Kanë ardhur 200 veta ju duhen 100, si merni 100 nga 200 veta? Çfarë kriteri përdorni? Pyetja ishte tronditëse.

**Znj. D. Alimehmeti:** Kryesisht ka qënë shkollimi.

**Z. I. Rusmali:** Kriter shkolla.

**Znj. D. Alimehmeti:** Kryesisht, intersi i parë ka qënë le të themi që të kenë patur shkollën, arsimin e lartë, por jo detyrimisht sepse jo, me sasi të Elbasanit ka qënë 223 Qendra Votimi operatorë.

**Z. I. Rusmali:** Sa aplikantë keni patur gjithsej nga Elbasani? S'e gjeni dot. E gjeni dot?

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Znj. D. Alimehmeti:** Po, patjetër.

**Z. I. Rusmali:** Mirë, zoti Himçi, ju na thatë për një numër anëtarësh komisioni që kanë qënë bashkëpunonjës bashkie, do të thotë në kushtet e konfliktit të interesit sipas ligjit, keni identifikuar një pjesë, besoni se mund të jenë më shumë por nuk keni siguri në se janë më shumë. Për këtë një pjesë që keni identifikuar keni kryer procedura kontestimi, në sensin keni deklaruar KZAZ-së ose KQZ-së, Komisionerit, që këta persona janë në kushtet e konfliktit të interesit dhe duhen liruar, duhen shkarkuar.

**Z. B. Himçi:** I nderuar, ne nuk kemi patur informacion brenda KZAZ-së cilët ishin se s'kishim si të administronim listën e komisionerëve, nuk na vihet në dispozicion.

**Z. I. Rusmali:** Ju merrni pjesë në procedurat e KZAZ-së, e para, e dyta ju

**Z. B. Himçi:** Marrim pjesë për administrimin e zgjedhjeve jo për të përcjell anëtari i KZAZ-së të na sjelli informacion kë kemi komisioner.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, nuk ka funksionuar kështu, por kur e keni marr vesh këtë fakt, mbas

**Z. B. Himçi:** E kemi marrë vesh nga informacioni gjatë procesit të ditës së votimit.

**Z. I. Rusmali:** Gjatë ditës së votimit, dakord.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. Y. Merkaj:** Sepse në Qendrën e votimit ka patur një operator dhe një operator që përdor dhe paisjen PEI, dhe një operator që përdor dhe paisjen PVN, dy operatorë, domethënë 200 Qendra Votimi janë 400 operatorë. Ne kemi patur vështirësi në gjetjen e tyre për t'u plotësuar.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, por sa aplikime ishte pyetja. Domethënë keni emëruar 444 apo 446, sa kanë qënë aplikimet? 76 makina kanë qënë pa vulë sigurie, si e keni konstatuar këtë fakt?

**Z. B. Himçi:** Në momentin kur kanë ardhur nga përfaqësuesit nga Komisionerët e QV-ve dhe janë dorëzuar materialet zgjedhore, njëkohësisht janë depozituar pranë KZAZ-së dhe paisjet PVN, në këtë rast nga është bërë kqyrja e paisjes nga komisioni dhe është mbajtur me procesverbal që këto kanë qënë pa vulën e sigurisë, pra kutia duhej të mbyllej me vulë sigurie nga të gjithë komisionerët e Qendrave të Votimit gjë që nuk ka ndodhur. Nga 202 që ka patur KZAZ 47, 76 rezultojnë pa vulë sigurie.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, dispononi kopje të këtyre procesverbaleve?

**Z. B. Himçi:** Janë në KQZ ato prandaj them, kopjet nuk i kemi marr, nuk është procesverbal por ato janë hedhur në librin e protokolleve të mbajtura që ka vërejtje komisioni, pra është një libër protokolli i posaçëm, nuk është procesverbal i veçantë që ndahet në kopje.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, zoti Merkaj, a është procesverbal i veçantë, pyetja e parë, dhe e dyta

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. Y. Merkaj:** Nuk ka asnjë shënim të procesverbalit në librin e protokollit të KZAZ-së, grupet e marrjes në dorëzim janë bërë nga dy anëtarë të cilët kanë qënë të forcave të ndryshme politike, nuk ka patur asnjë vërejtje gjatë marrjes në dorëzim, nuk kanë bërë shënime as anëtarët e Koalicionit Bashkë Fitojmë.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, kjo përgjigjja mohuese është pas verifikimit që keni bërë posaçërisht për këtë.

**Z. Y. Merkaj:** Po po, ja e kemi librin e protokollit të KZAZ-së, po e lexoj, po e shikoj edhe

**Z. I. Rusmali:** E kuptoj në rregull. Zoti Himçi mund të na jepni ju listën e Qendrave të Votimit?

**Z. B. Himçi:** I nderuar ne kemi në formën e fotografisë sepse është mbajtur me fotografi nga Kryetari i Komisionit të KZAZ-së.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, të lutem zoti Himçi, i dhe përgjigje Yllit jo mua. Tani që e ke me fotografi nuk është gjë e keqë është gjë e mirë, pyetja ishte listën e Qendrave të Votimit, 76 Qendrave të Votimit që preken nga ky fenomen ose dhe më pak se janë 2 makina për Qendra Votimi, mund të jenë dhe më pak Qendra Votimi, e keni ju?

**Z. B. Himçi:** Si listë me emra të posaçëm të mbajtura nuk e kemi, thashë, domethënë nuk e kemi të përcjellë sepse

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** E gjeni dot?

**Z. B. Himçi:** Të administrohet nga ana juaj libri i protokollit.

**Z. I. Rusmali:** Kjo është çështje tjetër, ju nuk e keni listën dhe nuk e identifikoni dot?

**Z. B. Himçi:** Nuk mund ta identifikoj, thashë e kam thjeshtë vetëm në mënyrë fotografike por duke pretenduar që ta administroj si provë, dhe të ishteë e vlefshme si provë, pikërisht për këtë arsyе i qëndruam kësaj situate.

**Z. I. Rusmali:** Tani dua të bëj një pyetje, që mund të duket sikur të kam inat, por nuk të kam inat. Me rinumërimin dhe rivlerësimin e votave çfarë kërkonit të provoni?

**Z. B. Himçi:** I nderuar, pyetje shumë e drejtë dhe shumë e bukur, e nisëm pak me aciditet por në fund fare e gjejmë gjuhën e përbashkët, s'ka asnje lloj problemi si elbasanllinj që jemi.

**Z. I. Rusmali:** Hajde hë, tani fole tamam.

**Z. B. Himçi:** Atëhere, në situatën e parë gjithë qëllimi ynë është, panvarësisht shkeljeve që zakonisht ka pretendimë në çdo lloj procesi ankimor dhe zgjedhor, nuk mund të jemi në situatën e një procesi perfekt, por për të thënë të drejtën që ka patur një ndikim sistematik në çdo Qendër Votimi nga operatorët e paisjeve elektronike të votimit ku konsideroj që personat të cilë ishin mbi 50 vjeç, në pjesën e pasigurisë dhe njohjes së pakët të votimit elektronik, sigurisht kanë kërkuar asistencë, ndihmesë

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

për të votuar. E kanë kërkuar vet apo i është orjentuar unë këtë nuk mund ta them, por di që ka në mënyrë specifike në Kodin Zgjedhor ku thuhet që pamundësia duhet të jetë vetëm fizike për të asistuar dhe jo pamundësi intelektuale. Fizike që duhet të nënkuqtojmë o ska dorë, o nuk shikon, vetëm në këto lloj rastesh duhet të mbahej shënim në procesverbal për tu shoqëruar me një familjar të tij, gjë e cila në këtë rast nuk ka ndodhur. Por sigurisht di të them që në mënyrë sistematike të orjentuar dhe të mirëmenazhuar, duke qënë dhe në ndërlidhje partiake me votuesit, me Partinë Socialiste, padiskutim ka ndikuar në mënyrë persistente do të thoja, në procesin e votimit. Sigurisht unë iu referova dhe në diskutimin e mëparshëm, një vendimi të 2002-shit nga Gjykata Kushtetuese, sepse atëhere nuk kishte as Kolegj Zgjedhor, as KAS. Sigurisht ai vendim i Gjykatës Kushtetuese riktheu dhe e quajti të pavlefshëm procesin e votimit. Qëllimi ynë kryesor është pavlefshmëria e votimit, sesi mund të dilte rezultati unë nuk mund të them, por di të them që votimi në të gjithë procesin e tij ka ndikuar negativisht në të drejtën kushtetuese të lirisë së votës, të fshehtësisë së votës, dhe votës individuale. Vetëm këto tre elementë i kanë munguar këtij votimi për zgjedhjet lokale në Bashkinë Elbasan.

**Z. I. Rusmali:** Zoti Himçi, rinumërimi i votave

**Z. B. Himçi:** Nuk kam dëshirë të merrem më shumë me rinumërimin sesa

**Z. I. Rusmali:** Pyetjen e kishim te rinumërimi i votave. Rinumërimi i votave vlen si mjet prove vetëm në rast se egziston dyshimi që rezultati në kutinë e votimit është i ndryshëm nga rezultati i nxjerrë nga makinat. Ju e keni këtë dyshim?

**Z. B. Himçi:** Po, e kemi.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Mund të na e shtjelloni këtë çështje?

**Z. B. Himçi:** I nderuar, po, mund t'ua shtjelloj dhe po deklaroj, gjatë procesit të votimit ne kemi patur Komisioner i cili votoi për Luçiano Boçin dhe në printim i doli emri Gentian Llati. Tani unë nuk kam qënë prezent se vota ka qënë individuale, por ai ishte jashtëzakonisht i shqetësuar dhe doli dhe në deklaratë për shtyp. Ka dalë në media në orën 12 të drekës, ende pa dalë rezultati i votimit, se mund të pretendonim që mund të ishte një situatë që, dëgjo këto humbën edhe tani hajde të nxjerrim sa më shumë argumenta. Anëtar komisioni, i cili deklaronte i shqetësuar, më pas kemi patur, dhe kjo ka qënë në Qendrën e Votimit, mos gaboj, 23 73/1, ka qënë në lagjen Partizani. Më pas edhe në Qendrën e Votimit, mos gaboj,

**Z. I. Rusmali:** Ma përsërit dhe një herë se,

**Z. B. Himçi:** 23 73/1, unë do ju kërkoja që ajo paisje i nderuar, jo ta shohim kështu, ne kemi kërkuar gjithsej 6 paisje të cilat kemi dyshime të arsyeshme, të cilët pretendimet nga votuesit tanë të sigurt na kanë thënë që kanë votuar Luçianon, dhe unë them që këto Qendra Votimi me këto paisje që kanë qënë aty të provohen të paktën nga ekspert, qoftë të brendshëm, qoftë të caktuar dhe nga ana juaj, që të shohim, domethënë ai softëear është i instaluar, ka një algoritëm të caktuar për të nxjerr atë sasi votash që pretendohet apo...

**Z. I. Rusmali:** Më duket se kaluam në një temë tjeër, me fal zoti Himçi, më duket se kaluam në temë tjetër. Për t'i qëndruar temës së rinumërimit dhe rivlerësimit, ju keni një rast denoncimi që është bërë publik, të një personi që thotë kam votuar tjetër gjë

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

dhe më ka dalë tjetër gjë në kuti. Të lutem zoti Himçi, dhe ky denoncim publik është në analizën tuaj, tregon që rezultati elektronik, mund të jetë i ndryshëm nga rezultati fizik. Të paktën kjo është për një Qendër Votimi për të cilën ka një deklaratë publike. Drejtoresha do na thotë, se do na e thotë se na e ka thënë dhe dje, që nuk ka asnje lloj mundësie që të ketë dallim midis rezultatit elektronik, nga rezultati fizik. Ju doni prapë se prapë ta bëni provën.

**Z. B. Himçi:** Ne kërkojmë të bëjmë provën dhe themi në 7 Qendra e kemi kërkuar nuk e kemi kërkuar në 222 Qendra, 7 në të cilat u ngritën këto pretendime nga

**Z. I. Rusmali:** Jo, jo, deri tani kërkesa është për 222 Qendra.

**Z. B. Himçi:** Jo, jo kemi qënë për pamjet filmike, të qartësohem, ju lutem.

**Z. I. Rusmali:** Kush janë këto 7 Qendra.

**Z. B. Himçi:** 7 Qendrat janë 23 73/1, 23 77, 23 58, 24 77, 24 23, 24 83, 24 81/1.

**Z. I. Rusmali:** Duan rinumërim për 7 Qendra Votimi, tani t'ja mbaroj dhe pyetjen e fundit unë. Domethënë për një Qendër Votimi ju kishit një denoncim publik nga Komisioneri juaj.

**Z. B. Himçi:** Te Qendra Votimit 23 73/1.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, për këto Qendrat e tjera nga i keni të dhënët që ka diskordancë.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. B. Himçi:** Po ju jap 24 23-shin.

**Z. I. Rusmali:** Mi jep të gjitha.

**Z. B. Himçi:** Dakord, 24 23-shi ka votuar dhe bashkëshortja e Komisionerit dhe nëna e Komisionerit kanë patur po të njëtin pretendim. Sigurisht që ne nuk e bëmë shumë publike. T'ju them diçka? E di pse nuk e bëmë publike? Sepse mund të ndikonte negativisht te votuesi dhe mund të kishte një moment te votuesi jonë i cili të thoshte ‘kjo është e përcaktuar’...

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Për një qendër votimi ju kishit një denoncim publik nga komisioneri juaj...

**Z. B. Himçi:** Po, tek qendra e votimit 2373/1, i nderuar!

**Z. I. Rusmali:** Dakord! Për këto qendrat e tjera nga i keni të dhënët që transmetuat?

**Z. B. Himçi:** I nderuar, mund t'ju jap 2423-shin.

**Z. I. Rusmali:** Mi jep të gjitha.

**Z. B. Himçi:** Po jua jap 2423-shi ka votuar edhe bashkëshortja e komisionerit dhe nëna e komisionerit, kanë pasur po të njëjtin pretendim. Sigurisht që ne nuk e bëmë shumë publike. T'ju them diçka?! E di pse nuk e bëmë publike, sepse mund të ndikonte negativisht tek votuesi dhe mund të ishte një moment tek votuesi jonë, i cili thoshte kjo është e përcaktuar...

**Z. I. Rusmali:** E qartë, tjetër!

**Z. B. Himçi:** Për dy qendra të tjera 2483 dhe 2481/1, janë dy qendra të cilat diskutuan për pjesën e procesit të transmetimit që ishte objekt i diskutimit tonë.

**Z. I. Rusmali:** A janë këto dy qendrat e votimit!

**Z. B. Himçi:** Po. Dhe 2477 i nderuar, është në Shushicë dhe kjo në njerën qendër...

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Shushica e bën të veçantë?

**Z. B. Himçi:** Ka qenë në transmetim, atë që zonja u shpreh dhe tha që njëra doli me 0 (zero) dhe tjetra doli me votim që kandidati kishte marrë vetëm 13 (trembëdhjetë) vota dhe nëntëdhjetë e ca vota ka marrë kandidati Gledian Lladja, 13 (trembëdhjetë) ka marrë Luçiano Boçi. Pjesa tjerët pra PVN-ja tjetër ishte 0 (zero) dhe mbi bazën e kësaj që thuhet që nuk u transmetua sepse duhet闪hi, na lindi dyshimi i arsyeshëm që të hetohej dhe kjo sepse diferenca ishte jashtëzakonisht e madhe në votim...

**Z. I. Rusmali:** Dakord, po nga ana tjetër e nxorri rezultatin.

**Z. B. Himçi:** Po e nxorri por sigurisht prap diferenca midis dy votuesve domethënë midis dy kandidatëve ishte goxha e lartë dhe goxha e thellë.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, po këto qendrat e tjera?

**Z. B. Himçi:** 2377-a i përket lagjes “Vullnetari” dhe këtu kemi pasur një rast që përsëri komisioneri ka votuar dhe ngriti po të njëjtin pretendim.

**Z. I. Rusmali:** Po kujt ja ka ngritur pretendimin?

**Z. B. Himçi:** Na e ngriti ne si shtab...

**Z. I. Rusmali:** Dakord, kemi tre qendra votimi që pretendimi ka ardhur tek shtabi.

*Zbardhi materialin audio*

*Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. B. Himçi:** Po, tek shtabi, tek ne!

**Z. I. Rusmali:** Jo dy qendra votimi!

**Z. B. Himçi:** Kemi mbajtur shënim... na e ngriti si shqetësim gjatë ditës së votimit!

**Z. I. Rusmali:** Që pretendimi ka ardhur tek shtabi. Po dy qendrat e fundit çfarë problemi kanë?

**Z. B. Himçi:** J'ua thash i nderuar, të gjitha j'ua preka!

**Z. I. Rusmali:** 2373/1 dhe 2358?

**Z. B. Himçi:** 2373-shi ju thashë që ishte deklarata e vetë personit mediatikisht.

**Z. I. Rusmali:** Prit se e kam shkruajtur dy herë. Atëherë 2358... cfarë problemi ka?

**Z. B. Himçi:** Madje për dy orë e kemi ndërprerë votimin aty sepse ishte rast i parë. 2358 i përket lagjës “Kongresi Elbasanit” dhe këtu jemi në po të njëjtën situatë ku anëtari i Partisë Demokratike ka votuar dhe na ka përcjellë përsëri këtë shqetësim në shtab.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, për momentin skam pyetje...

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. B. Himçi:** Dhe një diçka tjetër i nderuar, pse themi për pajisjen e votimit elektronik. Sepse drejtoreshën ne e pyetëm dhe relatori zoti Braho e pyeti dhe përsëri nuk dha një përgjigje konkrete. Unë përsëri po i bëj një pyetje se nga njëra anë thotë duhet të ketë rakordim midis votave të këshillit dhe votave të kandidatit në total për atë që kanë aplikuar. Pse është kjo diferencë 101 (njëqind e një) vota? Përsëri nuk kemi bindje në total midis votave të këshillit dhe votave të kandidatit. Unë përsëri e ngrej dhe në formën e pyetjes...

**Z. L. Braho:** Në fakt drejtoresha tha që tani janë barazuar. Kjo tabela që ka miratuar Komisioneri... Se di, nëse mund ta vini në dispozicion një tabelë zoti Sekretar i Përgjithshëm?

**Z. B. Himçi:** Jo ne nga lista përfundimtare e kemi marrë... ju siguroj që e kemi marrë nga lista përfundimtare.

**Z. L. Braho:** Ja ta verifikojmë! Atëhere na jepni një tabelë, një të këshillit dhe një të kryetarit të bashkisë. Po, vazhdo!

**Z. E. Lako:** Meqë jemi tek këto, verifikimi i këtyre QV-ve që u bë edhe sqarim këtu, që ta kemi edhe ne të qartë. Garancia që ka dhënë Kodi dhe makineritë është që ti voton për subjektin dhe e shikon tek pajisja printimin e asaj që ti ke zgjedhur. Nëse printimi, (se ju thoni kemi shtypur njëshin ka dalë dyshi), nëse printimi është 2, dyshin ke shtypur ti! Do të thotë që rezultati duhet të përputhet me fiziken. Domethënë, nëse ti numëron fiziken duhet të jenë sa rezultati. Kjo është garancia! Nëse printimi të ka dalë një atëherë njëshin ke shtypur edhe nuk e zgjidhim dot këtë punë! Nuk mund të pretendosh që kam shtypur njëshin dhe doli e printuar dy.

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

Atëhere garancia është printimi. Do të thotë që ti do ta numërosh me printimin.  
Nuk të çon asgjékund ai pretendim!

**Z. B. Himçi:** Jo, të çon... I nderuar të sqaroj diçka sepse ne jemi të fushës së drejtësisë edhe unë kam qenë i kufizuar...

**Z. E. Lako:** Edhe unë jam interesuar dhe kam pyetur për këtë!

**Z. B. Himçi:** Edhe unë po j'ua shpjegoj! Këto janë sisteme të mbyllura të votimit elektronik dhe sigurisht është një montim i softwareve të cilat, pikërisht është ky programi që përcakton mënyrën se si voton. Nëqoftëse ne vendosim një algoritëm dhe softwari sidomos që ti të shtypesh do të marri pjesën e programimit të vet nëse ka një algoritëm të caktuar, supozojmë 70 me 30. Në këtë moment, në momentin që unë shtyp ka një memorie, në momentin e shtypjes dhe të krahasimit të votave. Nëqoftëse këto janë në disporcion kjo pastaj do të thotë që pajisja përmes mua, në këndvështrimin tim, është e manipuluar.

**Z. E. Lako:** Nëse ka disporcion nëpërmjet rezultatit dhe asaj fizike është kjo që dëshironi po them... por mendimi që kam shtypur një dëshirë e printuar 2 nuk provohet dhe nuk ke çfarë të shikosh, nuk ke si ta verifikosh këtë!

**Z. F. Nuri:** Zoti Lako, një ndërhyrje të vogël! Ndoshta edhe testimi i këtyre pajisjeve, pra vënia dëshirë e praktik, ndoshta KQZ-ja ka vendosur ta bëj më vonë këtë pjesë me rastin tjetër të Kamzës. Do ishte testimi pra i këtyre pajisjeve do të na lejonte të kuptionim se ku qëndron edhe problemi.

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Nëqoftëse do të mund të reagoj ndaj kësaj? Zoti Nuri testimi është një gjë shumë e mirë, por testimi nuk bëhet në procedurë ankimore, ju e dini!

**Z. F. Nuri:** Nuk po them testim, po them verifikim!

**Z. I. Rusmali:** Jo, të lutem, po i përgjigjем avokatit. Nuk bëhet në procedura ankimore. Në procedura ankimore shqyrtohen provat dhe jepen vendime. Provën për këtë pretendim, për këtë dyshim që po thoni ju nuk e dispononi. E thoni edhe vetë që nuk e dispononi... apo jo? Keni kërkuar sepse egziston një opsjon, keni kërkuar tju hapen 7 kuti sepse egziston një opsjon që të ketë diskordancë por provën. Ju nuk e dispononi!

**Z. F. Nuri:** Nëse mund të bëj një ndërhyrje provën që kompjuteri ose pajisja ka diskordancë apo ka probleme ne nuk kemi as se si ta disponojmë sepse nuk i kemi as vizikisht ato dhe as na lejohet ti analizojmë. Por për të dalë tek argumenti ndoshta juridik, besoj se dhe ligji i procedurave administrative ka të parashikuar parimin se është administrata ajo, nen 35 në mos të gaboj, pika 2, që është administrata ajo që duhet të provojë ligjshmërinë e akteve administrative.

**Z. I. Rusmali:** Jo nuk është kështu! Ky është debat ligjor. Ju këtë debat e shkruani në kërkesën tuaj ankimore, ne përgjigjen tonë e shkruajmë në vendimin tonë! Mos merremi me debate ligjore sepse harxhojmë kohën e njëri tjetrit.

**Z. F. Nuri:** Nuk diskutohet.

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** A mund ta harxhojmë kohën duke bërë pyetje? Unë kisha ndoshta edhe dy pyetje shkurt. Lidhur me, ju keni pasur komisioner në qendrat e votimit. E kam vëmendjen në dy fenomene, në fenomenin e votimit të asistuar për të cilin ju ngrini pretendimin që procedurat nuk janë zbatuar sipas ligjit dhe në fenomenin tjeter të prezencës së personave të paautorizuar pranë qendrës së votimit, jo në qendrën e votimit. Besoj jemi dakord, për këtë! Në qendrën e votimit janë personat e autorizuar nga ligji për të qenë aty, pranë qendrës së votimit ju keni konstatuar masivisht persona të tjerë. Pra më shqetësojnë këto dy fenomene. Lidhur me këto dy fenomene, pyetja që kam unë është a ka pasur një ndërprerje të procesit të votimit për këtë shkak në ndonjë nga qendrat e votimit dhe a keni dokumentacion për këtë ju? Kjo është pyetja e para! Pyetja e dytë, komisioneri në rastin e votimit të asistuar ka shënuar në librin e protokollit a çfarë emri ka dokumenti, kontestimin e tij për procedurën e parregullt të votimit të asistuar?

**Z. F. Nuri:** Nëse mund të përgjigjem për pyetjen e dytë dhe po lë Blendin, kolegun që të përgjigjet për pyetjen e parë! I nderuar unë gjykoj se leximi i nenit 106, 107, 108 i Kodit Zgjedhor e ka mjaft të qartë, duhet të shënohet në librin e protokollit jo vërejtja por do të shënohet autorizimi që personi i posaçëm merr për të asistuar apo për të ndihmuar dikë tjeter. Pra nuk na takon ne të sjellim provën që është kontestuar por KQZ-ja i ka të gjitha procesverbalet. Mund ti merrni në bazë të nenit 21 të Kodit Zgjedhor, si anëtar të KAS-it, ti administroni, ti kqyrni dhe të shihni votimi a është bërë me procedurën e asistuar në përputhje më parashikimet ligjore të nenit 106, 107, 108 të Kodit Zgjedhor?! Pra a është parashikuar aty me autorizim të posaçëm, një autorizim për çdo person që të shoqërojë dikë tjeter, po apo jo?! Këtë mendoj e keni ju na të gjithë mundësinë për ta parë!

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Dakord, por ju nuk i dhatë përgjigje pyetjes time. Pyetja ime ishte a ka pasur ngjarje të tilla apo jo? Ka pasur komisioner që kanë kundërshtuar zhvillimin e procedurës në mënyrë të parregullt dhe a ka lënë gjurmë kjo?

**Z. B. Himçi:** I nderuar, shumë e drejtë pyetja që bëni. Përsa i përket pjesës së ndërhyrjes tek komisionerët, ne kemi pasur vetëm një anëtar komisioni, krytari dhe sekretari i komisionit përfaqësosheshin nga forca të tjera politike, të cilët mund të ndikoheshin qoftë kryetari, sekretari i qendrës së votimit mund të bëj pezullimin e procesit të votimit. Në këtë moment ne nuk kemi qenë në kushtet e aftësisë për ta pezulluar votimin nga ana jonë sepse kemi pasur vetëm një anëtarë që ka qenë anëtari i koalicionit Bashkë Fitojmë. Përsa i përket pjesës tjetër që këruat të pyesni në dijeninë tonë nuk ka pasur dhe nuk janë mbajtur në procesverbal. Kjo qoftë edhe për çështje të kulturës juridike të komisionerit por nga ana tjetër ose mungesë trajnimi të tyre. Gjithashtu do të tha që të dhënat ne i kemi që kanë ndodhur dhe prova më e mirë do të ishte pikërisht pamjet filmike nëse do të administrosheshin nga ana juaj për tu vënë në dispozicion.

**Z. L. Braho:** Zoti Merkaj ne këtë tabelën e miratuar nga Komisioneri prap e kemi me këtë diferencën me 101 (njëqind e një) vota dhe se di a do të mund të na e shpjegoni dot ju çfarë ka ndodhur apo të presim drejtoreshën?

**Z. Y. Merkaj:** Drejtoreshën!

**Z. L. Braho:** Të na shpjegojë teknikisht se si mund të ndodhi diferenca me 101 (njëqind e një) vota!

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** E ndryshon dot drejtoresha aktin?

**Z. Y. Merkaj:** Jo ta ndryshoje, të shpjegojë pse është diferenca 101 (njëqind e një)!

**Z. L. Braho:** Dakord, atëherë do të tërhiqemi për të marrë vendimin në lidhje me provat siç e cituam dhe në fillim. Për 10 minuta besoj shpallim vendimin, faleminderi!


**Rifillon Seanca**

**Ora 14:45**

**Z. L. Braho:** Riçelim seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore numër 85 të ankimuesit, subjektit zgjedhor koalicioni Bashkë Fitojmë në lidhje me Bashkinë Elbasan. Atëherë KAS vendosi:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës në lidhje me rinumërimin e disa kutive të qendrave të votimit, më konkretisht rinumërimin dhe rivlerësimin e fletëve të votimit që janë pjesë e qendrave të votimit 2373/1, 2481/1 dhe 2483.
- Po ashtu urdhërojmë administratën e KQZ-së që ti vër në dispozicion librin e protokollit KZAZ-së 47 dhe të gjithë procesverbalet e marrjes në dorëzim të materialeve nga KQV-të drejtuar KZAZ-së pas ditës së zgjedhjeve po për KZAZ-në 47. Në këtë mënyrë i lëm mundësinë palës ankimuese që shikojë të gjithë këto procesverbale në lidhje me pretendimet që ka për mospraninë e vulave të sigurisë në pajisjet e dorëzuara nga KQV-të.
- Në lidhje me kërkesën për dhënie kohe, KAS me shumicë votash vendos ti lër kohë subjektit ankimues deri ditën e hënë në ora 12:00 përsa i përket pamjeve filmike që kërkoj për të gjitha KQV-të. Për rrjedhojë i kërkojmë dhe KQZ-së që të gjej një moment më të shpejtë për tja dhënë këto materiale në formën e duhur në mënyrë që të mos arrijmë tek afati 5 ditorë që kërkuan.

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

Tani në lidhje me rinumërimin e këtyre 3 (tri) qendrave të votimit seanca do të riçelet ditën e hënë në orën 12:00 vetëm sa i përket rinumërimir të këtyre 3 (tri) qendrave të votimit këtu në ambjentet e KQZ-së. Kështu që seancën e pezullojmë deri ditën e hënë në mënyrë që të vijojmë me rinumërimin e këtyre 3 (tri) qendrave të votimit. Seanca deklarohet e myllur.

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



**01.06.2023  
Ora 16:17**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 67 dhe 74, subjekti ankues: Koalicioni Bashkë Fitojmë dhe kandidati për kryetar i Bashkisë Kuçovë, Qarku Berat, zoti Lefter Maliqi ”.**

**PJESËMARRJA :**

- KAS: Z.Elvil Lako, Z.Elvis Çefa, Z.Ilirjan Rusmali,  
Z.Koli Bele, Z.Ledio Braho
- Staf KQZ: Z. Y. Merkaj, Z. I. Osmanaj
- Parti Politike PS (M.Legisi), BF (A. Kaziaj)
- Të tjera KRIIK, Kandidati për Bashkinë Kuçovë (L.Maliqi)  
Avokatët e zotit Maliqi (A.Llangozi, O.Serani)

**Z. K. Bele:** Përshendetje, ndjesë për vonesën! Çelim seancën për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore nr. 67 të bashkuar me kërkesën nr. 74 të Koalicionit Bashkë Fitojmë, me objekt: “Ndryshimin e vendimit nr. 101, dt. 16.05.2023 të KZAZ-së 64, Bashkia Kuçovë, Qarku Berat, për miratimin e tabelës përbledhëse të rezultateve, rinumërim dhe rivlerësim i votave për KZAZ-në nr. 64 për të gjitha qendrat”. E njëjtë kërkesë, pra ajo me nr. 74 është bërë nga kandidati Lefter Maliqi, Bashkia Kuçovë, në emër të Koalicionit. Këto dy kërkesa janë bashkuar dhe jemi në shqyrtimin në themel të tyre. Prezent është trupa e KAS-it në kuorum, administrata e KQZ-së e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm si dhe palë në proces. Për palët ankuese thjesht një prezantim për efekt procesverbali sepse ju jeni të legjitimuar.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i BF-së:** Po i nderuar zoti relator, përfaqësuesi i Koalicionit Bashkë Fitojmë Altin Kaziaj.

**Z. L. Maliqi, kandidat për kryetar për Bashkinë Kuçovë:** Kandidati Lefter Maliqi.

**Znj. O. Serani, avokate për zotin Maliqi:** Avokate Orgesa Serani, avokate për zotin Lefter Maliqi

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Maliqi:** Avokat Arben Langozi, avokat për zotin Lefter Maliqi.

**Z. M. Legisi, përfaqësues i PS-së:** Mariglen Legisi, palë e interesuar, Partia Socialiste e Shqipërisë. Faleminderit!

**Z. K. Bele:** Avokatët jeni legjitimuar në seancën paraprake apo vini sot për herë të parë?

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Maliqi:** Po jemi legjitimuar, kemi dhe prokurën, bashkëlidhur ankimit.

**Z. K. Bele:** Dakord! Ndonjë kërkesë parapake për trupën e KAS-it, përjashtim apo konflikt interes i nga na jonë? Nuk kemi. Atëherë vazhdojmë me shqyrtimin në themel të lërkesës. Për efekt te respektimit të rendit të kërkesave po ja japim fjalën përfaqësuesit të Koalicionit fillimisht. Pa ju ndërhyrë se ju e dini që unë jam partizan i të qenit shterues dhe të drejtës së pakufizuar për të thënë ato që

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

mendojmë, ju lutem të jemi konçiz sa mundemi që të arrijmë qëllimin për të cilin jemi mbledhur në këtë proces.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i BF-së:** Po zoti Bele, do të mundohemi të jemi dhe ne konçiz siçe këruat dhe juve. Pa u zgjatur përtej për sa i përket pjesës së marrjes së kohës së panevojshme dhe duke qenë se jemi përpala disa fakteve, provave që kanë të bëjnë me një masakër të themi, të ndodhur në atë që është KZAZ-ja e vetme në Bashkinë Kuçovë, pra KZAZ-ja 64, kështu që do të na lejoni që ato që kemi përgatitur, materialin tonë, kërkeshën ankimore unë kolegu Langozi dhe kolegia ti parashtrojmë përpala jush me besimin që do të kemi një vendimmarrje objektive nga ana juaj. Siç e thatë dhe ju në fjalën tuaj, ju kemi vënë në lëvizje duke kundërshtuar atë që është vendimi nr. 101, dt. 16.05.2023 i ZAZ-së nr. 64 Bashkia Kuçovë për miratimin e tabelës përbledhëse të tabelës së rezultateve për zgjedhjet për kryetarin e bashkisë duhej këruar të paktën nga ana e Koalicionit Bashkë Fitojmë rinumërim dhe rivlerësim të votave për KZAZ-në në të gjitha QV-të për shkaqet dhe rrëthanat që do të jua them më poshtë dhe që ju e keni tashmë pjesë të dosjes tuaj administrative dhe që keni administruar. Koalicioni Bashkë Fitojmë ka ardhur në dijeni të fakteve dhe indicieve dhe ka siguruar prova të mjaftueshme në kendvështrimin tonë lidhur me problematikat dhe parregullsitë që kanë ndodhur në procesin zgjedhor përpala, gjatë dhe pas, të themi në vetvete e asaj që është i téri i një procesi zgjedhor. Listojmë këtu ato që janë gjetur, parregullsitë në këtë bashki, të cilat konsistonë në problematikat vijuese. Kemi patur problematika lidhur me kamerat në pjesën më të madhe të qendrave të votimit gjatë gjithë ditës për shkak të mostrajnimit ose fshehjes të themi të atyre që janë materialet e nevojshme filmike audio dhe video, besoj më shumë video sesa audio të asaj çfarë ndodh në një qendër votimi që nga hapja e saj në orën 7:00 deri

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

në mbylljen e qendrave të votimit, pra në orën 19:00. Në kutitë e votimit për këshillin bashkiak ka patur kundërshtime nga ana e anëtarëve të GNV-së. Nga zoti Xhafer Haxhilari dhe Qazime Dardha me shënimin që nuk janë gjetur fletët e mbylljes së kutisë, as në kutinë e votimit dhe as në kutinë e materialeve, të cilat nuk ishin saktësuar saktë në procedurat përkatëse. Kutisë së materialeve nuk i përputheshin vulat. Vulat ishin të shënuara ndryshe në procesverbalin e gjetur. Procesverbali i gjetur nuk përputhej me të dhënat në vetvete. Të dhënat nuk ishin shënuar me fjali. Procesverbali nuk përbante as datat, orë të mbylljes, as numrin e QV-së. Këtu që e ben pak të paqartë se cilat ishin në vetvete detyrat e personave të ngarkuar me këto detyra dhe cila ka qene QV-ja në vetvete. Në QV-në 3417 në shkollën fillore njësia... (*nuk kuptohet*) problematika me pajisjet e PEI-t kanë qenë të shumta. Është votuar manualisht për 50 qytetarë, 45 prej të cilëve, të paktën nga indiciet që kemi ne figurojnë të jenë jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë. Do të donim të vihej në lëvizje dhe vet ky institucion nëpërmjet marries së provës, duke i bërë një shkresë Drejtorisë së Përgjithshmë për Kufijtë dhe Emigracionit me listën e personave që do të vihet në dispozicion. Njëri prej tyre është Vladimir Qemal Tomorri i datëlindjes 11.02.1955, i larguar në Greqi në datën 27.02.2023. Pra dhe shumë të tjerë siç e thashë më parë. Në qendrën e votimit 3528/1 në rrugën “Llukan Prifti” tek Teknikumi i ashtuquajturi, ka patur refuzime votimi për këshillin bashkiak nga anëtarët e GNV-së nr.3, Qazime Dardha me shënim në procesverbalin e mbylljes është gjetur i pavulosur ky procesverbal. Në QV-në 3530 përsëri te Teknikumi në kutinë e votimit për këshillin bashkiak ka patur kundërshtime nga ana e anëtarëve të GNV-së siç e thashë më sipër me shënimin që procesverbali i mbylljes është gjetur i pavulosur. Në QV-në 3525/00 shkolla “1 Maji”... quhet shkolla, ka patur votime në grup, votime jashtë qendrës, të kapur me foto nga vetë vëzhguesit, pjesë të dosjes tashmë administrative që keni pranë

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

jush. Në QV-në 3825/00, e njëjta QV ka patur votime nga persona që rezultojnë të jenë jo vtues në këtë QV. Në QV-në 3525/01, Shkolla “1 Maji” jashtë qendrës së votimit kanë kapur shumë persona të tjerë që nuk mund të rrinë dhe problematikat kanë qenë të shumta dhe me kamerat e sigurisë. Kështu që nuk ka patur siguri në qendrën e votimit, as nuk është siguruar kjo gjë as nga Policia e Shtetit të themi, për atë që është largësia prej 150 metrash, e parashikuar në aktet nënligjore dhe vetë në Kodin Zgjedhor. Votime në grup ka patur te Kopështi nr. 3, janë kapur me foto dhe vëzhgues të tjerë, të cilët fotografonin vetë personat që futeshin aty duke mbajtur analizë në cilësinë e personave patronazhist dhe duke kërkuar kështu, duke ndikuar te vota në vetvete në mënyrë që të tjetërsonin vullnetin e lirë të qytetarit për të votuar. Gjatë dorëzimit të kutive janë konstatuar parregullsi dhe janë dorëzuar dorazi vulat nga komisionerët në disa QV dhe ju i keni me foto disa vula që janë jashtë kartonave të mirëidentikuara dhe jo të futura në atë që është kutia e votimit përkatëse. Gjatë procesit të numërimit sipas protokollit të mbledhjes së KZAZ-së është mbajtur shënim gjatë procesit se në QV-në 3420/1 njoftohet KZAZ-ja që gabimisht ka dëmtuar vulat pasi është vulosur gabimisht kapaku i materialeve zgjedhore në kutinë e votimit për kryetarin e bashkisë. Duke qenë se ky kapak nuk ka çarje për lejimin e votimit janë dëmtuar vulat dhe është vendosur sërisht kapaku i kutisë së votimit në këtë qendër dhe kërkohen që dy vulat e tjera për vulosjen e kutise nuk gjenden. KZAZ vendos të pajisë QV-në me dy vula të reja me kodet 024824 dhe 024827. E njëjta gjë ndodh dhe në një qendër tjetër ku është pajisur me vulën 024823, shënnimi gjendet në librin e protokollit të QV-së përkatëse. Anëtarët e GNV-së pasi numëruan kutinë në QV-në 3416 kanë myllur zarfin pa bërë raportimet për numrin e votuesve gra dhe burra dhe për këtë arsyë vendosën rihapjen e kutisë. Rihapin dhe vendosin kode të reja në këtë rast. Në QV-në 3415 kanë myllur kutinë pa plotësuar të gjithë zërat e kërkuar në tabelën e

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

rezultateve. Kutia rihapet dhe vendosen kodet. QV-ja 3501 rihapet kutia e materialeve për mospërputhje votash dhe i jepen vulat e sigurisë. GNV nr. 3 që po numëronte QV-në 3513 konstaton se vulat e mbylljes nuk përputhen dhe njofton KZAZ-në. KZAZ-ja në fakt, për këtë fakt thotë se vulat për këshillin bashkiak nuk i kishte, ishte mbylluar. Kutia e votimit për kryetar të këshillit bashkiak vendosi të rihapte KZAZ-ja në këtë rast kutitë e materialeve. Kutisë së votimit me numër 2516 i mungon procesverbali i mbylljes. KZAZ-ja vendosi të hapë kutitë e materialeve për QV-të 3818, 3819, 3819/1. Në QV-në 3523 u konstatuan dy vota të cilat u kundërshtuan nga anëtarja e Koalicionit Bashkë Fitojmë. Pasi u mblohdh KZAZ-ja vendosi që këto vota ti quajë të vlefshme. Vota pro për 6 anëtarë dhe 1 është e kundërshtuar siç e shihni dhe në provat që i kemi vënë në dispozicion. Në 3525/3 në kutinë e kryetarit të bashkisë nuk gjendej procesverbali i mbylljes së votimit dhe për këtë arsy e rihap kutia e materialeve zgjedhore. KZAZ pajis grupin e numërimit me 4 vula të reja. Në QV-në 3516 për shkak se nuk është gjetur proceserbali i mbylljes, KZAZ vendosi pajisjen e GNV-së me 4 vula shtesë. E njëjtë gje shkon dhe për QV-në 3819/1. Në QV-në 352303 dhe QV-në 3525/1 dhe 3526 nuk janë gjetur pv-të dhe u vendos hapja e kutive dhe materialeve të votimit, Në QV-në 3516 është rihapur kutia e materialeve zgjedhore. Në QV-në 351501 GNV-ja pas kontestimit të një fletë votimi dhe me shumicë votash vlerësohet e vlefshme për Partinë Agrare Ambjentaliste. Në QV-në 3825\1 në kutinë e votimit për këshillin bashkiak procesverbali i mbylljes... është gjetur vetëm kopja pa vulën e qendrës së votimit. GNV-ja njofton për këtë anomali ose qëllimshmëri KZAZ-në, e lila vendosi rihapjen e kutisë. I jepen GNV-së 4 vula vërtet të hedhura gabimisht. Në këtë kuti, pra në kutinë e fletëve të hedhura gabimisht për kryetarin e bashkisë janë gjetur fizikisht 13 fletë votimi, por meqenëse në sistem në momentin e rihapjes së kutisë së numërimit në tavolinën nr. 1 të numërimit në sistemin

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

elektronik rezultonin 7 fletë votimi dhe është kërkuar nga anëtari i PS-së numëruesh i tavolinës por edhe nga .... të mbulojë duke i shënuar këto 4 vota mungesë sikur janë gjetur të pavlefshme. Kjo është kundërshtuar nga anëtari jonë. E keni të shënuar pjesën e kontestimit të bërë nga anëtari i BF-së. I njejti skenar i mbulimit të mosraportimit mes votave fizike dhe votave të shënuara në procesverbal ka ndodhur në mënyrë të tejskajshme në të gjitha ato që kanë qenë qendrat e votimit të ZAZ-së 64, Bashkia Kuçovë. Donim që sistemi të kontrollojë në tërësinë e vetë, të kontrolloheshin përputhshmëritë e atyre që janë dokumentacioni zgjedhor në tërësi, qoftë ai elektronik, qoftë ai fizik. Ka patur anomali dhe qëllimshmëri të karakterit shumë të rëndë jo vetëm administrativ por besojmë dhe mendojmë që persona të caktuar me detyra zgjedhore të partisë në pushtet kanë dhe përgjegjësi të karakterit penal për të cilën do të flasë avokati Llangozi pasi ti jepet fjala nga ana juaj. Theksoj se ka patur një mosrakordim në çdo tavolinë. Ka patur zhurmë të patolerueshme, persona të paautorizuar për të qenë në qendrën e votimit. Ka patur ato që mund ti quajmë kërcënime ose intimidime të vetë qytetarëve për të votuar të lirë. Ka patur intimidime të vetë anëtarëve të GNV-së, të KZAZ-së, anëtarëve që i përkasin opozitës dhe Koalicionit Bashkë Fitojmë. Në librin e protokollit është shënuar nisja e numërimit në orën 24:00, por për shkak të një shkëputjeje dhe pushimi të paarsyeshëm të disa anëtarëve të KZAZ-së, vendim i marrë nga 4 anëtarë, rrëth orës 11:15 u shty dhe në orën 12:30 ka filluar. Kjo është shënuar në librin e vendimeve nga ana e ZAZ-së. Përpara fillimit të numërimit është konstatuar nga ZAZ-ja mosfunkcionimi i mirë i kamerës së sigurisë, e cila nuk mbulonte dot as tavolinën nr. 5 të numërimit dhe aspak ambjente shtesë ku vendoseshin materialet dhe pajisjet e PEI-t, e cila ishte e vendosur pas një dollapi. Në këtë ambjent shtesë ka patur një derë të mirëfilltë kalimi lidhëse gjë e cila vjen në kundërshtim me atë që është siguria në vtvete e një qendre votimi, numërimi

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

ose një ZAZ-je, e cila ka qenë në ambjente të pandriçuara rrëth shkollës së mesme ngjitur, pasi QV-ja ishte e pajisur vetëm me një kamer sigurie 4 dimensionale të themi e jo si përherë me kamera për çdo tavolinë. Në listën e kandidatëve për këshillin bashkiak ndodhen dy individë që i kanë shërbyer institucionit dhe procesit të votimit dhe numërimit përkatës. Kanë qenë dhe numëruar, kanë qenë dhe anëtarë të listës së këshillit bashkiak nga ana e PS-së. (*nuk kuptohet qarte emri*) me nr. 32 në listën e anëtarit të këshillit bashkiak rezulton gjithashtu se ka qenë përdorues i pajisjes PEI në një qendër votimi. Arlin Daulle nr. 1 në listën për anëtar të këshillit bashkiak rezulton gjithashtu se ka qenë numëruar gjatë gjithë procesit të numërimit. Në këtë proces votimi ka patur gjithashtu edhe përfshirje të punonjësve të bashkisë dhe funksionarë që kanë shërbyer respektivisht si më poshtë. Ju i keni emrat, mbështetjet unë nuk duhet ti bëj publike. Gjithsesi ju i keni aty. Problematika të tjera të ndodhura dhe të evidentuara me anë të konstatimit të bërë nga ana janë ato të kutive respektive 351701, mungonte procesverbali mbylljes, QV. 352301 mungonte procesverbali i mbylljes, 3825 po ashtu, 382503 po ashtu, 3829 po ashtu, 3527 po ashtu, 381701 mungonte proceverbali origjinal i vulosjes së kutive. Tani të flasim pak për fakte dhe argumentat që ne kemi trajtuar lidhur me atë që ka qenë procesi i votimit në tërësi dhe ambjenti ku është votuar, në një ambjent të themi jo të lirë përkundrazi deri diku edhe armiqësor dhe është thënë pak për shkak se ishte i fokusuar i gjithë shteti. Duke qenë se i kishin premtuar mbretit të tyre që do e merrnin 5 me 0 Qarkun e Beratit. Ja dolën duke vënë në dispozicion... vetëm tanket mungonin në Bashkinë Kuçovë, vetëm tanket mungonin në Bashkinë Kuçovë zoti relator. Duke marrë shkas nga të dhënat e vëzhguesve të GNV-ve Koalicioni Bashkë Fitojmë kërkon marrjen e provave nga KQZ-ja për pajisjet me regjistrimin e të gjitha kamerave në procesin e votimit në ZAZ-në nr. 64, në çdo QV. Nga verifikimi i këtyre pamjeve filmike do të rezultojë se numri i votave të vlefshme

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

apo të përfshira si të pavlefshme të një kandidati është relativisht i lartë. Nga leximi i këtyre anomalive apo parregullsive në kualifikimin apo jo të votës rezulton se kandidati i koalicionit do të shtohen të paktën votat të cilën ai ka humbur mandatin. Kjo sipas evidencave dhe sipas konstatimit të pamjeve filmike pasqyruar në QV e ZAZ. Pra mënyra e shkeljeve të pretenduara në procesin e ... dhe vlerësimit të votës, e bëjnë të detyrueshme kqyrjen e materialit zgjedhor me qëllim final rrinumërimin dhe rivlerësimin për ato qendra votimi ku nga vlerësimi i materialit filmik konstatohen qartë se votat e kandidatit të koalicionit, zotit Maliqi është shpërdoruar dhe adresuar qëllimi që një tjetër kandidat dhe për pasojë nuk është vlerësuar në mënyrë korakte nga grupet e numërimit. Për të përforcuar këtë qendrim ne koalicioni ankues në këtë rast në interesin më të lartë të procesit zgjedhor dhe në intëresin më të lartë të një transparence për qytetarët të cilët ushtrojnë një të drejtë kushtetuese në këtë rast, kërkojnë të bëhet rrinumërimi dhe rivlerësimi i votës për të gjithë ZAZ-në nr. 64 bashkia Kuçovë për çdo anomali dhe për çdo vlerësim ndryshe që është bërë qoftë në prezencë dhe qoftë në mungesë nëpërmjët të thëmi të atyre që janë intimidimet e bëra nga ana e qeverisë dhe përsonat e ngarkuar me pushtet në këtë rast. Nga këto dokumenta konstatohet se nga përbajtja e vendimmarrjes së çdo QV-je dhe ZAZ-je në vetvete rezultojnë parregllsi të shumta të cilat kanë cenuar në vetvete atë që është thelbi i procesit të votimit të numërimit dhe identifikimit korrekt të votës nëpërmjet ndërhyrjes që janë bërë me qëllim tjetësimin e vullnetit të zgjedhësve të kësaj zone zgjedhore. Kët veprime janë në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe me procedurat e përcaktuara nga Komsioni Rregulator pranë KQZ-së, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për sa i përket pjesës së pasqyrimit real dhe të vërtetë të vilnetit të zgjedhësve. Kjo rrëthanë përbën shkak ligjor sipas parashikimit të nenit 160 dhe provon se vendimi i KZAZ-së që kundërshtojnë vendimin nr. 101 nga të

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

gjithë procedurat e mëparshme që kanë të bëjnë me numërimin dhe përpilimin e asaj që është tabela përfundimtare, miratimi i tabelës përfundimtare, përbledhëse të KQZ-së, janë marrë në kundërshtm të hapur me ligjin. Ne si ankues kërkojmë që KAS për nevojat e hetimit administativ të vendosë administrimin e këtyre dokumentave administarativë zgjedhor, që është libri i protokollit të mbledhjeve, procesverbal të konstatimit të KZAZ-së, objekt ankimi tabelat e rezultateve të GNV-ve për QV-të e cituara. Pra të gjitha QV-të e ZAZ-së 64. Pamjet filmike të GNV-së, VNV-së, QV-së dhe ZAZ-së si dhe do dokument tjetër të nevojshëm për një hetim administrativ të plotë dhe të paanshem. Kërkesa jonë për rinumërim dhe rivlerësim gjen mbështetje në nenin 138 të Kodit Zgjedhor dhe më qartë mbështetet në provat të cilat pasqyrojnë se gjatë procesit të numërimit dhe vlerësimit të votave sipas përcaktimit sipas të nenit 116, 119 Të Kodit Zgjedhor ka patur shklje të konstatuara për numërimin e votave për çdo kandidat dhe për më tepër nga aktet e VNV-së dhe KZAZ-së gjatë vlerësimit të votave ka patur kundërshtim. Në çdo rast anëtarit tone i cili ishte i zgjedhur nga vetë Subjekti për të mbrojtur interesat. Pikë së pari interesat e votuesve dhe pikë së dyti interesat e subjektit, në mënyrë që vota të mos tjetërsohet. Pavarësisht naterialit të sipërcituar materiali zgjedhor i nxjerrë nga pamjet filmike dhe shmë raste krijohen...ai që do të nxjerrë nga pamjet filmike do të krijojë dhe do të shuajë ç'do dyshim që vota është tjetësuar dhe kandidati Maliqi ishte në epërsi të thelluar për sa i përket pjesës së atyre që kanë qenë qytëtarët e Kuçovës dhe rrehinave që kanë votuar për ta nxjerrë atë si kandidat fitues në përfundim të procesit të numërimit. Transparency ka lidhje me rinumërim dhe rivlerësin e votave, ka të bëjë edhe me indicje dhe me praktika të këtij komisioni kolegjial siç jeni ju. Vit 2021 na mësoi shumë gjera. Për transparencë besoj se edhe vet subjekti nteresuar që në këtë proces Partoa Socialiste e Shqipërisë për ti dhënë një provë më të madhe qyetarëve,

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

ndërkombetarëve thesarëve ndërkombetarë që janë shumë të interesuar për një proces të rregullt votimi. Besoj se ka interes edhe ai vetë edhe ai vetë si subjekt për të pasur një transparencë duke hapur dhe rivlerësuar votat nga ky komision. Për sa i përket shkeljeve të cilat provojmë me pamje filmike pasi ato kanë shkelur në mënyrë flagrante nenin 116, 117, 118, 119 të Kodit Zgjedhor. KQZ bazuar në materialin provues të rivlerësojë votat dhe të ketë një qëndrim objektiv për atë që është të themi e drejta kushtetuese e votuesve për të zgjedhur atë që është persni më i përshtatshëm për të drejtar bashkinë ku ata jetojnë, në mënyrë që të keni transparencë të karakterit ligjor dhe në mënyrë që të jemi objektiv deri në fund me atë që është vullneti i vetë qytetarëve që kanë votuar. Lidhur me vlerësimet që thamë më sipër të nderuar anëtarë, i nderuar zoti relator kërkojmë që ky komision kolegjal të vendosë sipas objektit tinë që e shtë: Ndryshimi i vendimit nr. 101, dt. 16.05.2023, ka pasur një lapsus përsa i përket muajit, për ZAZ-në 64, Bashkia Kuçovë, Qarku Berat, për miratimin e tabelës përbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Kuçovë duke përcaktuar rinumërin dhe rivlerësim të votave në gjithë ZAZ-në nr. 64 në çdo QV të saj. Faleminderit! Provat i keni bashkangjitur, besoj se i keni të gjitha.

**Z. K. Bele:** Faleminderit zoti Kaziaj! Vazhdojmë me ankuesin. Ju lutem duke qenë se zoti Kaziaj në mënyrë shteruese e trajtoi të gjithë materialin e ankimit, për ekonomi ato gjëra që u trajtuan nga ai... sigurisht mund të shton argumenta, të jepni një këndvështrim tjetër për gjërat por ju lutem të mos jemi në përsëritje.

**Z. L. Maliqi, kandidat për kryetar në Bashkinë Kuçovë:** Faleminderit zoti relator! Të nderuar anëtarë të trupit të KAS-it, të nderuar përfaqësues të KQZ-së, pak a shumë avokati i tha në mënyrë të përbledhur. Avokati tjetër që përfaqësohet me

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.01.06.2023*

prokurë i ka më të detajuara për shkak se kemi qenë në bazë, por do ju them që duke patur vlerësim te vendimi dhe paanshmëria juaj do ju bëj me dije se në KZAZ-në Kuçovë, në Bashkin Kuçovë janë bërë të gjitha mediatike. Ç'do incident i ndodhur, ç'do intimidim, blerje votash, çakull elektoral, asfalt elektoral, përplasje me Policinë e Shtetit. Dy kallëzime paraprake në KAS. Një kallëzim nga Partia Demokratike në datën 12 dhe një kallëzim tjetër nga ana ime në SPAK. Të gjitha këto shkelje, të cilat janë të provuara me filmime, fotografi dhe me kapje.... Atë që thga edhe avokati, që gjithë policia e shtetit, jo e Kuçovës por Ministri i Brendshëm, ish drejtues policie, banditë, oligarkë u fokusuan në Kuçovë sepse Kuçova edhe Kryeministri e dinte që nga të gjitha sondazhet që ishte e fituar. Madje nuk foli, por do ju them që të paktën të përqëndrohem i te një shkelje flagrante dhe një përplasje e imja të paktën me kordonin e polisë së shtetit kur u dorëzuan kutitë. Rreth orës 11:00 Drejtori i Qendrës së Kulturës, Qendra e Kulturës e cila është ngjitur me KZAZ-në, me kutitë e votimit, e cila është e lidhur me derë tjetër jo vetëm me KZAZ-në por edhe me shkollën e mesme rreth 100 metra. Ne jua kishim bërë problem edhe vëzhguesve të OSBE/ODIHR-it,. Futet brenda me çantë dhe unë çaj kordonin e polisë të nxjerr jashtë Drejtorin e Qendrës së Kulturës. Pas këtij incidenti e nxjerrin drejtorin, por aty futen edhe dy punonjës të tjera të bashkisë. Anëtare e KZAZ-së e ka bërë të qartë... Kryetari i KZAZ-së ka thënë léri këta dy punonjës. Ndërkohë unë do të hyj përsëri rrëth orës 11:15 dhe më thonë qytetarët që është edhe një oficer policie i Tepelenës, Në debat e sipër më thonë që nuk është e vërtetë, është përfaqësues nga KQZ-ja. Ndërkohë operatori i KQZ-së nga Pogradeci, patronazhist, çfarë ishte...ka thënë që për një orë e mbaruam problemin e KZAZ-së Kuçovë dhe ky jo sekretari që ishte i Ali Beajit, ky bëntë raportimin online me KQZ-në me shifra fiktive të procesverbaleve. Ka patur shumë kundërshtime dhe në filmime dhe në debate, në tension. Anëtare e KZAZ-së

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

në orën 11:20 vjen për të më njoftuar që po mbyllin KZAZ-në. Rasti i parë në vend dhe mbylljet në mënyrë të befasishme në dorën e kordonit të policisë. Çaj kordonin për të parë çfarë po ndodh, ku po shkojnë dhe marrin vendim për tu kthyer për tu larë, për 30 min dhe kthehen në 00:40. Kamerat e sigurisë që ne i morëm e trëgojnë pjesërisht pëtë gjë. Ndërkohë që këto kamerat tavolinën nr. 5, pjesën më të madhe të tavolinave nuk i mbulojnë, por nuk i mbulojnë as kutitë e votimit. Kutitë e votimit ishin ngjitur me qendrën e kulturës ku ne dyshojmë të gjithëçfarë është bërë... ose janë hedhur fletë votimi, ose janë ndërruar kodet, kutitë e të githë e rradhë. Sidomos në rrrështin e fundit. Pavarësisht se kishte tensione, deri në orën 00:00 në të 3 ish komunat në lagjen e qytetit isha fitues me 300-400 vota. Pavarësisht se kishin probleme vëzhguesit me numëruesh, sepse 3 tavolina kishin numëruesh, përsëri këto tensionet janë të filmuara. kështu që ne kemi besim tek ju që të gjitha këto indicje që dhe avokati tjetër zoti Langozi bashkë me zonjën kanë fakte të tjera, të pakundërshtueshme dhe për fallsifikim dhe për vepra të tjera, shkelje që janë bërë atje. Kam besim që të gjitha këto duhet ti shikojmë për të parë këtë krim të pastër elektoral dhe unë kam një besim të patundur që një pjesë e votave të mia i kanë kaluar edhe kandidatit të Alibeaj dhe një pjesë e votave të mia i kanë kaluar dhe kandidatit të rilindjes, ndërkohë që dhe te fletët e pavleshme... pra kërkojmë nga ju transparency, megjithatë avokatët që më përfaqësojnë me prokurë kanë prova tepër të sakta lidhur me procesverbalet, fallsifikimet dhe të gjitha me radhë. Faleminderit!

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Maliqi:** Të nderuar ne i kemi bërë një kërkesë ose një ankım pranë jush që është një ankım i zgjeruar ku kemi pasur disa pikë në ankım dhe në vendimin nr. 136, dt. 24.05.2023 ju si komision keni vendosur pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore me nr. 74 dt. 22.05.2023 pjesërisht për

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

disa pika të cilat janë thelbësore nga ana juaj është vendosur rrëzim me arsyetimin se ju nuk jeni organi kompetent për shqyrmin e këtyre kërkimeve. Unë doja të informohesha sepse vendimi nuk më rezulton të jetë i qartë, për arsyen sepse nuk më rezulton nëse është vendim i ndërmjetëm apo është një vendim i cili është vendim përfundimtar. Këtë unë nuk e kam kuptuar si gjatë shpjegimit dhe nëse ju mund të ma thoni nëse është vendim i ndërmjetëm apo vendim përfundimtar?

**Z. K. Bele:** Kasi në atë moment ka qenë me katër anëtarë por kur është bërë bashkimi për shkak se ankimi ishte më pare, e kam marrë automatikisht. Këtu vazhdon zoti zoti Rusmali.

**Z. I. Rusmali:** Dakord! Meqenëse ju keni paqartësi, vendimi është vendim i ndërmjetëm. Vendimi për pranimin për shqyrtim të një kërkese ankimore është vendim i ndermejtëm gjithmonë. Ne kemi vendosur moskompetencën dhe rregulli e kërkon që arsyetimi i vendimeve të ndërmjetme të bëhet bashkë me vendimin perfundimtar sepse vendimet e ndërmjetme janë vendime te brendshme të instiucionit dhe janë të paankimueshme. Ju keni kërkuar në listën e gjatë të objektit deklarimin e pa velfshmerisë së akteve të caktuara. Kodi i Procedurave Administrative parashikon që pavlefshmeria ablsolute e akteve konstatahet nga organi publik qe ka nxjerër akatet dhe pastaj nga një grup organesh në rrugën e tyre të hierarkike. Aktet qe ju kontestoni janë akte të organeve të tjera publike, nuk janë tonat dhe ju keni mundesinë në varësi nga afatet që parashikon igji për secilin. Ne si hyjme dot respektimit të afateve sepse nuk është çështje e shqyrtimit tone. Keni mundësinë ti kontestoni pranë organeve ose në rrugë ankimi gjyqësor të gjitha ato akte. Pra të gjitha akatet, të gjitha kërkuesat në pavlefshmëri aktesh nuk janë

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

konsideruar competence e jona. Ky ka qenë në thelb arsyetimi, pastaj në vendimin tonë perfundimtar ju do ta keni të arsyetuar me detaje këtë gjë.

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Malqi:** Atëherë, meqenëse ky vendim u pranua nga ju që është vendim i ndërmjetem dhe vendim i ndërmjetëm është marrë në kundështim me Kodin e Procedurave Administrative dhe pikërisht me neninin 24 të këtij kodi, i cili percakton...

**Z. I. Rusmali:** Por vendimin e ndërmjetëm ju mund ta ankimoni dhe është rregull, mund ta ankimoni bashkë me nenin perfundimtar. Nëqoftë se ju doni ta harxhon kohën për vendimin e ndërmjetëm, mund ta harxhon, por me duket se jemi jashtë temës sotë.

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Malqi:** Por mund ta perfundoj se.. unë nuk jam duke shpenzuar kohën me vendimin e ndërmjetëm por jam duke garantuar një proces të rregullt ligjor të cënuar në mënyrë të drejtpërdrejt nga ju si komision, për arsy se pse në nenin 24 të Koditit të Procedurave Administrative përcaktohet qartë: “Në rastet kur një organ ka mungesë kopetence, kur një organ publik me një kërkesë për çështje të cilat vlerësohen jashtë kopetencës së vetë, ja percjell kërkesën menjëherë dhe në çdo rast jo më vonë se dy ditë nga marrja e saj organit publik kompetent dhe njofton kërkuesin për këtë moskompetencë që ka vendosur”. Në rastin konkret nëse ne i referohemi vendimit nr. 136, pikës 2, kemi të bëjmë me një rrëzim të kërkesës dhe për këtë arsy unë kërkoj nga ana juaj revokimin e vendimit të ndërmjetëm të pikës 2, të vendimit nr. 136 dt. 24.05.2023 dhe nëse ju e vlerësoni se nuk jeni organi competent, dërgimin e kësaj kërkimi në organin competent. Kërkesën e kam me shkrim i kam të argumentuara të gjitha pikat se ku

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

janë ose të gjithë nenet. Janë një sërë nesh duke filluar nga neni 4,13,14,23,24,90,109,116 të Kodit të Procedurave Administrative ky vendim i ndërmjetëm është në shkelje të hapur. Ju mund të vodosni çfarë të doni, por unë këtë edhe nëse ju do të merrni një vendim negativ e dua për një vendimmarrje tjeter të mesiperme. Une e vlerësoj se kjo kërkesë është në përputhje me ligjin dhe kërkoj nga ana juaj që të shpreheni paraprakisht, që më pas unë të bëj kërkesat. Kam dhe dy kërkesa të tjera paraprake të cilat do ti bëj sipasd vendimit.

**Z. K. Bele:** Avokat faleminderit! KAS administron kërkesën tuaj dt. 31.05.23 në objektin që ju lexuat. Kërkesën per revokimin e pikës dy në vendimin nr. 136 24.05.2023 të Kas. KAS i konsiduar në vend shpjegon se vodosim të shprehemi me vendimin përfundimtar bashkë me kërkimet e tjera. Ju lutemi vazhdoni me pjesën tjeter të parashtrimeve tuaja.

**Z. A. Llangozi, avokat për zotin Maliqi:** I nderuar kjo është kërkesë paraprake nuk është...

**Z. K. Bele:** Avokat ju jeni avokat në karrierë. Ju bëtë një kërkesë, ne ju dhamë një përgjigje. Ju lutem vazhdoni me atë që keni për të thënë.

**Z. A. Llangozi, avokat për zotin Maliqi:** Edhe unë kërkoj një vendim për kërkesën që bëra, sepse nuk bëra një kërkesë që s'është e bazuar. Ne jemi te kërkesa paraprake tani do të vazhdojmë me vendimin përfundimtar. kjo është paragjykim.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. K. Bele:** Më fal edhe një here, përgjigjia është kjo që sapo dëgjuat. Për këtë kërkesë tuajën do të shprehemi me vendimin perfundimtar, ndaj të cilit... ta mbaroj të lutem... ndaj të cilit ju mund të bëni ankim në format e parashikuara nga ligji.

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Maliqi:** Ateherë...

**Z. K. Bele:** Ju lutem nëse nuk keni të.. të mbaroj... Nëse keni për të vazhduar me prarashtime apo kërkime të tjera jeni të lutur të vazhdoni, faleminderit.

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Maliqi:** Referuar kërkesës që unë bëra edhe asaj që ju keni rrëzuar, kërkesa ankimi që unë kam bërë, referuar edhe vendimin nr. 12 dt. 24.06.2016 ...Se ju shqetësoni dhe mund ta lëm të vendosni ca keni menduar ju. Po dakort se ju e keni vendosur ca vendimi do merni.

**Z. K. Bele:** Dëgjo, duhet të respektosh proceduarat. Se çfarë komunikojmë ne me njëri - tjetrin nuk të takon ty të komentosh. Nëse ke ardhur për të prishur procesin je në të drejten tënde, por fol me rradhë, kerko fjalen.

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Maliqi:** Por une e kisha rradhen.

**Z. K. Bele:** Po pra, por nuk mund të komentosh se çfarë konsultohemi ne. Unë jam shum i qetë zakonisht por...

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i BF-së:** zoti Bele mund ta marr fjalën?

**Z. K. Bele:** Të mbarojë zotëria.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i BF-së:** Këto tani më duket se janë...

**Z. K. Bele:** Nuk ka fare rëndësi.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i BF-së:** Me gjith respektin personal.

**Z. K. Bele:** Nuk kam nevojë për respektin e asnjerit.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i BF-së:** Nuk ke nevoj për respektin e asnjerit.

**Z. K. Bele:** Nuk kam fare.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i BF-së:** Meqenëse nuk ke nevojë për respektin e asnjerit nuk të lë të mbarosh pikë së pari...

**Z. K. Bele:** Tani, avokat te lutem, po fol çfarë te duash. Nëse do ta bësh qesharak procesin, keni ardhur të beni zhurmë zoti Kaziaj. Nëse ke ardhur te bësh zhurmë... kemi disa kohë... po ca të drejte, po flas me ate, po çfarë je ti...

**Znj. O. Serani, avokate për zotin Maliqi:** Ne duhet të flasim për vete apo duhet të flasim për ju?

**Z. K. Bele:** Dëgjo dëgjo avokat avakat të lutem vazhdoni kërkimet tuaja. Ne ju dhamë atë përgjigje që ju dhamë, në mënyrën si ne e mendojmë ligjin. Jeni i lirë të thoni atë që mendoni në respekt të etikës sigurisht. Ju lutemi vazhdoni në kërkimet tuaja, kjo është përgjigjeja që ne ju dhamë. Faleminderit

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. A. Langozi, avokat i zotit Maliqi:** Mendoj se nuk kam fyer askënd. As kam ndërmend të fyej askënd, as kam ndërmend të prish procesin ashtu siç u tha. Pavarësisht se ju më paragjykuat është një pjesë që ju përket ju, por arsyja që unë kërkoj që ky vendim i ndërmjetën të revokohet ka të bëjë me ankimin sepse në qoftë se ju ma pranoni këtë kërkesë që unë kam bërë aktualisht dhe ju mund të shprehni për të gjitha pikat e ankimit, atëherë i bie që unë duhet të shprehem në tërësinë e ankimit. Sepse unë në kundërshtim nga ai vendim, këtu është qëllim drejtësia, nuk është qëllim as të debatojmë me njëri-tjetrin, as të konfliktohem. Unë jam jashtë fushave politike dhe s'me intereson kjo pjesë, jam vetëm me të drejtën. Aktualisht mua më rezulton se me vendimin, me vendimin e datës 24/06/2019 kolegji zgjedhor ka konstatuar edhe kryesisht pavlefshmërinë e dekretit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë për shtyrjen e afatit zgjedhjeve dhe unë mendoj se për të gjitha pikat e kërkimit që unë kam parashtruar para jush, është një e drejtë që unë duhet ta ngre. Vendimi, është publikuar dhe mendoj se dhe ju keni dijeni për këtë gjë dhe mendoj se vendimi është i gabuar nga ana juaj dhe për arsy se vendimi është i ndërmjetëm, unë kërkoj revokim, sepse nuk po kërkoj se si... Të lutem! T'a mbaroj! Po... A mund ta mbaroj? Nuk po kërkoj unë se çfare vendimi do merrni ju ne përfundim? Vendimi juaj mund të jetë çfarëdo, por unë mendoj që të gjitha ato pika kërkimi që unë kam ti gjykojmë, sepse mua më duhet që në një gjykatë tjetër të ngreh të gjitha këto pretendime që unë kam, dhe mendoj se edhe në bazë të ligjit për funksionimin e organeve kolegiale, ju jeni një organ quasi - gjykatë që unë duhet të ngreh ç'do lloj pretendimi para jush dhe ju duhet të gjykonit ç'do lloj kërkimi. Ashtu e ka dhe kodi i procedurave administrative. Në përfundim të procesit juve mund të vendosni çfarëdo...sepse ne na ka rezultuar të nderuar që

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

KQZ-ja në mënyrë të turpshme, jo ju si kolegë, por KQZ-ja në mënyrë të turpshme ka fshehur vendimin e dënimit të kandidatit për kryetar bashkie Kreshnik Hajdari. Nuk i është dërguar as Prokurorit të përgjithshëm, është fshehur nga arkivat e tij, e kemi kërkuar disa herë me shkresa dhe ky vendim nuk ekziston. Dhe për këtë arsyen, jeni i vetmi institucion që ne mund të drejtohem i dëshiruar që të gjejmë drejtësi. E theksoj dhe njëherë, nuk kemi ardhur për të bërë konflikt. Klienti im ka shumë besim tek ju si organ kolegjal dhe nuk është qëllimi jonë të krijojmë debate të kota. Ne duam një vendim ashtu siç ju do ta mendonit deri në përfundim të procesit. As ne nuk duam të ju paragjykojmë ju, as ju ne, sepse ne kemi shumë prova, të cilat do ti provojmë gjatë procesit dhe mendojme se do ju bindim që kemi të bëjmë me, si me pavlefshmërinë të disa veprimeve konkrete dhe në lidhje me numërimin. Për këtë arsyen unë kërkoj revokimin e këtij vendimi referuar edhe vendimit. Unë nuk e mendoj se është e turpshme që ne të revokojmë një vendim të ndërmjetëm të dhënë nga ju. Unë mendoj është e turpshme që ne mos të bëjmë një vendim të drejtë dhe për këtë arsyen unë kërkoj nga ju mirëkuptimin, të jepni një vendim themeli në përfundim, dhe ta adresoni apo pranoni, jo me vendim paraprak...

**Z. K. Bele:** Ju kërkonit një vendim themeli tani apo vendim të...?

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Maliqi:** Jo, unë mendoj revokimin dhe të gjykohet ankimi në tërësinë e tij.

**Z. K. Bele:** Dakord! Meqenëse ju bëtë kërkime shtesë, meqenëse ju bëtë kërkime shtesë dhe meqenëse nuk ishte dhe nuk është qëllimi im t'ju pengoj ju të thoni ato që mendoni, por mu duk e udhës, mbasi ne mbajmë një qëndrim që ju të vazhdoni. Megjithatë meqenëse ju bëtë kërkime shtesë, shoh që edhe kolegët kanë pyetje, ne

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

këtu jemi, durim kemi sa të doni ju, kështu që të lutem po të pyesin kolegët dhe ne do vijmë prap tek fjala juaj.

**Z. L. Braho:** Unë nuk kam pyetje por për, tani meqenëse këtu jemi gjithë mes kolegësh ,se të gjithë juristë jemi, tani po të vësh re vendimin që ju pretendoni që, ose më saktë vendimi që ju citoni, vendimin e ndërmjetëm dhe ta lidhësh me kërkimet që keni bërë ju në ankım, një nga pikat e kërkimit përveç atij që është pranuar psh: është rinumërimi dhe rivlerësimi i votave. Rinumërimi dhe rivlerësimi i votave nuk janë objekt, janë mekanizëm për të arritur tek ajo që ju kërkoni dhe ne këtë qëndrim e kemi mbajtur tek të gjithë vendimmarrjet e tjera. Pra në qoftë se ti kërkon rinumërim dhe rivlerësim nuk është vendimi objekti ose më saktë, në qoftë se ne do marrim një vendimmarrje nuk do marrim vëndim për rinumërim dhe rivlerësim. Ai është vendim i ndërmjetëm. Tjetra, pavlefshmërinë e vendimit numër 101 për miratimin e tabelave. Pavlefshmëria mund të jetë pavlefshmëri e zgjedhjeve, se nuk ka pavlefshmëri tabele. Ti e ke kërkuar në pikën 1 ndryshimin e tabelës. Pra o do kërkosh ndryshim o do kërkosh pavlefshmëri. Prap mund të jemi ne kushtet e pavlefshmërisë së zgjedhjeve. Tjetra është , pavlefshmërinë e vendimit ne KAZ-së së qarkut Berat për shtyrjen e numërimit të votës nga ora 11:00 deri në ora 13:00, dhe të gjithë këto pavlefshmëritë e tjera dhe këtë të formularit të vetëdeklarimit, të gjitha këto janë elementë që ne mund ti konstatojmë dhe kryesisht. Momenti që ti do ngresh gjithë pretendimet, do sjellësh gjithë provat nuk është nevoja që ajo të jetë objekt i padisë. Dhe në qoftë se ne arrijmë ti pranojmë të gjitha këto pavlefshmëritë, patjetër që mund të shkojmë hipotetikisht tek pavlefshmëria e zgjedhjeve për Bashkine Kuçovë. Dhe nuk ka asnje pengesë për ju që ti bëni të gjitha ato kërkimet pavarësisht vendimmarrjes tonë të ndërmjetme.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. A. Langozi, avokat i zotit Maliqi:** Kur unë vendimin përkatës në pikën 2, unë marr një vendim rrëzimi është...po është rrëzim sepse e shkruan qartë, mund ta lexojmë. Është vendim rrëzimi dhe unë këtë dua... nuk hyj në debat juridik, ju jeni koshient dhe jeni avokat...

**Z. L. Braho:** Ne nuk bëjmë rrëzim në seancë paraprake, ka kalim , ka moskalim, nuk ka rrëzim...

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Maliqi:** Unë shkruaj atë që lexoj, unë lexoj gjykin, pranimin pjesërisht të ankimit..

**Z. L. Braho:** Po për sa i përket objektit. Ta shpjegova, rinumërim dhe rivlerësim, nuk mund të jetë objekt kërkimi.

**Z. A. Langozi, avokat i zotit Maliqi:** Tani, objekti i ankimit dhe bashke biem dakort, me të gjithë ju biem dakort se edhe gjykata e lartë ka mbajtur një unifikim që thotë që objekti i ankimit të kërkesës apo padisë nuk është vetëm pjesa hyrëse por është tërësia dhe në rastin konkret unë e kam menduar ta vë në pjesën hyrëse. Kjo ku e kam unë shkelje këtë gjë nuk e kuptoj. A është një akt administrativ, është akt administrativ të cilin unë duhet ta kundërshtoj dhe mendoj, mendoj...

**Z. E Lako:** Avokat, avokat, po bëjmë një debat...

**Z. A. Langozi, avokat i zotit Maliqi:** kur ju do ma rrëzoni këtë kërkim që në fillim, që s'do e merrni në shqyrtim, atëherë unë si mund ta pres që ju ta konstatoni pavlefshmërinë kryesisht?

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. E Lako:** Avokat ne jemi në seancën objektit të kërkesës sepse nuk shqyrtohet themeli, as prova, objektin e kërkesës. Objekti irregullohet sipas kërkimit që përcakton ligji. Ju në seancë themeli keni të drejtën ta bëni mbrojtjen si ta mendoni ju dhe me gjithë provat që ju pretendoni. Ne dhe unë nuk e kuptoju se ku e shihni pjesën që nuk ju pëlqen, që e doni tani apo në fund, kur më mirë ju vjen që vendimi përfundimtar të shprehet me gjithë kërkesat, sepse po ta marrim tani është ju nuk e keni relatuar akoma. Do me thënë ku është e keqja këtu nuk e kuptoju. Ne nuk po ju privojmë ju nga e drejta për të thënë atë që ju mendoni dhe kërkoni. Mund të thoni ç'të doni.

**Z. K. Bele:** Edhe dicka tjetër për ta qartësuar situatën avokat. Ka një tension në thonjëza në kod, midis të drejtës së ankimit të subjektit zgjedhor, si subjekt, ku është dhe kandidati për kryetar bashkie dhe parimeve të ankimit që janë tek neni 124 për subjektet politike të cilat kanë brenda edhe subjektin përveç kandidatit të pavarur. Në përgjithësi praktika e këtyre ankimeve ka qenë që është ankuar subjekti zgjedhor dhe kryetari i bashkisë, kandidati për kryetar bashkie, ka ardhur bashkë me subjektin zgjedhor. Ne këtu kemi një situatë të ndryshme nga ankimet e tjera, ku ju keni ardhur me dy korsi të ndryshme për të njejin qëllim dhe objekti final është i njejtë. Pra ka ardhur subjekti politik i përfaqësuar nga koalicioni, ka ardhur edhe kandidati. Tipikisht vjen subjekti. Duke thënë këtë, fakti që ju jeni bashkë nuk i prish punë procesit, e ndihmon procesin. Rruga është e njejtë. Ajo që po thonë edhe kolegët, pavarësisht nga moskalimi në vendimin e ndërmjetëm dhe mospranimi në atë fazë nga KAS-i të shqyrtojë ato pretendime, nuk do të thotë që jemi para gjësë së gjykuar dhe nuk do të thotë që ju nuk mund ti ngrini në këtë fazë. Pra ne nuk jemi një gjykatë, jemi quazi - gjykatë, është organ administrativ. Ju keni ardhur me një kërkim, dy kërkesa të ndryshme por siç e lexoj unë është e njejtë, kështu që unë ju ftoj që ju pretendimet tuaja, parashtimet tuaja çfarë keni për të

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

shqyrtuar, në qoftë se vlerësoni dhe ato që në atë vendim janë quajtur nga KAS-i se nuk janë ose është vlerësuar në atë fazë, së nuk janë, nuk është objekt i kësaj trupe t'i shqyrtojë. Gjithsesi ju i parashtroni dhe i bëni pjesë të seancës dhe ato do të jenë pjesë e dosjes, pjesë e argumentave për t'u shqyrtuar si nga kjo trupë ashtu edhe nga organet e tjera në rastin eventual të ndonjë ankimi, nëse do të ketë të tillë, pa paragjykuar në vendimmarrje. Nuk e di nëse e shterova merakun tuaj me këtë përgjigje.

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Malqi:** Ju ishit shumë të qartë dhe parimisht bini pothuajse të gjithë dakort me atë që unë kam kërkuar me kërkesën dhe mendoj ju ta revokoni dhe unë të jem i qetë në mbrojtjen time s'mendoj...

**Z. E Lako:** Më fal, por ne u shprehëm. Ne nuk mund ta bëjmë shokësh. Ne ju folëm gabim herën e parë po tërhiqemi, po shprehemi për së dyti, nuk shkon. Më ler ta mbaroj. Ne thamë që ne do të shprehemi në kërkimet përfundimtare për pjesën tuaj. Tani mund të themi hera e parë që jëmi në një proces. Kështu që do të lutem...

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Malqi:** Por kompetenca dhe juridikzioni janë të parat që gjykohen dhe...

**Z. E Lako:** Z 2: Po jam dakord! Kështu e kuptojmë ne ligjin. Ngriji këto probleme ne ankim.

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Malqi:** S'është kjo kështu e kuptojmë ne ligjin, unë s'jam duke folur me njerëz që s'kuptojnë ligjin.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. E Lako:** Tani, do vazhdojmë me këtë debat shterpë?

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Maliqi:** Unë s'mora përgjigje...

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Maliqi:** Përgjigja është do shprehemi...

**Z. L. Braho:** Altin nuk është punë fare e madhe tani, që të kuptohemi pak me njëri - tjetrin, se ne nuk jemi për hërë të parë, sidomos ti këtu se zoti Langozi ndoshta është për hërë të parë. Nuk është çështje që ne e kemi ndarë mëndjen, unë ja thash atij. Të gjitha këto që ai ka kërkuar si pika të objektit përvëç asaj që ka kaluar për shqyrtim, të gjitha janë mekanizma për të arritor te ajo që ai ka kërkuar. Edhe mekanizmat ai i ka në themel. Ne kemi rihapur kutitë në Rrogozhinë, kemi hapur pjesërisht në Kamëz edhe disa të tjera pa e patur në object. Sepse nuk është kërkimi për hapje kutish për rivleresim nuk është objekt... Nuk marim vendim ne. Të marim një vendim përfundimtar për hapje kutish edhe të ikim në shtëpi. Ne edhe ju. Ajo hapen kutitë edhe ndryshohet tabela, atë që ne kemi thënë. Pra edhe këtu nëqofte se do të vendoset për hapje kutish do të hapen kutitë, do të rinumerohen, do të rivleresohen edhe do të ndryshohet tabela nëqofte se do të ketë vend për ndryshim. Kaq e thjeshtë është. Dhe pavlefshmeria e formularit të dekriminalizimit, nëqoftë se këtu do të sillen prova, do të dilet në pavlefshmeri edhe mund të dilet dhe në pavlefshmeri zgjedhjesh. Nuk e pengon asnjeri këtë.

**Z. A. Kaziaj:** Pikërisht nga kjo që thatë ju zoti Braho fakti është që ju pse s'keni ndërmarrë nismën për t'ja dërguar organit kopotent meqë keni vendosur rrëzimi për moskompetencë të atyre që kanë qenë pikat që kolegu Langozi ka kërkuar në ankimin e vetë. Se është pak paragjykuese kjo gjë. Vetë kodi i procedurave

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

administrative e detyron organin kompetent ose organin kundrejt të cilit sillet një ankim të vihet në levizje për t'ja dërguar organit kompetent. Pra paragjykimi i kësaj çështje sipas meje ka diçka që nuk shkon. Edhe ju me argumentimin tuaj fare qartë e thatë. Fakti është se i keni pasur në dispozicion këto prova, një pjesë të tyre do ju vihen në dispozicion në këtë moment dhe për të vajtur atje ku ju thatë te rivlersimi dhe rinumerimi. Po pavlefshmëria është pjesë e totalit të gjësë në vetvete. Dhe pavlevshmëria ka te bëjë dhe me akte të karakterit jo vetem administrativ po me çdo akt tjeter që ju duhet ta konstatoni si të tillë në bazë të provave që janë sjellë nga ana jonë.

**Z. I. Rusmali:** Mbase duhet të bëj unë një shpjegim këtu. E para njehërë kjo çështje është çështje procedure jo negociale. Ne nuk jemi duke negociuar me njëri - tjetrin këtu. Edhe nuk kemi nevojë të bindim njëri - tjetrin këtu. Ne e kemi proceduriale. Një vendim i ndërmjetem e kësaj trupe, mund të ankimohet ligjërisht vetëm bashkë me vendimin përfundimtar. Dhe kjo është jashtë çdo lloj diskutimi. Eshtë ligj dhe ligji zbatohet, nuk negociohet e para. E dyta, ju duhet të kuptoni cila është procedura që po zhvillojmë ne këtu. Procedura që ne po zhvillojmë këtu është e paraktuar specifisht në ligj. Procedura është procedurë e kundërshtimit të vendimit për shpalljen e tableles përfundimtare të zgjedhjeve në zonë. Kundërshtimi i tabelës për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve në zonë bëhet në dy forma ligjore. E para nëpërmjet kërkesës për të ndryshuar tabelen kur subjekti konstaton që tabela ka numra gabim dhe numrat duhet të korrigohen. Dhe e dyta nëpërmjet kërkesës për shpalljen e pavlefshmërise së zgjedhjeve në qendra të caktuara të votimit. Pavlefshmëria e zgjedhjeve në qendra të caktuara të votimit lidhet me provimin e shkeljeve të caktuara në ato qendra të tilla që janë në një masë të tillë që bëjnë të pavlefshëm rezultatin. Kjo është procedura që ne

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

zhvillojmë. Tani përtej asaj që tha zoti Braho që një pjesë e objektit të përshkruar nga ju është metodë, nuk është kërkesë. Dhe metoda nuk ka më vend në objekt. Metoda është rruga nëpërmjet të cilës shkojmë te vërtetimi ose jo i kërkesës ankimore. Përtej kësaj ju keni bërë kërkesa që nuk janë kompetenc e jona. Tani thoni pse s'ja përcillni organit kompetent. Nuk ja përcjellim organit kompetent se ne jemi strukturë ankimi, nuk jemi organi publik. Ju duhet t'ja çoni organit publik që ju thoni që është kompetent për këtë punë dhe organi publik që nuk e ndjen veten kompetent duhet t'ja coj organit publik kompetent. Nëqoftë se çështja do kishte shku te Komisioneri dhe Komisioneri do të ju kishte thënë nuk jam unë kompetent ju do kishit mundesinë të vinit tek ne dhe të ankoheshit për vendimin e Komisionerit. Ne shqyrtojmë ankime, nuk shqyrtojmë kërkesa. Kërkesa juaj që ta deklarojmë të kriminalizuar kandidatin është kërkesë, nuk është ankim. E kuptoni dallimin midis kërkesës dhe ankimit?! Shkon paraqiteni kërkesën tek organi kompetent, kushdo qoftë ai por mos e paraqitni kërkesën në procedurë ankimi. Paraqiteni si kërkesë, jo si ankim. E keni sjellë si ankim. Nuk jua shqyrtojmë dot. Tani kjo juve nuk ju pëlqen është normale jo çdo njeri del i kënaqur nga kjo sallë. Por çdo njeri ka të drejtën të ankohet ndaj vendimeve tona. Dhe ju të drejtën e ankimit e keni të plotë, të pa kufizuar. Ju jeni në këtë moment, në këtë dilemë, ta bllokojmë punën e këtij komisioni për të shqyrtuar kërkesën tonë për ndryshim rezultati ose pavlefshmëri të zgjedhjeve se kemi një hall tjeter apo ta lejoni këtë komisjon të gjykoj për kërkesën tuaj dhe ato hallet e tjera t'i zgjidhni te organi kompetent. Çfarë doni të zgjidhni? Njérën apo tjetrën. Por ndajeni këtë punë se nuk ka sens të vazhdoj me këtë lloj debati negociues. Negociat me ne nuk ka. Ne kemi mar një vendim unanim. Proceduralist kundër këtij vendimi ju mund të ankoheni në Kolegjin Zgjedhor pasi të merni vendimin përfundimtar dhe këtu diskutimi mbyll. Ne do t'ju japim përgjigje formalisht dhe kërkesës për revokim po

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

përgjigje me kusht në procedurë ankimore nuk ka. O më jep përgjigje tani, o unë ngul këmbën edhe svazhdoj më tutje. Ne qoftë si ti thua ngul këmb edhe s'vazhdoj më tutje ne e mbyllim diskutimin me ty ja kalojm avokates tjetër. Nëqoftëse avokatja tjetër thotë unë ngul këmb e s'vazhdoj më tutje, e mbyllim më të ja kalojm palës së interesuar. Kjo është procedura jonë. E kuptioni këtë apo doni të ngulni këmb përsëri?

**Z. A. Llangozi, avokat për zotin Malqi:** Unë e kuptioni i nderuar edhe ju e kuptioni edhe këtë që ju mund të na hiqni të drejtën e fjalës, por nuk kuptioni se ku ju e dini se cfarë mendojmë ne.

**Z. I. Rusmali:** Ne nuk heqim të drejtën e fjalës. Njeriu që refuzon të shfrytëzoj të drejtën e tij, jo të lutem. Njeriu që refuzon të shfrytëzoj të drejten e tij, ne nuk ja heqim të drejtën. Thjesht konstatojmë që nuk do të shfrytëzojë të drejtën dhe kalojmë te tjetri. Ne nuk jemi peng i dëshirave tuaja. Ne jemi peng i procedurës ligjore dhe te procedura ligjore nuk lejojmë negociatë, prandaj mirë është të mos e zgjasim më këtë punë se po vonohemi kot.

**Z. A. Llangozi, avokat për zotin Malqi:** Jo këtë nuk kuptova tani se zoti relatori apo sqaroi që do të shprehet në përfundim të procesit ndërkoh ju u shprehët tani.

**Z. I. Rusmali:** Lidhur me kërkesën për revokim ne do shprehemi në përfundim të procesit.

**Z. A. Llangozi, avokat për zotin Malqi:** Po ju e dhat atë.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Përgjigje për këtë ti nuk mer dot sado të insistosh. Tani ftesa ime është mos insist, vazhdo te kërkesat që ke, vazhdo te parashtrimet që ke se përndryshe fjalën e mer avokatja.

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Maliqi:** Kërkoj përjashtimin tuaj i nderuar kërkoj përjashtimin tuaj.

**Z. I. Rusmali:** Është e gatshme avokatja ta mari fjalën?

**Znj. O. Serani, avokate për zotin Maliqi:** Avokatja është e gatshme edhe shtron kërkesë për përjashtimin tuaj duke qenë se ju nuk keni mundësine për të na dëgjuar edhe dicka tjetër. Jo duhet të them vetëm diçka.

**Z. I. Rusmali:** Jo jo formalizoj kërkes përjashtimi, duhet ti japim përgjigje ne.

**Z. K. Bele:** Po atëherë dakord! Si relator i séances, duke u ndodhur përpara dy kërkesava tuaja për përjashtim. Ka ndonjë kërkesë tjetër? Mund ta thuash.

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Maliqi:** Kërkojmë ta bëjmë me shkrim kërkesën sepse këtu u mendua se çfarë mendojmë ne dmth. u aludua se cfarë mendojmë ne e para.

**Z. K. Bele:** Do t'ju ftonim ta relatoni në seancë nëse mundeni.

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Maliqi:** E dyta toni është shum agresiv që na ka friksuar pa masë. Ne kemi ardhur këtu me një natyrë të qetë se s'kemi ardhur se me

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverball i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

frikë, na ka frikësuar shumë policia e shtetit me raprezaljet që ka bërë dhe nuk kemi ardhur që të na bëhet tjetër presion.

**Z. K. Bele:** Ju qetëson toni im i qetë?

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Maliqi:** Edhe presionin tek e fundit nuk e ham si presion, gjithsesi kërkojmë përjashtimin. Përjashtimin do ta bëjmë me shkrim. Është e drejta jonë. Afati medoj është tre dite për të bërë kërkesën, gjithsesi kam kërkesa të tjera.

**Z. K. Bele:** Jo jo kërkesën për përjashtim do ta ngrini tani në seancë.

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Maliqi:** Por duhet të shkruaj se kam arsyen.

**Z. K. Bele:** Arsyet thojini tani.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i BF-së:** tani nuk mund të flasë ai kundrejt të cilit...

**Z. I. Rusmali:** Të lutem prit pak. Ju avokate kérkuat përjashtimin e antarit. Ju jeni e qartë për motivin që kishit apo jeni e dyauar? Na e shpjegoni ligjërisht motivin ju lutem.

**Znj. O. Serani, avokate për zotin Maliqi:** Në rradhë të parë anëtari...

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. K. Bele:** Ne po e ndërpresim seancën... 5 minuta do të konsultohemi me njëri – tjetrit lidhur me procedurën dhe do të ju thërrasim.

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Maliqi:** Ne mendojmë se...

**Z. K. Bele:** Seanca u ndërpre 5 minuta të lutem dhe ju ftojmë të dilni nga salla.

**Rifillon Seanca**

**Ora 17:26**

**Z. K. Bele:** Riçelim seancën lidhur me kërkesën ankimore nr. 67. Kasha nevojë vetëm për një sqarim se ndoshta nuk e fiksova në mënyrë... kërkesa u ngrit fillimi shqiptar apo nga ana juaj avokate?

**Znj. O. Serani, avokate për zotin Maliqi:** E nisi avokati, por meqenëse ju hoq e drejta e fjalës vazhdova unë.

**Z. K. Bele:** nuk ju hoq e drejta e fjalës. Ka të bëjë me mekanizmin që dëgjojmë njëri – tjetrit me buton. E ka të drejtën e fjalës, gjithsesi ju veç e veç apo bashkarisht ju ftojmë të artikuloni kërkesën për atë shkak që ju konstatuat në seancë dhe ne do të shprehemi mbi kërkesën tuaj sipas praktikës që kemi në këtë trupë. Ju kujtojmë që ne ndryshe nga gjykatat e zakonshme apo trupa të tjera të ngjashme ku referoi avkati afatin 5 ditor, kemi limite Brenda të cilave çmojmë për shkelje sgjedhore. Kështu që duke qenë se kjo në kuptueshmërinë time të paktën, shkaku ishte i atypër atyshëm, ju lutem artikuloni ose në mënyrën që ju çmoni paraqitni këkresën tuaj dhe ne do të shprehemi për pjesën tonë.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. A. Llangozi, avokat për zotin Maliqi:** Shkaku nuk ka qenë i aty për atyshëm i nderuar, por për arsyet se në dijeninë time zoti Rusmali ka mbledhur informacione përmua që unë qëkam probematik dhe këtë gjë ja ka komunikuar klientit tim. Kjo është e turshme, që një komisioner si puna juaj të marrë informacione për një avokat që nuk e ka fare paë në proces. Unë për këtë përveçse ndjehem i diskriminuar, jam i fyer dhe për këtë arsyet kërkoj shkak të dytë kërkësë përpërjashtim dhe do të bëj kërkësë me shkrim të argumentuar. Kjo është e drejta ime. Unë nuk kërkoj që të ndërpritet ky proces, kërkoj që ky proces të vazhdojë, kërkesa imë të bëhet dhe të gjykohet brenda afateve ligjore që caktohen në Kodin e Procedurave Administrative. Nuk kërkoj nga ana juaj që të më privohet e drejta ime për të bërë një mbrojtje efektive. Unë do e bëj me shkrim, meqenëse ka mbledhur informacione përmua dhe do e bëj këtë... Mund ta deklaroj dhe klienti im të njëjtën gjë?

**Z. I. Rusmali:** Nuk është nevoja sepse nuk e tha Rusmali, por e thamë bashkarisht aty. Unë e vlerësoj Rusmalin si mik edhe ish-koleg, por jam në kundërshtim të paragjykimit që tha... Paragjykime kam edhe unë që atje në Kuçovë po thonë se do të kalojmë në zgjedhje përsëri në shtator, tetur edhe unë e kam gjithë shtetin, e pat gjysmën e shtetit kundër dhe do të kem shtetin të gjithë kundër, kështu që unë nuk heq dorë nga pavlefshmëria, masakra që është bërë atje. Nuk ka lidhje fare kjo sepse është bashkimi i dy ankimeve që është bërë nga avokatët tanë, kështu që nuk dua paragjykim në këtë drejtim sepse provat janë ato që dha edhe avokati i BF-së, por të dy avokatët kanë prova edhe më të shumta, edhe më të detajuara që unë jam mëse i bindur. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankiminimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Znj. O. Serani, avokate për zotin Maliqi:** Nuk kam asgjë për të shtuar. Unë vendrimin tim do e jap me shkrim, kur të paraqes edhe kërkesën.

**Z. K. Bele:** Dakord!

**Z. E Çefa:** Unë kam një pyetje për të dy avokatët. Ju doni kohë që të bëni me shkrim kërkesën për përjashtimin e kolegut dhe ndërkohë e pranoni faktin që kolegu të jetë këtu prezent ndërkohë që ju raportoni? Më duket sikur nuk kanë sens këto dy pohimet tuaja.

**Z. A. Llangozi, avokat për zotin Maliqi:** Ne kërkojmë që të jetë prezent sepse ne s'mund ta paragjykojmë vendimmarrjen tuaj. Ndoshta ajo kërkesë imja do të jetë e gabuar e ju do e rrëzoni.

**Z. E Çefa:** Ju po e parashikoni ndërkohë...Duke four në këtë mënyrë...

**Z. A. Llangozi, avokat për zotin Maliqi:** Normale, kur ju në një seancë paraprake më keni rrëzuar një kërkesë, më lind e drejta që unë të paragjykoj, por aktualisht nuk është me vendim përfundimtar, ju nuk mund të shpreheni por dhe ne...

**Z. E Çefa:** Edhe diçka tjetër ju lutem. Ju kërkon përjashtimin e kolegut Rusmali, por ndërkohë deri kur të formuloni kërkeën jeni dakord që zoti Rusmali të jetë këtu.

**Z. A. Llangozi, avokat për zotin Maliqi:** Po.

**Z. E Çefa:** Mund të ma citoni ju lutem bazën ligjore të kësaj kërkesë?

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. A. Llangozi, avokat për zotin Maliqi:** Neni 30 i Kodit të Procedurave Administrative.

**Z. E Çefa:** A mund të ma lexoni pak nenin 30?

**Z. A. Llangozi, avokat për zotin Maliqi:** Ku e kam unë detyrimin ligjor që ta formuloj aty për aty kërkesën? Unë minimalisht...

**Z. E Çefa:** Avokat nuk po ju them atë. Ma lexo pak nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative.

**Z. A. Llangozi, avokat për zotin Maliqi:** Pengesat ligjore...

**Z. E Çefa:** Më lexo nenin se interpretimin e bëj unë. Secili prej nesh mund ta bëjë këtë gjë.

**Z. A. Llangozi, avokat për zotin Maliqi:** Unë për këtë arsyе e kërkova kohën, që ta bëj saktë. Kjo është arsyjeja e lënies së kohës, sepse duhet të studiojmë ligjin. Nuk mund ta studjoj ligjin këtu aktualisht.

**Z. E Çefa:** Faleminderit që po ma lexoni nenin 30. Ju lutem ma lexoni nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative që ju e citoni si bazë ligjore në kërkesën që keni ndërmend të bëni përpara kësaj trupe.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Znj. O. Serani, avokate për zotin Maliqi:** Komisioni ushtron të drejtën e tij si një quazi – gjykatë dhe gjykata supozohet dhe prezumohet si njohëse e mirë e ligjit dhe nuk kemi ne pse të lexojmë dispozitat ligjore...

**Z. E Çefa:** Atëhesë do e lexoj unë nenin e kodit.

**Znj. O. Serani, avokate për zotin Maliqi:** Edhe diçka paraprakisht të lutem. Duke qenë se ne u paragjykuam se zvarrisim procesin dhe kemi qëllime të tjera dhe ne po ju themi se nuk kemi për qëllim të zvarrisim procesin dhe as qëllime të tjera. Kemi për qëllim të vazhdojmë një proces të rregullt.

**Z. E Çefa:** Jam dakord avokate, por kërkesa juaj mund ta bëjë absolutisht të pavlefshëm këtë procedim. Sepse ti po më thuaj mua vazhdo me personin prezent këtu, ndërkohë që nesër mund të jetë subjekt përjashtimi apo jo? Kjo mun dtë bëhet shkak për pavlefshmërinë e kësaj vendimmarje. Unë si organ administrativ nuk mund të procedoj pa u shprehur më parë për këtë kërkesë. Jam i detyruar të shprehem. Ose ta nxjerr jashtë kolegun ose kolegu të jetë këtu me ne dhe të vazhdojmë pastaj me parashtrimin e fakteve të tjera. A më kuption? Është diçka procedurale që ka precedencë ndaj ju lutem, ma lexoni pak kodin.

**Znj. O. Serani, avokate për zotin Maliqi:** Këtë vendimmarje e merrni ju. Ju na pyetët e keni problem të qëndrojë? Ne ju thamë nuke kemi problem. Qëndron apo nuk qëndron është vendimmarja juaj. Ju kërkuam kohë nuk na jepni kohë, tanë thoni çfarë doni.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. E Çefa:** Pretendoj të më citoni korrekt. As unë as kolegët nuk ju shtruan pyetje të kësaj natyre që ju pretendoni. Jun a thatë tekstualisht “ Kërkojmë përjashtimin e zotit Rusmali, por duam ta bëjmë me shkrim. Ndërkohë që ne e bëjmë me shkrim le të vazhdojë seaca. Shko tek zh-ja e alfabetit ndërkohë që jemi te germa a dhe nuk e dimë nëse germën a do e kemi këtu përpala apo do e nxjerrim jashtë. Tani ju lutem shumë më sqaroni pak bazën ligjore sepse ne duhet të marrim një vendim për këtë kërkesën tuaj, sepse ju po bëni një kërkesë paraprake për kërkesën paraprake. Ne këtu duhet të shprehemi me vendim sepse ne nuk mund të vazhdomë t'ju dëgjojmë, të rrezikojmë pavlefshmërinë e gjithë kësaj mbledhjeje duke e mbajtur zotërinë këtu ose duke e përjashtuar. Sa të më lexojnë nenin 30 të kodit ose më thoni ta lexoj unë nëse nuk e lexoni dot.

**Z. L. Braho:** Përpala se të shkoni te neni zoti Langozi na thoni sa kohë mendoni se ju duhet për ta shkruar kërkesën?

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Maliqi:** Nesër e ke gati kërkesën.

**Z. E Çefa:** Nuk kemi kohë avokat. Nuk e ndërpresim dot seancën.

**Z. E Lako:** Nuk jeni familjarizuar me seancat e KAS-it ju, por ne i kemi seancat të pandërprera. Nuk ka nesër dhe përderisa ju e keni bërë një kërkesë patjetër keni dhe një argumnt sepse ju nuk bëni kërkesa pa argument apo e keni paragjykuar kërkesën?

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Maliqi:** Sa ka ligji që unë ta paraqes?

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. E Çefa:** Atë po presim të na thoni. Ju thatë kam tre ditë kohë për të paraqitur kërkesën me shkrim. Tani unë të pyeta. Ta lexoj dhe unë se nuk e di këtë informacion. Më oriento që unë ta gjej dhe të them që ke të drejtë.

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Malqi:** Duhet të studioj ligjin.

**Z. E Çefa:** Ky nuk është argument zoti avokat. Duhet të studioj ligjin nuk ka argument.

**Z. K. Bele:** Avokat për ta rikthyer procesin ku ishim. Ne ju riftojmë nëse ju ndjeheni gati ta artikuloni kërkesën tuaj. Nuk është kusht citimi i ligjit për të bërë kërkesën. Ju bëni kërkesën siç ju e kuptioni ligjin dhe ne do të përgjigjemi siç ne e kuptojmë ligjin. Nëse jeni në gjendje ta bëni tani do të ndihmonte procesin.

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Malqi:** Pushteti i kërkesës është e drejtë e jona. Ju keni ë drejtë vendimmarrje. Kjo është e drejtë e imja dhe unë kërkoj kohë. E vlerësoj unë atë arsyen që dua të vë.

**Z. K. Bele:** Atëherë për record ju tërhiqëni nga bërja e kërkesës në këtë moment është korrekte kjo?

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Malqi:** Unë nuk tërhiqem, kërkoj kohë që ta bëj kërkesën me shkrim.

**Z. K. Bele:** Çfarë kërkon? Kërkon të ndërpritet procesi?

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Malqi:** Asnjëherë nuk e kërkoj ndërprerjen e procesit.

**Z. K. Bele:** Atëherë sa kohë kërkon avokat?

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Malqi:** Ditën e nesërme në orën 8:00 e kam kërkesën të depozituar.

**Z. E Çafa:** Më cito bazën ligjore që e lejon këtë kërkesë tuajën dhe këtë afat që ju pretendoni të lutem.

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Malqi:** Ku e kam unë bazën ligjore që ta citoj tanë?

**Z. E Çafa:** Të lutem shumë më thuaj nenin përkatës ku e lejon afatin që ju të merrni kohën që doni për të bërë këtë lloj kërkese procedurale në këtë lloj procedimi të posatshëm administrativ.

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Malqi:** E drejta është e parashikuar në ligjin për avoatinë. Ligji për avokatinë më jep të drejtën mua që unë të marr kohën e mjaftueshme për të bërë kërkesa.

**Z. E Çafa:** Na e lexo njëherë atë dispozitë të lutëm . dispozitën për ligjin mbi avoatinë.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Maliqi:** A mund ta di unë se ku e kam unë bazën ligjore që ta bëj tanë?

**Z. E Çefa:** E keni online. Ti japim administratës 5 minuta kohë?

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Maliqi:** Ne kërkojmë, ju rrëzojini.

**Z. E Çefa:** Jo ne kërkojmë ju rrëzojini nuk shkon. Ti mund të kërkosh duaSkënderbeun të ma sillni në sallë tanë ne të mblidhemi në dhomë këshillimi dhe të trajtojmë këtë kërkesë? A është serioze kjo?

**Z. L. Braho:** Avokat ju kërkon kohë për të shkruar kërkesën apo doni kohë për të gjetur prova? Këtë na sqaroni.

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Maliqi:** Prova kam me thasë unë.

**Z. L. Braho:** Ku i keni provat. Nëse ju duhet kohë për të shkruar, a ka mundësi administrata e KQZ-së ti ofrojë një ambjent avokatit për të shkruar kërkesën. Meqenëse e do me shkrim të argumentuar. Keni mundësinë ti japni akses në një kompjuter të shkruajë kërkesën dhe ta lëmë për çështje orësh?

**Z. K. Bele:** Zoti avokat duke qenë se procesi i rregullt ligjor që u citua edhe nga ju për ne është shumë i rëndësishëm, Duke qenë se nuk është në natyrën e këtij procesi të krijojmë debate në këtë fazë as në çfarëdolloj faze sepse ne marrim provat dhe shprehemi me provat. Gjithsesi të ndodhur në këtë situatë meqenëse ju

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

kërkon kohë ju propozoj të merrni një kohë të arsyeshme deri në orën 18:00, 20 minuta, shkruajeni kërkesën nëse ju e çmoni lidhemi përsëri në orën...

**Z. A. Llangozi, avokat për zotin Maliqi:** Nuk e kam mundësinë ta bëj për 20 minuta. Mirë më fal do e bëjmë ndryshe. Ta diskutojmë. Ndoshta klienti im do të heqë dorë. Është e drejta e tij. Unë avokat jam.

**Z. L. Maliqi, kandidat për kryetar për Bashkinë Kuçovë:** Mirë mund të ndërhyj pak për shkak të njohjeve, por jam kundër paragjykimeve dhe meqenëse miku im, në rastin konkret zoti Rusmali, tha që ju kërkon gjë tjeter për gjë tjeter, unë jam i detyruar të them edhe tjetrën, që juve si trupë sot, ky ministër i rendit, Çuçi, duke ditur që procesi është në ankirim, e ka ditur në orën 05:00 që do të ishte sot përfundimi pothuajse, se deri ne 05:00 do të ishte, kanë mbledhur partinë socialiste, festë me birra dhe redbull për fitoren e kryetarit të tij. Mbase sot ju do jepni vendimin, po paragjykoj unë tani, meqenëse do jepni vendim për ta, unë për zotin Rusmali jam dakort të vazhdojë pavarësisht çfarë vendimi merr në rastin e gjykimeve që, edhe provave që do të përjashtohen. Faleminderit! Po jo mo jo se Çuçi dhe oligarku Salillari dhe sot ishte avokatja këtu. Sot ka qënë avokatja këtu e Salillarit, tani para nja një ore. Unë e di këtë gjë që çfarë nuk bëjnë ata, kështu që unë s'dua të paragjykoj por jam i detyruar, përderisa ata festojnë kur s'ka vendim akoma jam i detyruar.

**Z. K. Bele:** Atëherë që të kthehem tek kërkesa për të vazhduar procesin mbasi janë në pritje dhe kolegët tuaj të Kamzës dhe ne duhet të marrim një vendim. O do vazhdojme me ata, të ndërpresim seancëndhe do të ju ftojmë ju mbas një apo dy orësh, sa do të vazhdojë

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

ajo seancë, ose nëse ne bëjmëkërkësën tani apo heqim dorë nga këekesa sicc e kuptova unë , vazhdojmë seancën me parashtrimet. Pra, është korrekte heqja dorë nga kërkësa në kohë rekord dhe të lutem avokat vazhdojme ku ishim me parashtrimet tuaja.

**Z. A. Llangozi, avokat për zotin Maliqi:** E kam theksuar që në fillim që kam edhe dy kërkësa të tjera dhe i kam me shkrim dy kërkësa.

“ Në bazë të nenit 66 të kodit të procedurave administrative kërkoj pezullimin e shqyrtimit tëankimit për këtë ccështje, për arsyet se referuar ligjit, referuar vendimit të dhënë nga ana juaj menumëri 136 të vitit 2023, rezulton se në pikën 2 të këtij vendimi ju keni vendosur rrëzimin e kërkësëssose ankimit për pikën, për pikat që unë kam ngritur dhe rrëzimi nuk presupozon një vendim të ndërmjetëm por është një vendim përfundimtar të cilën, në mënyrë absurd nga ana juaj, është vendosur që në seancën paraprake, por duke qënë se mua më jepet e drejta për të bërë kërkësë padi në kolegjin zgjedhor gjygjësor, i jam drejtuar këtij kolegji me padi ku kërkoj shfuqizimin e vendimit me numër 136, dt. 24/05/2023 dhe këtë kërkësë për pezullim e kam me shkrim dhe arsyet janë se nëse gjykata, kolegji gjygjësor do të vendosi, kundër vendimmarrjes tuaj, atëherë ajo që unë kam kërkuar do të gjykohet e plotë përpara jush dhe unë kërkoj pezullimin se kemi të bëjmë me një gjygjvarësi më saktë, kemi një proces që aktualisht këtu është i hapur, kemi dhe një proces ne Kolegjin Zgjedhor që është i hapur. Kam të drejtë apo s’kam të drejtë në ato pretendime që unë ngrita, për këtë arsyet kerkova edhe revokim që ta përfundoja këtu këtë proces por përderisa nga ana juaj nuk m'u dha kjo e drejtë unë jam drejtuar me kërkësë padi, brenda afateve ligjore kërkësën për pezullim, e kam edhe me shkrim, e depozitoj para jush.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. K. Bele:** Keni ndonjë kërkesë tjetër paraprake apo varet nga rezultati i kësaj?

**Z. A. Llangozi, avokat për zotin Maliqi:** Varet nga rezultati i asaj kërkese.

**Z. K. Bele:** Dakord! për ekonominë mendova se mund të ngriheshim bashkë. Palët e tjera lidhur me këtë kërkim, përfaqësuesi i koalicioni lidhur me këtë kërkesë keni qëndrim?

**Z. A. Kazaj, përfaqësues i BF-së:** Nuk kam asnje qendrim, jam dakort me kërkesën e bërë nga ana e...

**Z. K. Bele:** Pala tjetër, përfaqësuesi i zotit Legisi?

**Z. M. Legisi, përfaqësues i PS-së:** Po faleminderit! Të mos pranohet kërkesa për të gjitha arsyetimet që u bënë më përpara në këtë debat në lidhje me nëse është metodikë apo objekt. Ne vlerësojmë që kërkesa është e pabazuar.

**Z. L. Braho:** Për faktin që avokati thotë kam bërë padi në kolegj në lidhje me vendimin tonë, se ai 136 është vendimi jonë dhe kanë bërë padi në kolegj, dhe kolegji normalisht që ... pra, duhet ta presim ne Kolegin sipas teje apo duhet të vazhdojmë gjykimin pa pritur kolegjin?

**Z. M. Legisi, përfaqësues i PS-së:** Absolutisht jo, nuk duhet të pritet kolegji. Është pa asnje lloj efekti. Faleminderit!

**Z. E. Çafa:** Unë kam një pyetje. A keni një dokument që e vërteton që e keni depozituar padinë në kolegj?

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. A. Langozi, avokat për zotin Maliqi:** Është mandati i postës, i nderuar...

**Z. K. Bele:** Është mandati i postës që ka një kërkesë padiè, pra është depozituar para dy ditësh. Mirë kemi pyetje të tjera?

**Trupa e KAS-it:** Jo.

**Z. K. Bele:** Mirë atëherë KAS duke konstatuar këto kërkesat e tjera po tërhiqet dhe do të ju njoftojmë për pak në lidhje me vendimin.

**Rifillon seanca**

**Ora 18:01**

**Z. K. Bele:** Mirë ricelim seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesës 67 bashkuar me 74. Pra riçelim seancën lidhur me kërkesën e bërë nga pala ankuse për pezullimin e shqyrtimit të ankimit kundër vendimit të ndërmjetëm, pikës dy të vendimit nr. 136. Nga verifikimi na rezulton se në dt. 29.05.2023 rezulton të jetë dërguar një padi sipas dëftesës postare pranë Kolegjit Zgjedhor. N këto kushte KAS vendos të pranojë kërkesën për pezullimin duke i kërkuar administratës të interesohet pranë Kolegjit Zgjedhor për ecurinë e çështjes si dhe të bëjë kërkesë për shpejtimin nga Kolegji të gjykimit te këtij kërkimi, në respekt të afateve ligjore. Lidhur me shqyrtimin e kërkesave ankimore në këto kushte, duke qenë se nuk mund të caktojmë një seancë, mbasi varemi nga Kolegji, pra nga momenti i

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

gjykimit në Kolegj do të njoftojmë nëpërmjet administratës lidhur me seancën e radhës për këtë çshtje. Me kaq seanca deklarohet e mbyllur!

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*

 /

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**01.06.2023  
Ora 18:06**

***RENDI I DITËS***


**"Për shqyrtimin e kérkesës ankimore nr.81, me subjekt ankues: "Koalicioni Bashkë Fitojmë" si dhe kérkesës ankimore nr.86, me subjekt ankues: Partia Lëvizja e Legalitetit"( Kamëz).**

**PJESËMARRJA :**

- KAS: Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj
- Parti Politike: BF, PS
- Të tjera: KRIIK

**Z. E. Lako:** Atëherë, çelim seancën publike për shqyrtimin e kérkesave ankimore nr. 81 të depozituar nga subjekti zgjedhor Koalicioni Bashkë Fitojmë si dhe numër 86 të depozituar nga subjekti zgjedhor Partia Lëvizja e Legalitetit. Seanca e kaluar u ndërpren me qëllimin që përsa i përket kérkesës së parë ankimore subjekti të kishte kohë në lidhje me provat e marra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si dhe ti krijonim mundësinë administratës në lidhje me kérkesën e dytë për të sjellë materialet zgjedhore të dy QV të kerkaur nga subjekti Partia Lëvizja e Legalitetit për dy QV 1575/00 dhe 1597/02. Shoh që nga administrata është bërë e mundur që këto materiale të vijnë pranë mjediseve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në mbledhjen që po zhvillojmë. Prezente është në përbërje të plotë trupa e KAS, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përfaqësuar nga Sekretari i

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

Përgjithshëm si dhe shoh që janë përfaqësuesit e të dy subjekteve ankues edhe të palës së interesuar siç kemi vendosur .

***Palët në proces:*** Prezent

**Z. E. Lako:** Atëherë, pa humbur kohë le të fillojmë duke ia dhënë fillimisht sipas numrit të kërkesave për shqyrtimin e kërkesës ankimore numër 81 për subjektin zgjedhor Koalicionin Bashkë Fitojmë, po zoti Nuri fjala është për ju.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së:** Faleminderit zoti Lako! Fillimisht desha të parashtroi shkurtimisht një kërkesë që ne kemi depozituar pak më parë në protokollin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e cila ka të bëjë me vënien në dispozicion është kërkesë e përsëritur, vënien në dispozicion të kamerave të QV. E theksoi është e përsëritur si kërkesë këtu kemi listuar zoti Lako dhe anëtarë të nderuar të KAS të gjithë QV ku na janë dhënë kamera në dispozicion ndërkohë që ka qëndra që nuk na janë dhënë në dispozicion. Ndryshe nga sa na u tha dje këtu në këtë seancë edhe nga përfaqësuesit e KQZ-së sipas të cilëve të gjithë kamerat ishin vënë në dispozicion. Më konkrentisht ne na janë vënë në dispozicion vetëm 69 pamje filmike pra nga 69 QV nga mbi 130, 133 janë saktësisht në Kamëz që duhet të ishin vënë në dispozicion. Nga 69 filmime ne kemi marrë vetëm 23 pamje ku janë pamje të qarta ku mund të shihen edhe veprime. Ndërsa në 46 QV pamjet nuk përfshohen , nuk është e mundur domethënë që të shihen qartë veprimet e personave, qoftë për shkak të pozicionimit të kamerës qoftë për cilësinë e dobët apo mungesë totale të filmimeve. Pa dashur tiu marrim më tepër kohë, ne i kemi listuar të gjithë QV nga 1 deri 133 me numrat përkatës sipas QV dhe aty anash kemi bërë edhe saktësimin nëse kamera ka qenë nuk ka qënë . ka qënë në rregull filmimi etk etj. Siç mund ta shikoni kemi vetëm

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

çerekun e kamerave për të mos thënë më pak që janë të shfrytëzueshme. Megjithatë, zoti Hoxha kandidati do tua sqarojë edhe më mirë, nga ato pak kamera që na janë vënë në dispozicion...

**Z.A. Hoxha, kandidati i BF-së:** Rreth 23 kamera që është arritur 15 prej tyre mund të përftojnë, ndërsa 13 kanë shkelje flagrantë të përsëritura me nga 60-70 edhe më tepër shkelje flagrante ku operatorët votojnë më shumë se sa një e dy e më shumë se pesë raste ku votojnë edhe anëtarët e komisionit. Ku votimi masiv, kolektiv është i pranishëm gjatë gjithë ditës, ku ka shkelje të hapura flagrante të cilat ne do tua paraqesim edhe në pamje filmike unë i kam me CD do tua paraqes si provë por edhe të printuara me foto megjithëse fotot thjesht tregojnë një veprim të shkurtër por në rast se do të ndiqet me pamje filmike unë e kam shkurtuar përfekt kohe dhe përfundur vënë në dispozicion që të jetë e mundur përfundur parë nga ana e komisionit, ku do të jetë nga 3-5 minuta secila nga këto, gjithsesi ato tregojnë hapur QV që vetëm votim nuk ka qenë ky i datës 14 Maj të paktën në QV në këto 13 që ne kemi arritur edhe përfundur një kohë rekord, kemi arritur që ti dokumentojmë shkeljet e hapura të procesit gjatë datës 14 Maj, në këto QV konkrete, faleminderit.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së:** Më lejoni që tua vendos në dispozicion disqet me provat.

**Z. E. Lako:** Më falni, se mbase edhe unë nuk e kuptova qartë, se pati pretendim që nuk janë vënë në dispozicion të gjithë pamjet filmike nga ana e KQZ-së apo këto pamje filmike nuk janë të qarta domethënë që ta qartësojmë këtë.

*Zbardhi materialin audio*

*Ardita ÇAMI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së:** Të dyja edhe nuk na janë vënë në dispozicion të plota ndryshe nga sa u tha dje këtu edhe ato që na janë vënë në dispozicion e para që nuk janë të plota, ka filmime që nuk mungojnë faqe në QV të caktuara, ka filmime ku është erësuar ekrani apo është blur po themi i pa shfrytëzueshëm. Ka filmime ku kamera është orientuar poshtë, konkretisht nuk duket fare se çfarë bëhet në ....

**Z. E. Lako:** Në rregull në ato që është, ku mundet që është që kamera nuk tregon pamjen e qartë, mbase nga vetë administra e komisionit qendror të votimit ose e atyre që përgatisin vendosjen e kamerave. Nuk janë vendosur ndoshta në pozicionin e duhur po ka ndonjë koment nga ana e administratës për këtë pretendim, zoti Merkaj domethënë nuk janë vënë të gjithë pamjet filmike apo një pjesë e tyre nuk dallohen apo mungojnë sipas pretendimit të ankuesit?

**Z. Y. Merkaj:** Aktualisht kaq sa kishim, pavarësisht se i thamë janë të gjitha kështu na u tha nga kompania, aq kamera kishim regjistruar që janë vënë në dispozicion në lidhje me pamjet...

**Z. E. Lako:** Aq kamera domethënë jo çdo QV ka pasur kamera?

**Z. Y. Merkaj:** Jo, jo. Kompania kishte transferuar të dhënat e regjistruara në këto QV pavarësisht se nga kompania thanë që i kemi rregjistruar të gjitha. Aq sa tha i kemi dhënë...

**Z. E. Lako:** Po pse?

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. Y. Merkaj:** Se po vazhdon transferimi i të dhënave nga kamerat në sistemin e KQZ-së.

**Z. E. Lako:** Nga ankuesit keni pasur ndonjë pretendim konkret për ndonjë QV që ju pretendoni me indicie edhe për atë qëndër nuk keni marrë ndonjë pamje filmike ka ndonjë gjë konkrete apo kështu apriori?

**Z.A. Hoxha, kandidati i BF-së:** Jo, apriori. Ne kemi depozituar që në kërkesën paraprake pretendimet tona dhe me foto për shëmbull QV 2241/1 në Babrru. Operatori ulët se përton të rrij edhe në këmbë dhe ndërhyrë në mënyrë të hapur në monitor. Ajo kamer që është me foto atë ditë e keni edhe në ankesën tonë, sot nuk na është vënë në dispozicion po bën shënimë është e turbullt dhe përfshohen pamje. Ndërkohë që në ditën e votimit pamja është shumë e qartë. Kjo është absolutisht, e keni në CD edhe në materialin që na keni dhënë mund të kqyret edhe absolutisht unë kam bindjen që është e qëllimshme.

**Z. E. Lako:** Ka ndonjë koment nga administrata për këtë QV konkrete 2241/1.

**Znj. D. Alimemeti:** Për këtë QV konkrete nuk kam asnje koment por është kërkuar nga zotëria, nga koalcioni është kërkuar pamjet e të gjithë kamerave të Kamzës dhe nuk është specifikuar në asnje moment një QV e specifikuar që të kishin prioritete ose të ndanim le të them QV nga të tjerat. Do të thotë që kompania ka marrë ka tërhequr pamjet filmike cilësia e tyre është standarte, është e enkriptuar dhe kërkon kohën e tyre prandaj kjo vonesa le të themi që ka kaluar një pjesë e informacionit dhe për pjesën e cilësisë ose vendosja e kamerave është proces tjetër pastaj është si

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

e kanë përdorur si e kanë vendosur kamerën. Është element jo teknik le të themi nuk lidhet me sistemin.

**Z. E. Lako:** Për sa i përket vendosjes së kameras është një problem që është diskutuar edhe në një çështje tjetër. E merr përsipër kompania këtë vendosjen në mjediset apo edhe KQV ka përgjegjësi për mënyrën se si filmohet dhe ..

**Z. Y. Merkaj:** Atë e vendos operatori që është për PEI dhe për kamerën. Ideja është që operatori nuk e shikon në monitor se çfarë shikon në QV kamera. Ai me një hamendje e vendos në një pozicion që të ruhet fshehtësia e votës dhe të jetë përballë dhomës së fshehtë.

**Z. E. Lako:** Nuk ka verifikim të pamjes që jep kamera në momentin kur vendoset nga operatori?

**Z. Y. Merkaj:** Jo, jo

**Z. E. Lako:** Po zoti Braho?

**Z. L. Braho:** Tani këtë punën e hamendësimit po në kohë reale e sheh dikush kompania këto kamerat? Po si gjithsecili mund të abuzoj, çdo operator....

**Z. Y. Merkaj:** Është sistem i mbyllur thjesht rregjistrohet në kartën që ka kamera dhe pastaj hiqet karta..

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. L. Braho:** Kush e mban përgjegjësinë që një kamera pavarësisht se ka rregjistruar gjithë ditën, ka rregjistruar një material që është krejt irrelevant?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së:** Nëse mundet një sqarim për...

**Z. E. Lako:** Po zoti Nuri!


**Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së:** Në listën që kemi paraqitur për të gjithë kamerat e për të gjithë QV që na janë vënë në dispozicion kemi disa dhe mund ti citojmë jo vetëm që pamjet janë të turbullta po nuk ka filmime fare. Për shëmbull në QV 2047 nuk ka filmime kamera është bosh. E njëjtë gjë filmime bosh në QV 2049/2 thjesht për ilustrim.

**Z. E. Lako:** Për këtë QV 2047 që nuk ka pamje përshëmbull, ka ndonjë pretendim konkret, domethënë është e rastësishme që nuk ka pamje apo ju pretendoni diçka? Çfarë ka ndodhur që mund të jetë evidentuar tek libri i protokollit apo ju gjatë vëzhguesve atë për QV ka ndonjë gjë konkrete? Apo thjesht evidentohet vetëm që nuk shikohet, nuk duket pamja nga kamera?

**Z.A. Hoxha, kandidati i BF-së:** Më fal të gjitha këto edhe në kërkesën tonë, janë dhënë prova sepse ne nuk mund të kishim prova paraprake, pamje filmike pavarësisht indicieve dhe ankesave të shumta siç ne e kemi paraqitur në kërkesën paraprake që kemi vënë në lëvizje këtë trup të ankimit tonë administrativ. Kishte ankesa të shumta të ardhura në shtabin tonë elektoral për ndërhyrje në proces, gjatë gjithë ditës në thaujse në të gjitha QV. Ne kemi listuar tre- katër QV që vërtet kanë qenë korrekt operatorët dhe komisioni por që janë në minoranca aq të vogël që po të

*Zbardhi materialin audio*

*Ardita ÇAMI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*


shihen të gjitha qëndrat nuk kapin as 10% të qëndrave që trupa e komisionerëve dhe operatorëve kanë zbatuar vërtet detyrimin e tyre. Nga 15, 13 kanë shkelje të hapura të procesit zgjedhor, kanë votim të drejtëpërdrejtë jo intimidim jo thjesht intimidim, votim të drejtëpërdrejtë nga ana e operatorit. Operatori voton mbi 5 raste, anëtarja e komisionit shkëputet dhe shkon e voton bashkë me votuesin , kryen të gjithë procedurën e votimit. Është e hapur dallohet lehtësisht edhe me sy në pamje filmike që ndizet drita në momentin që voton, drita e kutisë pra që kryehet komplet procedura e votimit nga ana e operatorit dhe anëtarës së komisionit. Absolutisht janë vepra penale nuk është vetëm kjo, sepse do ta adresojmë edhe në institucione të tjera por gjithësesi. Absolutisht po thjesht për ta vënë në dijeni trupën ...

**Z. E. Lako:** Mos ta kthjejmë në gjëra që siç e thatë edhe ju mund të shqyrtohen në një hetim...Për hetimin tonë administrativ për këto që ju pretendoni apo që keni marrë nga kamerat ku disa duken disa nuk duken ka ndonjë dokumentim fakti në librin e protokollit nga KQV në lidhje me këtë pretendim, ka ndonjë diçka të dokumentuar apo të shkruar? Sepse ju keni pasur përfaqësues në atë KQV, pra ka ndonjë shënim diku apo donjë evidentim sepse nga kamera shumë herë edhe mund të japi ndonjë përshtypje të gabuar përshëmbull pa e paragjykuar. Mund të japi përshtypje sikur dikush që operatori mund ti ketë ...

**Z.A. Hoxha, kandidati i BF-së:** Sinqerisht unë i kam shmangur aludimet, për një ose dy raste në një qëndër. Një rast ose dy raste që mund të ketë afruar operatorin ndoshta edhe për ndonjë problem teknik. Por kur operatori gjatë gjithë ditës ndërhyjn në mënyrë të përsëritur unë e kam ilustruar dhe ka ...

**Z. E. Lako:** Po komisioneri nuk ka reaguar përshëmbull?

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z.A. Hoxha, kandidati i BF-së:** Asnjë komisioner nuk ka reaguar dhe ai mund të ketë shpërdoruar detyrën apo mund të ketë kryer krim zgjedhor nuk e përjashtoj as komisionerin, që mund të ketë qenë ndoshta jo në lartësinë e duhur të përgjegjësive të tij. Por gjithësesi ky nuk është një rast sporadik për një, dy ose tre raste që unë i kam parë gjatë gjithë ditën në QV nuk jam marrë fare me to i kam kaluar. Por, pjesa tjeter që në mënyrë të përsëritur permanente duke rakorduar me njëri tjetrin, duke komunikuar me njëri tjetrin dhe duke influencuar drejtëpërdrejtë në votim dhe në rezultatin përfundimtar atëherë unë jam absolutisht mbi këtë bazë ankohem. Nuk e bëj ankesën thjesht për ankesë për të kaluar procedurën, absolutisht jo, as tiu harxhuar kohën ju, as mua.

**Z. E. Lako:** Nuk po e paragjykon njeri, ne prandaj jemi këtu, për tiu shërbyer edhe për ta bërë sa më transparentë procesin. Por duke pasur parasysh rregullat se si funksionon i gjithë procesi zgjedhor sidomos edhe dita e votimit. Ka një procedurë të caktuar se si hynë votuesit në QV, si mbahet rradha, si veprojnë dhe kur ka shkelje të kësaj natyre ka një procesverbal që e mban sekretari i KQV-së dhe çdo kush mund të shprehet dhe të kërkojë pezullimin e procesit. Ka ndonjë evidentim të tillë nga komisioni sepse i bie që jo vetëm operatori por edhe komisioni të gjithë nuk paskam funksionuar atë ditë.

**Z.A. Hoxha, kandidati i BF-së:** Atë ditë unë kam njoftuar me anë të telefonit tim, kam njoftuar për pa rregullsi, për bllokim, për intimidim, për ndërhyrje të personave të pa autorizuar në QV edhe shefin e komisariatit të policisë zotin Oligert Torba, me anë të telefonit tim personal edhe ai në telefon personal sepse 41 e kishte fikur. E kam informuar në lidhje me rastin, mediat po ashtu, kam shkuar në disa QV mua

*Zbardhi materialin audio*

*Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

nuk më lejonin të hyja brenda se kishin terezitë e veta, i prishja atë rreshtin se si e kishin ...

**Z. E. Lako:** Kandidati me sa di unë...

**Z.A. Hoxha, kandidati i BF-së:** Jo kandidati mund të hyjë ti përshëndesi, unë nuk do të hyja në QV. Aty në koridor i përshëndes, se institucion ishte, absolutisht unë nuk jam natyrë që mund të hyjë të intimidojë askënd aq më pak komisionin. Po hyja së bashku me përfaqësuesit e Partisë Socialiste,

**Z. E. Lako:** Unë e di që është e ndaluar...

**Z.A. Hoxha, kandidati i BF-së:** Nuk është e ndaluar por në çdo rast kjo është praktikë, që kandidatët kanë hyrë dhe i kanë përshëndetur të majtë, e të djthë, e të pa parti çfarë kanë qenë aty. I kanë dhënë dorën, i kanë uruar suksese, nuk është ndonjë shkelje absolutisht. Jam ndaluar me qëllim që të mos hyja në ato QV dhe ata të bënin atë çfarë bënë, jam ndaluar pikërisht në Valias të vjetër tek QV ku ka mbi 70 votime nga operatori dhe anëtarja e komisionit, punonjësja përgjegjësja e UKK-së që i kam evidentuar edhe me emër mbiemër edhe nga operatori po ashtu. Që janë përfaqësues të Partisë Socialiste dhe të kandidatit Rakip Suli. Pra, vetëm në atë QV kemi 70 votime raste flagrante që po të hapen vetëm votim nuk quhet. Unë nuk e di kam marrë pjesë si person në të gjitha rastet e votimeve por si ai votim unë nuk kisha parë ndonjëherë.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së:** Mund tua vëmë në dispozicion CD këto që kemi arritur të administrojmë. Administrata ju lutem!

*Zbardhi materialin audio*

*Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. E. Lako:** Patjetër ti administrojmë.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së:** Edhe provat me shkresa ndoshta?

**Z. E. Lako:** Po.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së:** Kemi gati edhe disa dosje shtesë.

**Z. E. Lako:** Mundemi zoti Merkaj se mbase nuk mund ti disponojmë të gjitha, po dikë nga ato që mund të jetë rasti më flagrantë ose...

**Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së:** Ne prandaj kërkuaam monitor që dje.

**Z. E. Lako:** Ndërkohë administrata të marri masat. Ndërkohë për ta menaxhuar sa më....

**Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së:** Edhe provat e tjera i depozituam me pamjet filmike.

**Z. E. Lako:** Për sa i përket grupit që do merret me numërimin e këtyre dy QV-ve kqyrjen. Janë gati zoti Merkaj të dy grupet?

**Z. Y. Merkaj:** Po.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. E. Lako:** Ti ngrejmë të dy grupet dhe kandidati ndërkohë që ne shohim pamjet, mundet që ne duke parë pamjet ndërkohë edhe të të filloj procesi mos ta...

**Z. Y. Merkaj:** Patjetër.

**Z. E. Lako:** Po bëhen gati të dy grupet kështu që edhe ju mund ta kqyrni në moment... Kur të bëhen gati mund ta kqyrni. Do kqyren materialet vetëm për këshillin Edhe ju drejtoresha do të jeni aty për ti mbikqyrur besoj, mirë faleminderit. Ndërkohë sa të bëhet gati edhe monitori me ankuesin tjetër në këto moment nuk kemi ndonjë gjë, sepse do të filloj kqyrja e materialeve atje. Pala e interesuar ka ndonjë koment në lidhje me pretendimet që u thanë deri tani në këtë fazë?

**Z. M. Legisi, përfaqësuesi i PS-së:** Jo, nuk kemi koment, dakord të vlerësohen provat sipas kërkësës, faleminderit.

**Z. E. Lako:** Nga anëtarët ndonjë pyetje, apo ti shohim njëhër? Dakord sa të bëhet gati...

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. E. Lako:** Mirë, atëherë e vazhdojmë seancën aty ku e lamë. Mbaroi këqyrja e materialeve zgjedhore për sa i përket dy QV-ve: 1575 dhe 1597/02 të Bashkisë Kamzë. Në përfundim të këqyrjes së këtyre materialeve, ku pamë edhe kutitë edhe votat për këshillin bashkiak dhe ato për kryetar të bashkisë. Zoti Merkaj ju lutem, në lidhje me tabelat e përpunuara këtu, në bazë të numërimit që u bë në mjeshter e KQZ-së, cili është rezultati, pra në përfundim të përpilimit të këtyre tabelave?

**Z. Y. Merkaj:** Po, sipas urdhërimeve të KAS-it, u bë numërimi i dy qendrave të votimit, qendra e votimit nr. 1575/00 dhe 1597/02 dhe në përfundim të procesit u plotësua tabela e rezultatit për çdo qendër votimi. Rezultati përputhet me rezultatin e sistemit elektronik të ardhur nga qendrat e votimit, nga usb-të e pajisjeve PEVN. Kështu që është i njëjtë me rezultatin e burimit.

**Z. E. Lako:** Pra, nga këqyrja rezultoi se shifrat, si për anëtar këshilli, si për kryetar bashkie, për këto dy QV, janë ato të raportuara në sistemin elektronik, nga këqyrja fizike. Kështu që, në këtë rast KAS i konsultuar në vend me vendim të ndërmjetëm do t'i vlerësoj si të rregullta këto dy rezultatet e këtyre dy QV-ve, dhe do t'i përfshijë në rezultatin përfundimtar të Bashkisë Kamëz, me vendimin përfundimtar që do të marrim në fund të këtij procesi. Ankuesi ka ndonjë koment në këtë fazë në lidhje me këtë? Mirë faleminderit, ne do vazhdojmë me pjesën tjetër të ankimit. Ju mund të rrini, si ta vlerësoni vetë sepse nuk e dimë se si do zhvillohet, por gjithsesi..... Faleminderit! Atëherë vazhdojmë me koalicionin “Bashkë Fitojmë”, besoj se kamerat, filmimet janë gati, dhe ne mund të vazhdojmë më këqyrjen e këtyre pamjeve filmike. Ju lutem, përfaqësuesit mundet që edhe nga vendi mund të na shpjegoni çfarë pretendoni në lidhje me këto pamje?

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Atëherë këto janë pamjet e qendrës së votimit 1577/1, operatori, siç shikohet qartë voton komplet procedurën e votimit. Votuesja thjesht afrohet, dhe nuk kryen asnjë veprim sipër monitorit por, po ta shikosh nga fillimi, i kryejnë të dy veprimet edhe përzgjedhjen e votimit të kandidatit edhe konfirmimin e fletës së votimit, pra nuk preket fare tastiera nga ana e votueses, përveçse shkel absolutisht distancën, shkel çdo lloj detyrimi. Aty janë dy zgjedhës bashkë. Përsëri, po ta shikoni operatori afrohet dhe kryen të gjitha veprimet në monitor. Pra votuesit thjesht kanë pasur rol pasiv aty. Shikoni si afrohet.

**Z. L. Braho:** Kush është operatori?

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Operatori është ai me jek portokalli. Zgjatet në ekran edhe voton. Jo, shikoje, ktheje edhe një herë nga fillimi. Shikoje nga fillimi. Ja plakë, vetë e dyta është ajo. Ja si voton! Ky voton nga këtej. Sepse në të tillë pozicion është vendosur kamera.


**Z. E. Lako:** Është ky i vendosur nga pjesa prapa?

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Po. Nga pjesa mbrapa. Shikojeni si zgjatet nuk është se e zbaton atë detyrimin e tij që ka thjesht për t'i orientuar në distancë, për të ruajtur distancën, afron dhe kryen veprime aktive sipër monitorit. Në pamjen e parë, ktheje nga e para ai kryen çdo veprim...që të duket më qartë të pjesa e parë. Video e parë. Kush po e komandon, se nuk e kam idenë?

**Z. E. Lako:** Mund ta shofim edhe një herë videon e parë?

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Jo jo të parën. Të parën që u shfaq.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. I. Rusmali :** Jo, jo, këtë tjetrën.

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Që votoi ajo gruaja vetëm. Anëtar i komisionit, vëzhgues është ky tjetri, anëtar i komisionit, ai që afrohet përballë, dhe ai i shkel ato, por të paktën ai nuk ka kryer ndonjë veprim. Shikojeni tani si afrohet përsëri, shikojeni si afrohet. Kryen veprime sipër.

**Z. L. Braho:** Po ai cfarë bën ?

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Nuk ka asnje rol ai aty. Ai voton. Si jo?! Shikoje!


**Z. L. Braho:** Dua të shoh edhe një herë atë gruan, se e pashë te komisioni po dua të shoh, a voton apo jo?

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Ja, këtu, ja shikojeni, prit, do afrohet, shikojeni, i tregon se ku duhet të votojë.

**Z. E. Lako:** Orientim po e quajmë.

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** ja shikojeni tani, u prek ekrani. Prit, ai nga sipër, po direkt, ja se është.... tani konfirmoje - thotë, por se merr vesh xhaxhi. Prit, shikojeni tani tjetrën, 2 persona në një qendër votimi, pra kuptohet, pa plotësuar asnje deklaratë shoqërimi që e kanë detyrim. Ky ishte një rast votimi familjar. Shikoni si pret akoma ai, që kërkoi votimin e njërit person. Po ta shikoni, që ka shoqëruar njërin person, dhe pret po në qendër të votimit. Shoqëron personin e dytë, pa plotësuar

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

asnje deklaratë. Nuk e dimë a është familjar. Votim kolektiv. Mund të jetë, me shumë gjasa. Kryen veprimi.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së:** Mendojmë se është votim familjar. Përderisa janë dy zonja, shikojeni si i fut dorën. E para dy persona s'lejohen të rrinë prapa monitorit. 2 persona që votojnë njëkohësisht.

**Z. E. Lako:** Mirë, besoj se ky pretendim që keni ju për këtë lloj, e këqyrëm d.m.th. që operatori... Ka ndonjë tipologji tjetër shkeljeje? Ka një pyetje zoti Çefa.

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Po ka edhe një diçka tjetër.

**Z. E. Çefa:** Tani sipas statistikave që ju keni arritur të mblidhni, në ato qendra votimi që keni parë kamerat, sa përqind është pesha e shkeljeve të prezumuara sipas Jush? Të kësaj lloj tipologje.

**Z. I. Rusmali:** Ky rast sa persona?

**Z. E. Çefa:** Jo e doja në përqindjen në raport me personat që kanë votuar në total. Po nëse ju jeni në gjendje sigurisht. Tani ndoshta është e tepët të kërkojmë këtë shifër në këtë moment, por nëse e keni, po themi. Nëse e keni në raport me votuesit, sa përqind për këto qendra votimi që ju keni parë janë votime të kësaj natyre, pra, të parregullt të kësaj natyre, jo të natyrave të tjera që do të na i tregoni më vonë. A e keni këtë shifër apo...Nëse e keni sigurisht.

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Kuptova qartë pyetjen tuaj. Në këtë moment unë mund të bëj me dije Komisionit që në atë qendër votimi janë mbi 70 raste që i kryen veprimet drejtpërdrejt operatori. Nuk jam në gjendje të them se sa vota ka, sepse ka raste që ai do të afrohet vetë personalisht dhe klikon mbi 5 karta identiteti, i njëjtë operator, po ashtu edhe anëtarja e komisionit që i kam identifiku edhe me emra, i keni në dosje, i keni edhe me pamje. Të dhënrat e tyre i kam marrë nga rrjetet sociale


**Z. E. Çefa:** Në këtë qendër votimi sa votues janë regjistruar? E keni ketë informacion, sa votues kanë votuar atë ditë?

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Mund ta gjejmë atë, sepse e kam në.... minimalisht janë 70 persona që ka votuar operatori ose komisioneri, në atë qendër votimi. Pra janë 70 vota, të cilat nuk janë hedhur drejtpërdrejt nga votuesi.

**Z. E. Çefa:** Në sa votues total? Se dua të bëj përqindjen e famshme pra, këtë që thashë.

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Nuk e di sa mund të ketë qenë pjesëmarrja në atë qendër konkretisht, sepse nuk e kam bërë atë lloj analize, por di që në 15 QV që unë kam këqyrur, 13 janë me shkelje të kësaj kategorie duke pasur parasysh që në shumë raste nuk duket, janë vendosur me qëllim kamerat që duken vetëm këmbët e personave që lëvizin, pra nuk duket veprimet konkrete, si në këtë rast, por absolutisht duket operatori që në çdo rast në kundërshtim me çdo lloj procedure kalon në pjesën ballore të ekranit dhe kryen veprime konkrete sipër, dhe pa mbajtur asnje procesverbal dhe në dijeninë time, ndoshta kanë procesverbale, mos të aludojmë, se mund të ketë patur defekt dhe e kanë...

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Këto 70 rastet të kësaj qendre votimi dhe ato të tjerat në qendrat e tjera, i kemi ne në imazhe këtu? Apo janë përzgjedhje imazhet?

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Disa, pjesa dërrmuese i keni me imazhe. Një pjesë janë me foto, janë të specifikuara edhe me minutazh.

**Z. I. Rusmali:** Dakord! Qoftë edhe me foto, ne do t'i shohim këto, d.m.th. dhe do t'i numërojmë, është normale. Paraqit provën, ne do ta shqyrtojmë provën. Do t'i gjejmë të 70-ta, apo ka nevojë të pasurohet prova, se i keni lënë ca në shtëpi? Kjo është pyetja jonë.


**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Realisht nuk i kam punuar në shtëpi, i kam punuar në një ambient tjetër, kam punuar në një ambient tjetër por...

**Z. I. Rusmali:** Kjo ishte e rëndësishme, se në ambient laboratorik ndotet prova dhe pastaj..

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Po absolutisht është marrë në kushtet me optimale. Po për t'ju bind edhe juve dhe kush ka dëshirë të bindet që aty ka qenë një krim zgjedhor, ka qenë një batërdi. Vetëm zgjedhje nuk ka pasur në dt. 14.05.2023 në Kamëz. Dhe kjo është në interesin publik më së shumti.

**Z. I. Rusmali:** Dakord! Pyetja...

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Pyetja juaj...Unë kam shteruar me atë kohë krejt minimale që më keni lënë në dispozicion. Do të jemi në raport që t'ju bind për provën.

**Z. I. Rusmali:** Të lutem, të lutem, zoti Hoxha, d.m.th. ti ke dëshirë të thuash një gjë tjetër, je i mirëpritur ta thuash, por të lutem plotëso njëherë nevojën time. Unë do të shoh materialet, dhe unë duhet ta di që t'i check-oj të 70 rastet, nga një rast? Apo aty janë 50, 20...këtë dua të them.

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Ju kam sjellë materialet, nuk janë 70, janë diku rreth 130, 140, ndoshta edhe më shumë, edhe më pak. Ndoshta më shumë, edhe me pak, por janë absolutisht më shumë se 70, por që i keni të legjenduara me minuta se ku kanë ndodhur shkelja dhe çfarë shkelje konkrete ka. Voton operatori, ka votim kolektiv, voton anëtarë i komisionit, apo...

**Z. I. Rusmali:** Shumë faleminderit! Unë statistikën po e nxjerr nga imazhet që keni depozituar këtu.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së:** Ajo që mund të bëj, nëse mund të bëj një plotësim në lidhje me pyetjen që bëri zoti Rusmali. Ajo që ne do të donim të plotësonim, do të ishte që po të na ishin vënë të gjitha kamerat në dispozicion jam i bindur që zoti Hoxha bashkë me stafin e tij që i ka këqyrur të gjitha kamerat, do të kishte sjellë shumë më tepër prova sot. Pra, këtu është problemi. Ne kaq kemi arritur të sjellim për kaq pak orë në dispozicion. Pra edhe një herë për ta fiksuar për të gjithë, nga 15 qendra votimi, zoti Hoxha pretendon që në 13 prej tyre kanë probleme të theksuara me votimin kolektiv, votimin e asistuar me probleme, ose në të cilin nuk janë ndjekur

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

rregullat. Nga 15, 13 janë me probleme serioze. Herën e fundit, herën e kaluar, ne sollëm mbi 60 fotografi me ngjyra vetëm të një qendre votimi ku ishin evidentuar raste të asistimit nga personat aty, personi që ishte me jek portokalli, që është pjesë e stafit po themi, që ka asistuar në mënyrë të kundraligjshme, votuesit e caktuar. Vetëm një qendër votimi mbi 60 raste. Pra dhe mendoj që janë të mjaftueshme për të krijuar bindjen.

**Z. E. Çefa:** Këtë rast, ne e kuptuam pak a shumë, edhe çfarë na sollët ju. Ka ndonjë tjetër rast, ndonjë shkelje tjetër përveç kësaj që operatori ka ndihmuar në disa raste votuesit të votojnë. Përveç kësaj ka ndonjë tipologji tjetër shkeljeje apo vetëm.... e përgjithshmja është në këtë ... ka ndonjë shkelje tjetër që është evidentuar nga ju atë ditë, përveç këtyre, të kësaj lloj shkeljeje?

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Po, kemi votimin që kryhet nga komisionerët, përveç operatorit, dhe kemi komisioner që kryen drejtpërdrejt votim për llogari të votuesit, të rastësishëm, në atë qendër votimi. Kemi votim që voton operatori pa praninë e votuesit.

**Z. E. Lako:** Ta shofim këtë pretendimin.

**Z. I. Rusmali:** Një sekond...Voton operatori, apo komisioneri është e njëjta tipologji. Pyetja në këtë rast është: Si e keni identifiku Komisionerin? D.m.th. ne kur të shofim filmin e identifikojmë dot? Më saktë, që është komisioneri?

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Ju ndofta nuk e verifikoni dot. Gjithsesi unë e kam bërë printimin, e keni në fletë edhe emrat dhe gjeneralitetet e Komisionerit. Ju keni listën e Komisionerëve dhe mund ta verifikoni pastaj lehtësisht.

**Z. I. Rusmali:** Vetëm na shpjegoni ju, si e keni identifikuar? Vetëm kaq!

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Po patjetër. Unë banoj në atë zonë, kam 30 vite, dhe njoh ç'do punonjës të administratës, dhe ajo ishte përgjegjëse e UKK-së, Ilva Marku, dhe ma shpjeguan ata të PD-së, të zonës, se i pyeta: -Kush komisioner është kjo që voton? A është anëtar i komisionit, çfarë roli ka? - Po, është anëtar i komisionit i Partisë Socialiste dhe kryen këto veprime.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së:** Besoj dhe tipologja është tamam pak, i nderuar, përderisa është një komisioner që asiston apo voton, kjo përbën dhe vepër penale, në bazë të nenit 107.

**Z. K. Bele:** Kam një pyetje: E drejta e komisionerit të votojë në një qendër votimi, a është e njëjtë në ketë rast? Pra, komisioneri voton në vendbanimin e tij, ose në qendrën e votimit, nëse unë e kam. Është rasti që..., d.m.th. e përjashtojmë dot, që komisioneri ka qenë në qendrën e tij, ose ka ushtruar të drejtën e tij për të votuar. Nuk e di ky rast apo raste të tjera.

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Jo ky rast nuk sjell konfondim në këtë pjesë, sepse jep gjeneralitetet, jep kartën e identitetit votuesja, dhe kjo e shoqëron gjatë gjithë kohës, nga hyrja deri sa kryen veprimin, dhe votuesja vetë nuk kryen asnjë veprim me atë ekran.

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. E. Lako:** Ka nevojë ta shohim një pjesë të tillë? E keni të evidentuar aty?

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Po mund ta shikojmë. Po e njëjtë qendër është. Po në të njëjtën qendër e keni. Ajo me veshje të bardhë. Videoja e dytë. Këtu në telefon e gjej lehtë, po aty...

**Z. E. Lako:** Tjetër, tjetër, ka ndonjë shkelje të pretenduar?

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Ju thatë që i njëjti operator voton disa herë, pra është një pamje tjetër, që edhe ato i keni në dispozicion. Po voton mbi 5 herë rresht. Keni pastaj shkelje që bëhen nga administrata publike ditën e votimit, që i keni me pamjet që ua kam ... një listë e 100 personave që i kanë intimiduar ç'do votues. E kanë marrë me dorëzim të kontrolluar që në hyrje 150 m larg, duke e orientuar për votën e tij, duke e kontrolluar që ka votuar aty ku do ai, dhe duke e kthyer mbrapsht. Këto veprime duan një lidhje logjike, një këqyrje të kamerave që unë e kam kërkuar realisht, ndoshta nuk është objekti i kërkesës. ... n.q.s nuk e kërkoni ju te institucionet, sepse atë ditë ka qenë konfuzion...

**Z. E. Lako:** Nuk është te këto filmime?

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Nuk është në këto filmime, janë një pjesë që unë ia kam vënë në dispozicionin tuaj, në kërkësen e parë fillestare, të ankimores, ku janë 98 emra që të jem i saktë, 98 emra me drejtues shkollash, me drejtues të bashkishë me të gjitha veprimet konkrete që këta kanë kryer gjate ditës së zgjedhjeve. Mënyrën sesi kanë intimiduar, mënyrën se si janë grupuar, dhe se si kanë kontrolluar çdo

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

votues. Mënyrën se si kanë influencuar edhe brenda qendrave të votimit, me foto dhe me legjendim dhe me emra konkretë. Po ashtu keni një rast, që ky është...

**Z. I. Rusmali:** Të mbarojmë punë me videot.

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Kjo u fshi, video e kësaj 41, 1-shi e Paskuqanit. Te ekranit, të tre cd-të, me ato që kam arritur të 13 qendrat, më falni, e që unë i kam këqyrur, të gjitha provat janë të dorëzuara në administratën.

**Z. I. Rusmali:** Të gjitha votim për tjetrin?

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Po votim.

**Z. I. Rusmali:** Shkelje tjetër? Ndonjë rrëmujë të tavolina e komisionit, ndonjë veprim....?

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Jo nuk ka veprime të dhunshme, vetëm votim për...

**Z. E. Lako:** Atëherë vazhdojmë me provat e tjera që keni. Po zoti Braho.

**Z. L. Braho:** Kam një pyetje për ankimuesin. Tani ju pasi keni kqyrur të gjitha këto dhe të gjitha pretendimet e tjera, keni marrë ndonjë iniciativë tjetër ligjore përveç ankimit në KAS?

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Po, faleminderit për pyetjen. Atëherë, unë vij nga fusha e zbatimit të ligjit prej shumë vitesh dhe absolutisht që pasi të administroj të

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.01.06.2023*

gjitha provat, për mua përbëjnë vepër penale një pjesë dërrmuese nuk mund ta përcaktoj sesa dhe sesi, ose të cilit subjekt kanë qenë, gjithsesi, unë do bëj kallëzimet në prokurori dhe në institucione të tjera që kanë fushën e vet të ekspertizës dhe do të ndjek rrugën ligjore për përgjegjësitë penale që kanë përveç përgjegjësive administrative që mund të marrë institucionin juaj, KQZ-ja, apo institucione të tjera që unë nuk jam ndoshta në dijeni të dij se si funksionojnë. Ndërsa në aspektin e veprave penale që janë konsumuar në dijeninë time, janë konsumuar me shumicë atë ditë, dhe dy –tre ditë para, sepse përdorimi i forcave speciale dy ditët e fundit është i paprecedent. Kanë vepruar në Kamëz forcat RENEA, forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë. Unë vetë jam përplasur me forcat e policisë sepse po kontrollonin drejtuesit e strukturave tonë pa asnje mandat kontrolli, po i ndalonin në rrugë, pra pa asnje mandat kontrolli, paasnje të drejtë të parashikuar në kompetencën e përgjegjësitë e tyre, në ligjin e Policisë se Shtetit apo në Kod Zgjedhor, thjesht dhe vetëm, për t'i bllokuar, për të kryer, veprime të tjera, të cilat rezultuan të suksesshme, për atë subjekt politik që ata favorizuan me veprimet e tyre antiligjore. Unë i kam denoncuar, i kam me pamje filmike, po nuk i quajta të nevojshme t'ua vë ju në dispozicion, sepse për mua ato janë vepër penale, që do t'i adresoj në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor apo në SPAK, sipas kompetencës vendore dhe territoriale që ka. Faleminderit!

**Z. E. Lako:** Mirë, mund të vazhdoni me pretendimet e tjera që keni apo me ndonjë kërkesë, shpjegimin e provave, çfarë keni para KAS-it.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së:** Doja të vazhdoj me relatin faktikisht të kërkesës. Atëherë dhe sikundër e pamë dhe nga pamjet filmike do të keni dhe mundësinë t'i shihni nga provat e tjera, fotot që keni në dispozicion të nderuar anëtarë të KAS-it,

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

ne gjykojmë që në zgjedhjet në Kamëz në Bashkinë Kamëz së pari, është shkelur parimi kushtetues i votës vetjake, parimi kushtetues i sekretit dhe lirisë së votës gjithashtu.

Kemi vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 169 të datës 26 korrik 2002, ku Gjykata Kushtetuese, atëherë KQZ-ja nuk ekzistonte ende, në dijeninë time, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen me kërkues zotin Gafurr Muka, përfaqësuesi i Partisë Konservatore të Shqipërisë, me objekt shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr. 93, të datës 10.07.2002 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kjo gjykatë, Gjykata Kushtetuese, konstatoi se në një shumicë rastesh dhe në një mënyrë të dukshme, kishte persona të tjerë që kishin votuar për anëtarë të së njëjtës familje. Sipas Gjykatës Kushtetuese, votimi i një personi për të tjerët cënon parimin e votës vetjake, e parashikuar kjo, nga neni 45, pika 4 e Kushtetutës. Si Kushtetuta, ashtu edhe nenet e Kodit Zgjedhor, mbajnë një qendrim rigoroz kundër ç'do shkelje të këtij parimi dhe përcaktojnë rregulla të detajuara për të shmangur cënimin e kësaj të drejte politike, të drejtës së votës. Çdo shmangie prej tyre të çon në pasoja për të gjithë procesin zgjedhor. Në gjykimin e çështjes në fjalë rezultoi se, komisionet e qendrave të votimit në kundërshtim me ligjin kishin lejuar që zgjedhësit te votonin në emër të familjareve të tyre apo personave të tjerë. Duke marrë parasysh shkeljet e mësipërme, në atë zonë, ishte ndikuar te fitimi i mandatit çka bëri që Gjykata Kushtetuese ta shpallte të pavlefshme rezultatin dhe të përsëriteshin zgjedhjet. Ky është një standard i vendosur nga Gjykata Kushtetuese dhe që duhet të zbatohet kurdoherë. I njëjti standard është në përputhje dhe me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, dhe në këtë rast, e njëjta situatë ligjshmërie, në vlerësimin tonë ka ndodhur edhe në bashkinë Kamëz në 14 maj 2023. Nga provat që ne kemi arritur të sigurojmë në një kohë kaq të shkurtër derimë tani në përpjekje të këqyrjes së kamerave të vetë qendrave të votimit, që na janë vënë në dispozicion nga KQZ-ja,

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

evidentohen shumë qartë raste të shumta, raste të panumërtë të shkeljes së parimit kushtetues të votës vetjake, nëpërmjet votimit familjar, prezencës së një vëzhguesi apo një asistenti që shpesh herë duket qartë se prek ekranin e votimit elektronik, ç'ka do të thotë që ai person, jo vetëm mund të këtë votuar në vend të zgjedhësit, por më e pakta ka cenuar sekretin, fshehtësinë e votës, si dhe ka ndikuar në cenimin e lirisë se votës. Konkretisht, këto shkelje evidentohen nëpërmjet prezencës në shumë raste të dy a më shumë personave njëherësh mbas ekraneve elektronikë të votimit, gjithashtu evidentohen veprime të kundraligjshme dhe sistematike në mjaft qendra votimi, nga vëzhgues apo asistentët e votimit elektronik, të cilët kanë ndikuar zgjedhësit, në mënyrë sistematike, duke cënuar parimin e votës vetjake, parimin e sekretit të votës, si dhe gjithashtu, duke cënuar parimin e lirisë së votës pikërisht, sepse duke u sjellë në atë mënyrë, të veshur me pushtetin dhe me autoritetin e përfaqësuesve të KQZ-së, ata kanë dhënë përshtypjen se kishin autoritetin e shtetit, dhe si i tillë, ky proces votimi është i cenuar. Ne kemi paraqitur mjaft raste, të nderuar, ku njerëz, duken mjaft qartë nga kamerat, se presin në thonjëza “që të vijë asistenti që t'i ndihmojë” për t'i orientuar drejt votës, ndërkohë që vetë Kodi Zgjedhor, në nenet 106, 107, 108, të tij parashikon tashmë mekanizma mjaft strikt, dhe në raste mjaftë të kufizuara, ku mund të ndërhyhet për të asistuar persona të caktuar. Përjashtimi, pra, që bëhet nga vota vetjake është mjaft strikt, dhe neni 106, pika 3, e sanksionon se kur duhet të vijë dikush dhe të asistojë një zgjedhës. Po jua citoj shkurtimisht: “Zgjedhësi voton vetëm përvete, me përjashtim të rastit të përcaktuar në nenin 108 të këtij Kodi”. Ndërkohë në pikën 5, të nenit 106, është një dispozitë e tillë, e cila sanksionon shkeljet e këtij parimi, konkretisht Kodi parashikon që anëtarët e qendrave të votimit që kanë lejuar një zgjedhës të votojë më shume se një herë, ose në emër të zgjedhësve të tjera mbajnë përgjegjësi penale në përputhje me nenin 248 të Kodit Penal, që është shpërdorimi i detyrës, me

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

përjashtim të rastit të parashikuar nga neni 108 i Kodit Zgjedhor, ndërkokë që në Kamëz, ne kemi arritur të provojmë, pa asnje dyshim, se ka ndodhur votim masiv, votim familjar në dhjetëra qindra raste, në 14 maj 2023, dhe askush nuk është përballur deri më tani me pasojat ligjore apo pasojat penale, në lidhje me shkeljet e tyre. Së dyti, ne kemi konstatuar shkelje të procedurave që garantohen nga Kodi Zgjedhor, në mënyrë të qëllimshme dhe në mënyrë sistematike, kanë ndodhur këto shkelje. Kjo ka krijuar një model sjellje në mjaft qendra votimi që e shtyn zgjedhësin që të mendojë që para që para se të votojë, komisioni, pra shteti mund të interferojë pa kufizime, në fshehtësi e përrjedhoje të interferojë në lirinë e zgjedhjes. Pra, jo vetëm që është cënuar sipas nesh, rëndë, parimi kushtetues i sekretit, i lirisë së votës, kur ka ndërhyrë operatori, por i tërë procesi në atë qendër votimi apo në qendra votimi përkatëse është kompromentuar. Është kompromentuar rëndë, duke mos dhënë jo vetëm në substancë, por as në dukje, aparençën e garancive kushtetuese dhe ligjore që zgjedhësit të paraqiteshin për të votuar të lirë. Pra, ne gjykojmë se në mjaft qendra në Kamëz, vullneti i zgjedhësve është deformuar. Neni 108 i Kodit Zgjedhor, i cili parashikon rastet se kur zgjedhësit nuk mund të votojnë vetë, sanksionon që vetëm zgjedhësit, të cilët për arsyen fizike, e kanë të pamundur të kryejnë procedurat e votimit, mund të kërkojnë ndihmën e një familjari, ose të një zgjedhësi tjetër që është regjistruar në listën e zgjedhësve për t'i ndihmuar, për t'i asistuar në votë, dhe kjo vetëm me procedurë strikte kur personi nënshkruan deklaratën në librin e protokollit të mbledhjeve të asaj qendre votimi dhe angazhohet se nuk do të bëjë publike votën, pra janë disa kushte. Ju, si KAS, keni mundësinë që t'i merrni të gjitha protokollet e mbledhjeve të qendrave të votimit, bazuar në nenin 21, në Kamëz, dhe të shihni aty, nëse ka pasur në librat e protokollit shënimë, në lidhje me deklaratat në fjalë, deklaratat e shoqërimit të personave për të votuar, dhe jam i bindur që në pjesën, për të mos thënë 99% në 100% të rasteve nuk do të gjeni asnje deklaratë të

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*




*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.01.06.2023*

tillë në librat e protokollit. Ndërkokë nen 108, pika 4, ndalon shprehimisht anëtarët e komisionit të zgjedhjeve apo sekretarët që të mund të ndihmojnë zgjedhës për të votuar. Nga pamjet filmike dhe sikundër e parashtroi dhe kandidati, zoti Hoxha, janë evidentuar mjaft raste ku kanë qenë vetë anëtarët e komisioneve të qendrave të votimeve, ata të cilët janë ngritur, kanë shkuar, dhe i kanë asistuar (në thonjëza) zgjedhësit, veprim ky totalisht, në kundërshtim me ligjin, me Kodin Zgjedhor, dhe që përbën krim zgjedhor. Ligji është shumë i qartë: "Vetëm personat që nuk kanë aftësi fizike për të votuar mund të asistohen". Ligji nuk thotë që mund të asistohen personat mbi 50 vjeç, personat në pension, personat që nuk kanë shkollë të lartë, personat që nuk dinë të përdorin mjetet apo teknologjinë e informacionit, personat që nuk dinë gjuhë të huaja, etj. etj.. Ndoshta do të duhet që Kodi Zgjedhor të ndryshohet në të ardhmen, po kuadri ligjor aktual nuk e lejon këtë gjë. Dhe praktikat e paligjshme, n.q.s se ato mund të jenë toleruar në raste, pavarësisht, nëse kanë qenë masive apo jo, kjo nuk do të thotë që të legjitimohet dhe të justifikohet. Fakti se këto praktika nuk janë kontestuar ndonjëherë apo nuk janë kontestuar gjithmonë nga ana e komisionerëve qoftë edhe të koalicionit tonë, nëse ka pasur raste të tilla, ku siç dihet ne, si koalicion nuk është se kemi pasur komisionerë në të gjitha qendrat e votimit, përkundrazi, kjo nuk do të thotë aspak se duhet përligjur votimi masiv, votimi familjar, votimi i operatorit në vend të zgjedhësit apo votimi i asistuar, i kryer kryekëput në kundërshtim me rregullat e përcaktuara nga Kodi Zgjedhor. Prandaj jemi këtu përparrë KAS-it, pikërisht për të kundërshtuar komplet këto procedura, dhe për të kërkuar anulimin e zgjedhjeve në bashkinë Kamëz, pikërisht se po kundërshtojmë këto shkelje flagrante, që në gjykimin tonë të procesit zgjedhor, shkelje flagrante të Kushtetutës dhe ligjit. Nga ana tjetër, fakti se këto ngjarje kanë ndodhur në mënyrë sistematike në Kamëz, dëshmojnë për shkelje të rënda të procesit, shkelje që kanë deformuar vullnetin e zgjedhësve në mënyrë të rëndë,

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

gjithashtu dhe lirinë e tyre. Në këto kushte, ne do kërkojmë anulimin ose shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve në bashkinë e Kamzës. Po ja lë fjalën kandidatit nëse ka diçka për të shtuar. Faleminderit!

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Atëherë, në parim jam absolutisht dakord me parashtrimin që bëri avokati. Doja thjesht të sqaroj anëtarët e komisionit, që qëllimi im është që vërtet të ketë një proces, sepse është cenuar rëndë vullneti i zgjedhësve, qoftë edhe me shoqërim, megjithëse shoqërimet kanë qenë në kundërshtim me parashikimet dhe detyrimet që ka Kodi Zgjedhor, që duhet plotësuar fillimisht deklarata, por gjithsesi ka qendra votimi që mbi 50% e votuesve, janë votues me shoqërim, që shoqërimi është bërë nga punonjësit e administratës publike, apo nga përfaqësues të Partisë Socialiste, gjë e cila ka ndikuar drejtpërdrejt në vullnetin e zgjedhësve më datën 14 maj në Bashkinë e Kamzës. Përveç atyre dyshimeve të tjera, përveç fakteve, dhe provave që ne sollëm këtu, edhe kjo, po të shikohen të gjitha pamjet filmike, n.q.s mbi 50% e votuesve, në disa qendrat votimi edhe më tepër, absolutisht dëshmon qartë, që nuk ka qenë vullneti i votuesve ai i datës 14 maj, po ka qenë vullneti i administratës publike, vullneti i atyre që kanë diktuar rezultatin e datës 14 maj, përveç shkeljeve të tjera që janë absolutisht flagrante, janë të hapura, që dëshmojnë qartë dhe dëshmi e qartë e kontrollit të votuesve, është edhe rasti i paprecendentë i një anomalie statistikore, ku një kandidat humb vota në ç'do qendër votimi në bashkinë Kamzë. Ju do të thoni që ky nuk është... por absolutisht, kjo anomali statistikore është e paprecendentë në historinë e zgjedhjeve vendore apo politike në Republikën e Shqipërisë. Faleminderit!

**Z. E. Lako:** Më duket Zoti Hoxha se një nga ato QV-të...sot ishit fitues në një, apo si subjekt?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*  


*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Prit ta sqarojmë. Është një kuti, një qendër votimi ka 3-4 kuti në këtë sens flas unë. A t'i ndajmë, ose për ta thënë, kemi 29 grup-seksione dhe unë kam paraqitur në atë... e keni dhe me grafik, ndoshta në grafik nuk jua kam paraqitur, por në seancën e radhës...

**Z. E. Lako:** Me formën e organizimit e njëjta gjë, por me qendër votimi...

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Me formën e organizimit, me një kuti sporadike...

**Z. E. Lako:** Mirë, nëse nuk keni diçka tjeter. Për palët e interesuara ka ndonjë diçka tjeter, çfarë mund të ...

**Z. A. Skënderi, përfaqësues i PS-së:** Jo, nuk kemi ndonjë gjë, kështu esenciale, ne e diskutuam edhe ditën e djeshme qëndrimin që mbajti kandidati, se është po i njëjti qëndrim. Nga këqyrja, po themi, e atyre gjetjeve që pamë, aq sa arritëm të shikojmë në këtë moment këtu, aq sa u shfaqen, ndikimi që pretendohet të jetë kaq i madh në rezultatin zgjedhor të pritshëm të kandidatit, nuk evidentohet, të paktën konkretisht, meqenëse këtu po flasim për prova, tasni prova po ngeli dyshim, s'është me provë në vetvete. Fakti që aty nuk ndihmohet dorë për dorë kandidatët nuk do të thotë që në 2 raste, apo 3 raste që evidentohet nga videot, meqenëse videot i ka sjellë vetë subjekti, nuk janë të imponuara nga ana juaj, nuk përbën risi në këtë përqindje më të madhe të pritshmërisë që ka kandidati, kështu që ky ngelet pak dyshim i arsyeshëm. Aty mund të këtë parregullsi procedurale, por nuk është se ka ndodhur dorë për dorë. Aq më tepër, ka pasur vëzhguesin të zgjedhur nga ana e tij, që nuk kërkuar as pezullim në atë qendër votimi asgjë, d.m.th. e ka konsideruar të rregullt procesin,

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*  


*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

ndërkohë janë 7 anëtarë të tjerë të komisionit aty, që e shikojnë 3 metra më larg, ku bëhet votimi elektronik, dhe asnjë prej tyre nuk çohet ose të kontestojë, ndërkohë që flitet edhe me audio, pavarësisht se këtu ne nuk e dëgjojmë audion. Kështu që të gjitha këto rrethana nuk të çojnë patjetër te anulimi i zgjedhjeve, sepse 160-ta, pika "a", e thashë edhe dje: kërkon me patjetër – thotë: "që të jetë e rëndë situata", nëse këtu kandidati thotë që unë prisja dhe 70 vota ose kam dhe 70 evidentime, ose edhe 100 qofshin ato, në tërësinë e humbjes, po e quaj kështu, të votave të pritshme të kandidatit, atëherë sa shkon raporti i përqindjes së këtij gabimi dhe si ndikon kjo, që ky rezultat, të shkojë te pavlefshmëria e zgjedhjeve, sipas nenit 160, meqenëse ky është kërkimi final i të gjithë objektit të kërkimit të tij. Kështu që më duket një pak, më tepër si ... Pa dëshirë që s'i ka marrë ato vota, të pritshme, se sa provueshmërinë në kuptimin e të Kodit Elektoral dhe të veprimtarive që kanë ndodhur atje. Faleminderit!

**Z. E. Lako:** Faleminderit! Ka ndonjë pyetje në këtë? Doni edhe juve të shton ...

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Po një replikë të vogël. Dëshira e çdo kandidati është për të fituar zgjedhjet, dhe kjo nuk ngelet në vlerësimin tuaj subjektiv. Absolutisht edhe unë kam patur dëshirë të fitojë, po kjo nuk më errëson mua logjiken dhe nuk më errëson si jurist, unë do të kanalizohesha pavarësisht përfaqësuesi i kujt jam, po të shikoja në një qendër votimi në mënyrë flagrante votojnë operatoret dhe komisionarët. Dhe po të kisha qenë anetar i komisionit dhe po të kishte qenë duke me favorizuar mua nuk ia kisha lënë që t'i bënte kundërshtarit politik atë lloj veprimi prandaj, mua nuk më duket normale që të thuash ato nuk janë shkelje. Ato janë shkelje flagrante të ligjit. Ato përbejnë vepër penale. E tejkalojnë ndoshta .. E shpjegova, ndoshta nuk është objekti i këtij diskutimi, por gjithsesi ato kanë cënuar

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

rëndë, sepse tejkalon veprimin administrativ, vepra penale, e tejkalon, por ato kanë cenuar rende rezultatin. Të gjitha format janë përdorur. Një nga këto është votimi nga ana e operatoreve dhe komisionarëve, përveç intimidimit gjatë gjithë ditës, përveç presionit, përveç administratës publike që ka predominuar, dhe ka ushtruar presion hapur me gjitha format e saj të mundshme, gjatë gjithë procesit të votimit nga ora 07:00, i dini, sepse i keni me pamje dhe jua kam kërkuar, i keni edhe me foto po t'i shikoni, aty i keni edhe me emra konkrete që mund t'i verifikoni dhe mund t'i pyesni, dhe të gjitha këto forma kanë sjellë absolutisht një rezultat, i cili nuk ishte as në pritshmërinë e kundërshtarit politik. Faleminderit!

**Z. E. Lako:** Faleminderit, zoti Hoxha. Ka ndonjë pyetje tjetër? Besoj i shteruat edhe kërkuesat. Mirë, atëherë këtu i jepin fund pjesës së hetimit për këtë ankim dhe meqenëse siç, u relatua këtu janë disa disqe që përbajnë videot e pamjeve që ju pretendoni, në mënyrë që edhe KAS të këtë kohën e nevojshme për t'i parë ato dhe për t'i vlerësuar. Atëherë ne, pjesën e pretendimeve përfundimtare dhe të shpalljes së vendimit do ta lëmë në një ditë tjetër. Apo t'i mbyllim që sot? Atëherë dhe pretendimet përfundimtare, shkurtimisht, që edhe ta mbyllim si procedurë, ju çfarë kërkoni nga KAS?

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së** Paraprakisht, siç u relatua që në fillim, ne kemi një pjesë shumë të vogël, pra, nuk është plotësuar detyrimi ose përgjegjësia që kam patur për të vënë në dispozicion të gjitha kamerat, sepse nga ana e administratës së KQZ-së, nuk ishte bërë e mundur deri tani. Ne presim që të na vijnë të gjitha kamerat në dispozicion, të gjitha ato, dhe pastaj ne ta plotësojmë përsëri me shkelje, dhe me prova të tjera, t'ju bindim ju, si komision, që absolutisht ajo ka qenë rezultati që

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

është prodhuar në mënyrë fiktive, dhe jo vullneti i qytetarëve, votuesve.  
Faleminderit!

**Z. E. Lako:** Zoti Hoxha pa dashur që t'ju heqë asnje të drejtë, ne llojet e tipologjive jua kërkuam të shkeljeve, dhe ato tipologji ne do t'i mbajmë në vlerësimin tonë, jo vetëm për këto QV, por edhe për QV të tjera të mundshme, të cilat edhe ne gjatë kësaj kohe mundet që të marrim një kopje të këtyre pamjeve që do t'ju vihen edhe ju, kështu që...

**Z. A. Hoxha, kandidat i BF-së:** Më falni, mungojnë disa qendra votimi, ku rezultati është shumë i thellë dhe mosvënia e tyre në dispozicion mua më duket e qëllimshme dhe mendoj që juve duhet të jeni shumë më të qartë nëse unë do kem të gjitha kamerat në dispozicion dhe do ju bind, do ju vë përpara, shumë prova të tjera të cilat, vërtetë do t'ju bindin dhe ato që nuk janë të qarta, mund të jenë të qarta, n.q.s do të shkarkohen siç duhet, dhe absolutisht do të krijohet...

**Z. E. Lako:** Zoti Hoxha, nëse ju deri në ditën që do lëmë seancën, që e mendojmë eventualisht ditën e martë, ora 12:30. Nëse ju, vëreni gjatë kësaj periudhe te provat e reja që keni ndonjë gjë që ja vlen dhe diçka konkrete që ne mos të rrime prapë të shohim filmime pa fund, po diçka që është ndryshe nga këto që pamë dhe që i vlen këtij procesi, ne mund ta riçelim prapë hetimin dhe t'i vlerësojmë ato prova të reja që keni paraqitur. Pra shkurtimisht sot që t'i mbyllim dhe konkluzionet dhe pastaj duke parë e duke bërë ditën e martë,

**Z. Y. Merkaj:** Tani do të gjitha qendrat e votimit, apo do disa qendra specifike që thotë ku është rezultati më i thellë.

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.01.06.2023*

**Z. E. Lako:** Mirë atëherë që edhe ne mos të bëjmë debat, ditën e martë ora 12 e 30, nëse keni prova të reja, ne do ta riçelim hetimin, në të kundërt, do të kalojmë me konkluzione dhe me shpalljen e vendimit. Faleminderit, me kaq e deklaroj të mbyllur seancën për sot!

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*

